



COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME  
EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS

© Këshilli i Evropës/Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 2012. Ky përkthim u bë i mundur me mbështetjen e Fondit të Mirëbesimit të të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Evropës ([www.coe.int/humanrightstrustfund](http://www.coe.int/humanrightstrustfund)). Ai nuk është detyrues për Gjykatën. Për më shumë informacion, shiko shënimin e plotë në lidhje me të drejtën e autorit në fund të këtij dokumenti.

© Council of Europe/European Court of Human Rights, 2012. This translation was commissioned with the support of the Human Rights Trust Fund of the Council of Europe ([www.coe.int/humanrightstrustfund](http://www.coe.int/humanrightstrustfund)). It does not bind the Court. For further information see the full copyright indication at the end of this document.

© Conseil de l'Europe/Cour européenne des droits de l'homme, 2012. La présente traduction a été effectuée avec le soutien du Fonds fiduciaire pour les droits de l'homme du Conseil de l'Europe ([www.coe.int/humanrightstrustfund](http://www.coe.int/humanrightstrustfund)). Elle ne lie pas la Cour. Pour plus de renseignements veuillez lire l'indication de copyright/droits d'auteur à la fin du présent document.



COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME  
EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS

DHOMA E MADHE

**ÇËSHTJA A. DHE TË TJERË kundër MBRETËRISË SË  
BASHKUAR**

*(Kërkesa nr. 3455/05)*

VENDIM

STRASBURG

19 shkurt 2009

*Ky vendim është përfundimtar por mund t'i nënshtrohet rishikimit  
redaktues.*

**Në çështjen A. dhe të Tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar,**  
Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, në Dhomën e Madhe të përbërë nga:

Jean-Paul Costa, *Kryetar,*  
Christos Rozakis,  
Nicolas Bratza,  
Françoise Tulkens,  
Josep Casadevall,  
Giovanni Bonello,  
Ireneu Cabral Barreto,  
Elisabeth Steiner,  
Lech Garlicki,  
Khanlar Hajiyev,  
Ljiljana Mijović,  
Egbert Myjer,  
David Thór Björgvinsson,  
George Nicolaou,  
Ledi Bianku,  
Nona Tsotsoria,  
Mihai Poalelungi, *gjyqtarë,*

dhe Michael O'Boyle, *Zëvendës Kancelar,*

Pasi shqyrtimit me dyer të mbyllura më 21 maj 2008 dhe më 4 shkurt 2009,

Merr vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në datën e fundit të lartpërmendur:

## PROCEDURA

1. Çështja filloi në vijim të një kërkesë (nr. 3455/05) kundër Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore e cila u depozitua në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa") nga njëmbëdhjetë individë joshitetas të Mbretërisë së Bashkuar ("kërkuesit"), më 21 janar 2005. Kryetari pranoi kërkesën e kërkuesve që emra e tyre të mos zbuloheshin (neni 47 § 3 i Rregullores së Gjykatës).

2. Kërkuesit përfaqësoheshin nga Birnberg Pierce and Partners, firmë avokatie nga Londra. Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar ("Qeveria") përfaqësohej nga Agjenti Përfaqësues Z. D. Walton, nga Zyra e për Çështje të Commonwealth-it dhe Punëve të Jashtme.

3. Kërkuesit pretenduan, në mënyrë të veçantë, që ishin ndaluar në mënyrë të paligjshme, në kundërshtim me nenet 3, 5 § 1 dhe 14 të

Konventës, dhe që nuk kishin pasur mjetet e duhura në dispozicion, në kundërshtim me nenet 5 § 4 dhe 13.

4. Kërkesa iu caktua Seksionit të Katërt të Gjykatës (neni 52 § 1 i Gjykatës). Më 11 shtator 2007, një Dhomë e atij Seksioni, e përbërë nga gjyqtarët në vijim: Josep Casadevall, Nicolas Bratza, Giovanni Bonello, Kristaq Traja, Stanislav Pavloschi, Lech Garlicki, Liliana Mijović dhe gjithashtu Lawrence Early, Kryesekretar i Seksionit, hoqi dorë nga juridiksioni për t'ia lënë Dhomës së Madhe, ndërkohë që asnjëra nga palët nuk e kundërshtoi këtë (neni 30 i Konventës dhe neni 72 i Rregullores).

5. Përbërja e Dhomës së Madhe u vendos sipas dispozitave të nenit 27 §§ 2 dhe 3 të Konventës dhe nenit 24 të Rregullores së Gjykatës.

6. Si Kërkuesit, ashtu edhe Qeveria depozituan vërejtjet e tyre me shkrim lidhur me themelet. Përveç kësaj, u pranuan komentet e palëve të treta nga dy organizata jo-qeveritare me seli në Londër, Liberty dhe Justice, të cilave u ishte dhënë leje nga Kryetari për të ndërhyrë në procedurën me shkrim (neni 36 § 2 i Konventës dhe neni 44 § 2 i Rregullores).

7. Një seancë dëgjimore publike u mbajt në Ndërtesën e të Drejtave të Njeriut, në Strasburg, më 21 maj 2008 (neni 59 § 3 i rregullores).

Para Gjykatës dolën:

- (a) *për Qeverinë*  
 Z. D. WALTON, *Përfaqësues*  
 Z. P. SALES, QC  
 Znj. C. IVIMY, *Avokatë,*  
 Z. S. BRAVINER-ROMAN,  
 Znj. K. CHALMERS,  
 Z. E. ADAMS,  
 Z. J. ADUTT,  
 Z. L. SMITH, *Këshilltarë;*
- (b) *për Kërkuesit*  
 Znj. G. PIERCE,  
 Znj. M. WILLIS STEWART,  
 Z. D. GUEDALLA, *Këshilltarë Juridikë,*  
 Z. B. EMMERSON, QC,  
 Z. R. HUSAIN,  
 Z. D. FRIEDMAN, *Avokat.*

Gjykata dëgjoi fjalimet e Z. Emmerson dhe Z. Sales dhe përgjigjet e tyre lidhur me pyetjet e parashtruara nga Gjykata.

## FAKTET

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

8. Faktet e çështjes, siç u paraqitën nga palët, mund të përmbliidhen si më poshtë.

#### A. Derogimi

9. Më 11 shtator 2001 katër avionë komercialë u rrëmbyen në hapësirën ajrore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Dy prej tyre u përplasën drejt në Kullat Binjake të Qendrës Botërore të Tregtisë dhe një avion i tretë u rrëzua në Pentagon, duke shkaktuar humbje të mëdha të jetëve njerëzore dhe shkatërrim të pronave. Organizata terroriste islamike al'Qaeda e udhëhequr nga Osama Bin Laden mori përsipër përgjegjësinë. Mbretëria e Bashkuar u bashkua me Shtetet e Bashkuara në një aksion ushtarak në Afganistan, i cili ishte përdorur si bazë për kampet ushtrimore të al'Qaedës.

10. Qeveria pretendoi që ngjarjet e shtatorit 2001 treguan se terroristët ndërkombëtarë, sidomos ata që kishin lidhje me al'Qaedën, kishin qëllim dhe kapacitete për të zhvilluar sulme kundër shënjestrave civile në shkallë të atillë që ishte pa precedent. Më tej, duke pasur parasysh strukturën e ngushtë globale të al'Qaedës si dhe bashkëpunëtorët e saj dhe fanatizmin, pamëshirshmërinë dhe vendosmërinë e tyre, do të ishte e vështirë për Shtetin që të parandalonte sulme të tjera. Sipas vlerësimit të Qeverisë, Mbretëria e Bashkuar, për shkak të lidhjeve të saj të ngushta me Shtetet e Bashkuara, ishte në shënjestër të veçantë. Ajo konsideroi që ekzistonte një emergjencë e llojit më të rëndë të rrezikut ndaj jetës së kombit. Për më tepër, ajo konsideronte që kërcënimi vinte kryesisht por jo vetëm nga një numër i caktuar shtetasish të huaj të pranishëm në Mbretërinë e Bashkuar, të cilët ofronin rrjete ndihme për operacionet islamike terroriste lidhur me al'Qaedën. Disa prej këtyre shtetasve të huaj nuk mund të depërtoheshin për shkak të rrezikut që, po të ktheheshin në vendin e tyre, ata do të vuanin dënime kundër nenit 3 të Konventës.

11. Më 11 nëntor 2001, Sekretari i Shtetit mori një Urdhër Derogimi sipas Seksionit 14 të Ligjit të të Drejtave të Njeriut të vitit 1998 ("Ligji i vitit 1998") ("Ligji i vitit 1998", shih paragrafin 9 poshtë), ku ai vendosi kushtet e një informimi të propozuar për Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës në lidhje me një derogim sipas nenit 15 të Konventës. Më 18 dhjetor 2001, Qeveria e dërgoi derogimin tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës. Në letrën deroguese shkruhej:

***“Emergjencë publike në Mbretërinë e Bashkuar***

Sulmet terroriste në New York, Washington D.C. dhe Pensilvania të 11 shtatorit 2001 sollën mijëra vdekje, përfshirë edhe shumë viktime britanike dhe shtetas të tjerë nga 70 vende të ndryshme të botës. Përmes rezolutave 1368 (2001) dhe 1373 (2001), Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara i njohu sulmet si kërcënim ndaj paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

Kërcënimimi nga terrorizmi ndërkombëtar është i vazhdueshëm. Në rezolutën 1373 (2001), Këshilli i Sigurimit, duke vepruar sipas Kreut VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, u kërkoi të gjitha Shteteve të merrnin masa për parandalimin e kryerjes së sulmeve terroriste, përfshirë edhe mohimin e strehimit të sigurt atyre që financojnë, planifikojnë, përkrahin apo kryejnë sulme terroriste.

Ekziston një kërcënim terrorist në Mbretërinë e Bashkuar nga persona që dyshohen të jenë të përfshirë në terrorizëm ndërkombëtar. Në mënyrë të veçantë, ka shtetas të huaj në Mbretërinë e Bashkuar të cilët dyshohen për përfshirje në urdhërimin, përgatitjen apo nxitjen e akteve të terrorizmit ndërkombëtar, ose për anëtarësim në organizata apo grupe të cilat janë aq të lidhura me anëtarët e këtyre organizatave dhe grupeve, të cilat përbëjnë kërcënim për sigurinë kombëtare në Mbretërinë e Bashkuar.

Për pasojë, në Mbretërinë e Bashkuar ekziston emergjenca publike në kuptim të nenit 15(1) të Konventës.

***Ligji për Anti-Terrorizmin, Krimin dhe Sigurinë i vitit 2001***

Si rezultat i emergjencës publike, Ligji për Anti-Terrorizmin, Krimin dhe Sigurinë i vitit 2001, *inter alia*, përmban dispozita për pushtete të zgjeruara për arrestimin dhe ndalimin e shtetasve të huaj, çka është e zbatueshme kur ka për qëllim zhvendosjen apo depërtimin e personave nga Mbretëria e Bashkuar por kur zhvendosja apo dëbimi nuk janë të mundura në kohën e dhënë, me pasojën që ndalimi do të ishte i paligjshëm sipas legjislacionit vendor. Pushteti i zgjeruar për të arrestuar dhe ndaluar zbatohet kur Sekretari i Shtetit lëshon një certifikatë ku shpreh bindjen e tij që prania e personit në Mbretërinë e Bashkuar përbën rrezik ndaj sigurisë kombëtare dhe që ai dyshon se personi është terrorist ndërkombëtar. Ajo certifikatë i nënshtrohet një ankese të Komisionit të Posaçëm të Ankesave të Imigracionit (angl. SIAC), i ngritur në përputhje me Ligjin e Posaçëm të Ankesave të Imigracionit të vitit 1997, i cili ka fuqi ta anulojë certifikatën nëse ka arsye të besojë se ajo nuk duhet të ishte lëshuar. Mund të depozitohet ankesë lidhur me një pikë të ligjit nga një vendim i SIAC-it. Përveç kësaj, certifikata rishikohet nga SIAC në intervale të rregullta kohore. Gjithashtu, SIAC ka mundësi të lejojë dorëzimin, kur është me vend dhe në rrethana të caktuara. Çdo i ndaluar ka të drejtë ta përfundojë ndalimin e tij nëse pajtohet që të largohet nga Mbretëria e Bashkuar.

Pushteti i zgjeruar për arrestime dhe ndalime në Ligjin për Anti-Terrorizmin, Krimin dhe Sigurinë të vitit 2001 përbën masë që kërkohet rreptësisht nga kushtet dhe kërkesat e situatës. Është një dispozitë e përkohshme e cila hyn në fuqi për një periudhë fillestare prej 15 muajsh dhe më pas skadon deri sa të ri-miratohet nga Parlamenti. Prandaj, ai i nënshtrohet rishikimit vjetor nga Parlamenti. Nëse në një kohë të caktuar, sipas vlerësimit të Qeverisë, emergjenca civile nuk ekziston më, ose pushteti i zgjeruar nuk kërkohet më në mënyrë rreptë nga kushtet e situatës, atëherë Sekretari i Shtetit e tërheq urdhrin.

***Pushteti për arrestime [ndalime] sipas të drejtës vendase (përveç Ligjit për Anti-Terrorizmin, Krimin dhe Sigurinë të vitit 2001)***

Qeveria ka pushtet në përputhje me Ligjin e Imigracionit të vitit 1971 ('Ligji i vitit 1971') për të zhvendosur apo dëbuar persona mbi bazën e faktit që prania e tyre në Mbretërinë e Bashkuar nuk çon drejt së mirës publike në aspektin e sigurisë kombëtare. Personat po ashtu mund të arrestohen dhe ndalohen sipas Skemave 2 dhe 3 të Aktit të vitit 1971 në pritje të dëbimit të tyre. Gjykatat në Mbretërinë e Bashkuar kanë vendosur që ky pushtet ndalimi mund të ushtrohet vetëm gjatë periudhës së nevojshme, në të gjitha rrethanat e rastit konkret, për të zbatuar zhvendosjen, dhe që, nëse bëhet e qartë se zhvendosja nuk do të jetë e mundur brenda një periudhe kohore të arsyeshme, ndalimi është i paligjshëm (*R. Kundër Guvernatorit të Burgut të Durhamit, ex parte Singh* [1984] All ER 983).

#### ***Neni 5(1)(f) i Konventës***

Është konstatuar tashmë që Neni 5(1)(f) lejon ndalimin e një personi me qëllim të dëbimit vetëm në rrethana kur 'po ndërmerren veprime me qëllim të dëbimit' (*Chahal kundër Mbretërisë së Bashkuar* (1996) 23 EHRR [Raporti Europian mbi të Drejtat e Njeriut] 413 në paragrafin 112). Në atë rast, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut u shpreh që ndalimi do të pushohet që qeni i lejuar sipas Nenit 5(1)(f) nëse procedurat e dëbimit nuk zbatohen me zellin e duhur, dhe që ishte e nevojshme që në raste të tilla të përcaktohej nëse kohëzgjatja e procedurave të dëbimit ishte e tepruar (paragrafi 113).

Në disa raste, kur qëllimi mbetet zhvendosja apo dëbimi i një personi apo shtetasi mbi bazat e sigurisë kombëtare, ndalimi i vazhduar mund të mos jetë në përputhje me Nenin 5(1)(f) siç interpretohet nga Gjykata në çështjen *Chahal*. Kështu mund të jetë nëse, për shembull, personi ka konstatuar që zhvendosja e tij drejt vendit të vet mund të rezultojë në trajtim që kundërshton Nenin 3 të Konventës. Në raste të tilla, pavarësisht nga serioziteti i kërcënimit ndaj sigurisë kombëtare që shkaktohet nga personi në fjalë, është e vendosur që Neni 3 e ndalon zhvendosjen apo dëbimi drejt një vendi ku ekziston një rrezik real që personi do të trajtohet në kundërshtim me atë Nen. Nëse nuk ka një destinacion tjetër në dispozicion të menjëhershëm, atëherë zhvendosja apo dëbimi nuk është i mundur, për momentin, pavarësisht nga fakti që qëllimi përfundimtar mbetet zhvendosja ose dëbimi i personit sapo të jenë bërë përgatitjet e duhura. Përveç kësaj, mund të mos jetë e mundur të ndiqet penalisht një person për një vepër penale duke pasur parasysh rregullat e rrepta lidhur me pranueshmërinë e provave në sistemin e drejtësisë penale në Mbretërinë e Bashkuar dhe standardet e larta të provave që kërkohen.

#### ***Derogimi sipas Nenit 15 të Konventës***

Qeveria ka shqyrtuar nëse ushtrimi i pushtetit të zgjeruar për ndalim i përmbajtur në Ligjin e Kundër-Terrorizmit, Krimin dhe Sigurisë të vitit 2001 mund të jetë në shpërputhje me detyrimet nga Neni 5(1) i Konventës. Siç tregohet më lart, mund të ketë raste kur, pavarësisht nga qëllimi i vazhdueshëm për zhvendosjen apo dëbimin e një personi i cili mbahet i ndaluar, nuk është e mundur të thuhet që 'po ndërmerren veprime me qëllim të dëbimit' në kuptim të Nenit 5(1)(f) siç interpretohet nga Gjykata në çështjen *Chahal*. Për sa kohë që ushtrimi i pushtetit të zgjeruar mund të jetë në shpërputhje me detyrimet e Mbretërisë së Bashkuar sipas Nenit 5(1), Qeveria ka vendosur të shfrytëzojë të drejtën e derogimit që i jepet nga Neni 15(1) i Konventës dhe do të vazhdojë të veprojë kështu deri në njoftim të mëtejshëm."

Lajmërimi për derogim atëherë caktoi dispozitat e Pjesës 4 të Ligjit të Kundër-Terrorizmit, Krimin dhe Sigurisë të vitit 2001.

12. Më 12 nëntor 2001, Ligji i Kundër-Terrorizmit, Krimin dhe Sigurisë, që përmbante klauzolat të cilat eventualisht do të bëheshin Pjesa 4 e Ligjit të

Kundër-Terrorizmit, Krimin dhe Sigurisë të vitit 2001 (“Ligji i vitit 2001”: shih paragrafin 90 poshtë), u paraqit në Dhomën e Komuneve. Ligji u miratua në Parlament brenda dy javësh, pas tre ditësh debat në Dhomën e Komuneve mbi 125 klauzolat e një mocioni kufizues programimi, çka i shtyri Komisionin e Përbashkët të Drejtave të Njeriut dhe Komitetin Përzgjedhës të Çështjeve të Brendshme të ankoheshin në lidhje me shpejtësinë me të cilën u kërkohej ta shqyrtonin çështjen.

13. Ligji i vitit 2001 hyri në fuqi më 4 dhjetor 2001. Gjatë periudhës së legjislacionit, gjashtëmbëdhjetë individë, përfshirë edhe njëmbëdhjetë kërkuesit aktualë, u certifikuan sipas seksionit 21 dhe u ndaluan. Gjashtë kërkuesit e parë u certifikuan më 17 dhjetor 2001 dhe u ndaluan pak kohë më pas. Kërkuesi i shtatë u certifikua dhe u ndalua në fillim të muajit shkurt të vitit 2002; kërkuesi i nëntë më 22 prill 2002; kërkuesi i tetë më 23 tetor 2002; kërkuesi i dhjetë më 14 janar 2003; kërkuesi i njëmbëdhjetë u certifikua më 2 tetor 2003 dhe u mbajt në ndalim pasi kishte qenë paraprakisht i ndaluar sipas një ligji tjetër.

## **B. Procedurat e derogimit**

14. Në procedurat para Komisionit të Posaçëm të Apelit për Imigracion (angl. Special Immigration Appeals Commission, “SIAC”: shih paragrafët 91-93 poshtë), shtatë kërkuesit e parë kontestuan ligjshmërinë e derogimit, duke pretenduar se ndalimi i tyre sipas Ligjit të vitit 2001 përbente shkelje të drejtave të tyre nga Nenet 3, 5, 6 dhe 14 të Konventës. Secili prej tyre, më tej, kontestoi vendimin e Sekretarit të Shtetit për të certifikuar secilin si terrorist ndërkombëtar.

15. Më 30 korrik 2002, pasi shqyrtoi materialin e hapur dhe atë të mbyllur dhe pasi dëgjoi parashtrësarët e avokatëve të posaçëm përveç këshilltarëve të palëve dhe të palës së tretë, Liberty, SIAC mori vendim mbi ligjshmërinë e derogimit. Ai vendosi që, mbi bazën e materialit publik, ishte bindur që kërcënimi nga al’Qaeda kishte krijuar një emergjencë publike që kërcënonte jetën e kombit, në kuptim të Nenet 15 të Konventës, dhe që materiali i mbyllur e kishte konfirmuar këtë pikëpamje.

Më tej, SIAC u shpreh se fakti që synimi për të mbrojtur publikun nga terroristët ndërkombëtarë do të kishte mundur të arrihej përmes metodave alternative nuk tregonte se masat e marra nuk ishin rreptësisht të nevojshme. Për më tepër, meqenëse qëllimi i ndalimit ishte mbrojtja e Mbretërisë së Bashkuar, fakti që i ndaluari ishte i lirë të largohej tregonte se masat ishin hartuar në përputhje me gjendjen e emergjencës.

SIAC i refuzoi ankesat e kërkuesve nga Neni 3 i Konventës. Ai vendosi që, për aq sa ato u referoheshin kushteve të ndalimit të tyre, kërkuesit duhet të hapnin procedura në gjykatat civile, dhe që SIAC nuk kishte juridiksion për të vendosur mbi një ankesë të tillë meqenëse nuk ishte “çështje derogimi”. Më tej, SIAC u shpreh se nuk shihte themel në argumentin e



kërkuesve që ndalimi për një periudhë të pacaktuar ishte në kundërshtim me Nenin 3. Lidhur me këtë pikë, SIAC u shpreh që ndalimi nuk ishte i pacaktuar, meqenëse ai përcaktohej nga kufijtë kohorë të vetë Ligjit të vitit 2001, dhe që nga viti 2001 Ligji në fjalë parashikonte që certifikimi i çdo kërkuesi i nënshtrohej automatikisht shqyrtimit nga SIAC çdo gjashtë muaj. Sidoqoftë, thjesht fakti që nuk ishte caktuar afat për ndalimin parandalues nuk përbënte shkelje të Nenit 3.

SIAC nuk pranoi që Neni 6 ishte i zbatueshëm në procesin e certifikimit. Certifikimi i secilit kërkues si i dyshuar terrorist ndërkombëtar nuk ishte “akuzë” por deklarim i dyshimit dhe procedurat para SIAC-it nuk kishin për qëllim konstatimin e akuzës penale. Për më tepër, nuk bëhej fjalë për të drejta civile përkatëse dhe as Neni 6 nuk ishte i zbatueshëm në aspektin civil.

Megjithatë, SIAC nuk vendosi që derogimi ishte i paligjshëm sepse dispozitat përkatëse të Ligjit të vitit 2001 diskriminonin në mënyrë të pajustificueshme ndaj shtetasve të huaj, në shkelje të Nenit 14 të Konventës. Pushteti i Ligjit të vitit 2001 mund të kufizohej si duhet ndaj jo-shtetasve vetëm nëse kërcënimi vinte ekskluzivisht, ose pothuaj ekskluzivisht, nga jo-shtetasit dhe provat nuk e mbështesnin këtë përfundim. Në paragrafët 94-95 të këtij vendimi, SIAC u shpreh:

“94. Nëse do të ketë derogim nga e drejta për liri e ngërthyer në Nenin 5 për sa u përket terroristëve të dyshuar ndërkombëtarë – dhe ne shohim argumente të fuqishme në favor të një derogimi të tillë – derogimi do të duhej të shtrihej racionalisht tek të gjithë terroristët ndërkombëtarë të dyshuar që nuk mund të zhvendosen. Do të kufizohej si duhet ndaj pjesës së huaj të popullsisë vetëm nëse, siç kundërshton [avokati i kërkuesve], kërcënimi vjen ekskluzivisht apo pothuaj ekskluzivisht nga ajo pjesë e huaj.

95. Por provat para nesh kanë treguar përtej çdo argumentimi që kërcënimi nuk është kaq i kufizuar. Ka shumë shtetas britanikë të identifikuar tashmë – shumica të ndaluar jashtë vendit – të cilët hyjnë në përkufizimin e ‘terroristëve të dyshuar ndërkombëtarë’, dhe ishte e qartë nga parashtrimet që dëgjuam se sipas mendimit të [Sekretarit të Shtetit] ka të tjerë në liri në Mbretërinë e Bashkuar të cilët do të mund të përkufizoheshin në mënyrë të ngjashme. Në këto rrethana, ne nuk mendojmë që derogimi mund të shihet si diçka tjetër përveç se diskriminim mbi bazat e origjinës kombëtare”.

Kështu, SIAC rrëzoi urdhrin e derogimit të 11 nëntorit 2001 dhe lëshoi një deklaratë mospërputhshmërie në lidhje me seksionin 23 të Ligjit të vitit 2001 sipas seksionit 4 të Ligjit të vitit 1998 (shih paragrafin 94 poshtë).

Ai i shtyu apelet individuale të shtatë kërkuesve të parë kundër certifikimit (shih paragrafët 24-69 poshtë) në pritje të rezultatit të apelit të Sekretarit të Shtetit dhe kundër-apelet e kërkuesve lidhur me çështje ligjore kundër vendimit të mësipërm.

16. Më 25 tetor 2002, Gjykata e Apelit mori vendimin e saj (*A. dhe të Tjerët kundër Sekretarit të Shtetit të Departamentit të Brendshëm* [2002] EWCA Civ 1502).

Ajo vendosi që SIAC kishte pasur për detyrë të gjente që ekzistonte një emergjencë publike që kërcënonte jetën e kombit. Megjithatë, ndryshe nga mendimi i SIAC-it, Gjykata vendosi që qasja e ndërmarrë nga Sekretari i Shtetit mund të justifikohet në mënyrë objektive. Ekzistonte një lidhje racionale mes ndalimit të jo-shtetasve të cilët nuk mund të dëboheshin për shkak të frikës për sigurinë e tyre, dhe qëllimit të cilin Sekretari i Shtetit synonte të arrinte, pra zhvendosja e jo-shtetasve që paraqisnin kërcënim për sigurinë kombëtare. Për më tepër, kërkuesit do të ndaloheshin jo më gjatë se ishte e nevojshme para se të dëboheshin ose deri sa emergjenca të zgjidhej apo ata të pushonin së qeni kërcënim për sigurinë e vendit. Nuk kishte diskriminim në kundërshtim me Nenin 14 të Konventës, sepse shtetasit britanikë që dyshoheshin për terrorizëm nuk ndodheshin në situatë të ngjashme me shtetasit e huaj njësoj të dyshuar të cilët nuk mund të dëboheshin për shkak të frikës për sigurinë e tyre. Shtetas të tillë nuk kishin të drejtë të qëndronin në vend por vetëm të drejtën momentale për të mos u zhvendosur për qëllime të sigurisë së tyre. Gjykata e Apelit shtoi se e drejta ndërkombëtare përcaktonte qartë që, në situata të caktuara, Shtetet mund ta bënin dallimin mes shtetasve dhe jo-shtetasve, sidomos në kohë emergjencash. Më tej, ajo përfundoi që Parlamenti kishte pasur për detyrë të kufizonte masat e propozuara në mënyrë që të ndikonin vetëm tek shtetasit e huaj të dyshuar për lidhje terroriste sepse duhet të arrinte në konkluzionin që ndalimi i një klase të kufizuar të shtetasve të huaj me të cilët kishte lidhje masa ishte, në ato rrethana, “rreptësisht i kërkuar” brenda kuptimit të Nenit 15 të Konventës.

Gjykata e Apelit ishte dakord me SIAC që procedurat për të apeluar kundër certifikimit nuk ishin “penale” në kuptim të Nenit 6 § 1 të Konventës. Megjithatë, ajo gjeti që aspekti civil i Nenit 6 ishte i zbatueshëm por që procedurat ishin aq të drejta sa mund të arrihej në masë të arsyeshme. Më tej, ajo vendosi që kërkuesit nuk kishin vërtetuar që ndalimi i tyre përbënte shkelje të Nenit 3 të Konventës.

17. Kërkuesit u lejuan të apelonin në Dhomën e Lordëve, e cila e mori vendimin e saj më 16 dhjetor 2004 ([2004] UKHL 56).

Shumica e Lordëve të Drejtësisë, shprehimisht ose në mënyrë të nënkuptuar, gjeti që ndalimi i kërkuesve sipas Pjesës 4 të Ligjit të vitit 2001 nuk hynte nën ombrellën e përjashtimit nga e drejta e përgjithshme për liri që parashikon Neni 5 § 1(f) i Konventës (shih Lordi Bingham, në paragrafët 8-9; Lordi Hoffman, në paragrafin 97; Lordi Hope, në paragrafët 103-105; Lordi Scott, në paragrafin 155; Lordi Rodger, në paragrafin 163; Baronessa Hale, në paragrafin 222). Lordi Bingham e përmbledhi qëndrimin në këtë mënyrë:

“9. ... Një person që kryen një krim të rëndë sipas ligjit penal të këtij vendi, pa marrë parasysh nëse është shtetas apo jo-shtetas, mund të akuzohet, të gjykohet dhe, nëse dënohet, mund të burgoset. Por një jo-shtetas që përballet me mundësinë e torturës apo trajtimit çnjerëzor nëse kthehet në vendin e tij, dhe i cili nuk mund të

dëbohet në një vend të tretë, dhe nuk është akuzuar për krime, nuk mund, sipas Nenit 5(1)(f) të Konventës dhe Skemës 3 të Ligjit të Imigracionit të vitit 1971, të ndalohet këtu edhe nëse gjykohet se përbën kërcënim për sigurinë kombëtare.”

18. Më tej, Dhoma e Lordëve vendosi, tetë me një (Lordët Bingham dhe Scott me hezitim të konsiderueshëm), që përfundimi i SIAC që ekzistonte një emergjencë publike që kërcënonte jetën e kombit nuk duhej hequr. Lordi Hope i vlerësoi provat si më poshtë:

“118. Ka prova të bollshme në materialin [publik] që tregojnë se qeveria ka qenë krejtësisht e arsyeshme në pikëpamjet e nëntorit 2001 që ekzistonte një emergjencë që kërcënonte jetën e kombit... Mbretëria e Bashkuar ishte në rrezik nga sulmet e rrjetit al’Qaeda i cili kishte kapacitet përmes bashkëpunëtorëve të tij për të shkakuar viktima masive dhe efekte shkatërruese ndaj funksionimit të kombit. Kjo u vërtetua me ngjarjet e 11 shtatorit 2001 në New York, Pensylwania dhe Washington. Kishte një numër të konsiderueshëm shtetasish të huaj në Mbretërinë e Bashkuar të cilët kishin vullnetin dhe kapacitetin e sulmeve të koordinuara këtu të cilat mund të ishin po aq shkatërruese në jetë njerëzish dhe pasuri. Ka pasur të dhëna të shumta të inteligjencës që tregonin se organizatat terroriste ndërkombëtare të përfshira në sulmet e kohëve të fundit dhe në përgatitje për sulme të tjera terroriste kishin lidhje me Mbretërinë e Bashkuar, dhe që ato dhe të tjerë paraqisnin një kërcënim real për këtë vend. Ekziston një masë në rritje provash që tregon përgatitje për përdorimin e armëve të shkatërrimit në masë në këtë fushatë. ...[Zyra e Punëve të Brendshme] konsideron që kërcënimet serioze ndaj kombit mbizotëronin, edhe pse jo ekskluzivisht, dhe më shumë nga kategoria e jo-shtetasve të huaj.

119. Ajo që del qartë nga këto deklarata është gjendja aktuale e emergjencës. Është një emergjencë e cila përbëhet nga kërcënimet që këto sulme do të ndodhin. Ajo kërcënon jetën e kombit për shkak të pasojave të tmerrshme që do të ndikonin tek të gjithë nëse ato ndodhin këtu. Por ende nuk mund të thuhet që këto sulme janë të afërta. Më 15 tetor 2001 Sekretari i Shtetit tha në Dhomën e Komuneve që nuk kishte të dhëna nga inteligjenca që tregonin ndonjë kërcënim specifik ndaj Mbretërisë së Bashkuar: shih Hansard (Debatet HC, col 925). Më 5 mars 2002 ky vlerësim i qëndrimit u përsërit në përgjigjen e qeverisë ndaj Raportit të Dytë të Komisionit të Përzgjedhur të Dhomës së Komuneve për Mbrojtjen ndaj Kërcënimit të Terrorizmit (HC 348, para 13) ku deklaronte që do të ishte e gabuar të thuhet që kishte prova të ndonjë kërcënimet konkret. Nuk do të arrija në përfundimin, nga materialet që kemi parë, që nuk ka emergjencë aktuale. Por do të arrija në përfundimin që emergjenca që paraqesin kërcënimet është e një lloji të ndryshëm, apo në një shkallë tjetër, prej asaj që pa dyshim do të pasonte nëse kërcënimet materializohen ndonjëherë. Provat tregojnë që kjo emergjenca e fundit nuk mund të thuhet se është e afërt. Duhet njohur fakti se, meqenëse sulmet mund të vinë pa paralajmërim, mund të mos jetë e mundur të identifikohet një fazë ku të mund të thuhet se ato janë të afërta. Ky është faktor i rëndësishëm, dhe unë nuk e lë pa përmendur. Por fakti është se faza kur kombi duhet të përballet me atë lloj emergjence, emergjencën e sulmit të afërt, nuk ka ardhur.”

Lordi Hoffman, i cili nuk u pajtua, pranoi që kishte prova të besueshme të një kërcënimet të sulmit terrorist brenda Mbretërisë së Bashkuar, por konsideroi që ai nuk do të shkatërronte jetën e kombit, meqenëse kërcënimet nuk ishte aq themelor sa të kërcënonte “institucionet e qeverisjes së ekzistencës sonë si komunitet civil...”. Ai konkludoi që “kërcënimet i vërtetë ndaj jetës së vendit... nuk vjen nga terrorizmi por nga ligje si këto”.

19. Lordët e tjerë të Drejtësisë (Lordët Bingham, Nicholls, Hope, Scott, Rodger, Carswell dhe Baronsha Hale, ku Lordi Walker kundërshtoi) e refuzuan parashtrësën e Qeverisë sipas së cilës i takonte Parlamentit dhe ekzekutivit, e jo gjykatave, që ta gjykonin përgjigjen e nevojshme ndaj mbrojtjes së sigurisë publike. Lordi Bingham i shprehu pikëpamjet e tij në këtë mënyrë:

“42. Nga kjo analizë del se kërkuesit, sipas mendimit tim, kanë të drejtë t’i ftojë gjykatat që të shqyrtojnë, mbi baza proporcionaliteti, Urdhrin e Derogimit dhe përputhshmërinë me Konventën në seksionin 23 [të Ligjit të vitit 2001] dhe gjykatat nuk përjashtohen efektivisht, nga ndonjë doktrinë nderi, prej analizimit të thellë të çështjeve të ngritura. Po ashtu, del se unë nuk e pranoj tërësinë e plotë të parashtrimeve të Prokurorit të Përgjithshëm. Në mënyrë të veçantë nuk pranoj dallimin që bën ai mes institucioneve demokratike dhe gjykatave. Natyrisht është e vërtetë që në këtë vend gjyqtarët nuk zgjidhen dhe nuk i japin llogari Parlamentit. Gjithashtu është e vërtetë që ...Parlamenti, ekzekutivi dhe gjykatat kanë funksione të ndryshme. Por funksioni i gjyqtarëve të pavarur të ngarkuar me interpretimin dhe zbatimin e ligjit njihet universalisht si tipar themelor i një shteti demokratik modern, një gurthemel i vetë sundimit të ligjit. Prokurori i Përgjithshëm ka të drejtë të plotë të ngulë këmbë mbi kufijtë e duhur të autoritetit gjyqësor, por ai gabon kur stigmatizon vendimmarrjen gjyqësore si deri diku jo-demokratike. Është posaçërisht pa vend në një rast si ky, në të cilin Parlamenti ka miratuar ligj në seksionin 6 të Ligjit të vitit 1998, të bëhet i paligjshëm çdo akt i autoritetit publik, përfshirë gjykatën, i papërputhshëm me një të drejtë të Konventës; i ka kërkuar gjykatave (në seksionin 2) të marrin parasysh jurisprudencën përkatëse të Strasburgut; u ka kërkuar (në seksionin 3) gjykatave, për aq sa është e mundur, t’u japin fuqi të drejtave të Konventës, dhe ka lejuar të drejtën e apelit në rastet e çështjeve të derogimit. Efekti natyrisht nuk është që të refuzohet autoriteti sovran ligjvënës i Mbretëreshës në Parlament, meqenëse nëse legjislacioni deklarohet i papërputhshëm, vlefshmëria e legjislacionit mbetet e pandryshuar (seksioni 4(6)) dhe zgjidhja gjendet tek ministri përkatës (seksioni 10), i cili jep llogari para Parlamentit. Ligji i vitit 1998 u jep gjykatave një mandat shumë të veçantë, krejtësisht demokratik.”

20. Kështu, shumica shqyrtoi nëse regjimi i ndalimit sipas Pjesës 4 të Ligjit të vitit 2001 ishte përgjigje e përshtatshme ndaj situatës së emergjencës, dhe arriti në përfundimin që ajo nuk e zgjidhte dot racionalisht kërcënimin e sigurisë dhe ishte një përgjigje jo-proporcionale me atë kërcënim. Ata u mbështetën në tre parime bazë: së pari, fakti që skema e ndalimit zbatohet vetëm tek jo-shtetasit e dyshuar për terrorizëm ndërkombëtar dhe nuk i adresohet kërcënimit nga shtetas të Mbretërisë së Bashkuar që ishin njësoj të dyshuar; së dyti, fakti që linte të dyshuarit terroristë ndërkombëtarë të lirë për t’u larguar nga Mbretëria e Bashkuar dhe për të vazhduar aktivitetet e tyre kërcënuese jashtë shtetit; së treti, fakti që legjislacioni ishte hartuar shumë gjerë, dhe nuk mund, parimisht, të gjente zbatim tek individët e dyshuar për përfshirje në organizata terroriste ndërkombëtare, çka nuk hyn në hapësirën e derogimit.

Lidhur me pikën e parë, Lordi Bingham theksoi që gjetjet e SIAC-it që kërcënimin terrorist nuk kufizohet me jo-shtetasit nuk ishte kontestuar. Meqenëse SIAC ishte tribunali përgjegjës faktmbledhës, ishte e

panevojshme të analizohej baza e gjetjeve të tij, por kishte prova që “mbi një mijë individë nga Mbretëria e Bashkuar vlerësohen nga të dhënat e inteligjencës të kenë marrë pjesë në kampe trajnimi në Afganistan gjatë pesë viteve të fundit”; që disa shtetas britanikë thuhej se kishin planifikuar të ktheheshin nga Afganistani në Mbretërinë e Bashkuar; dhe që materialet lidhur me kërkuesit tregonin nivel të lartë përfshirjeje të shtetasve britanikë dhe atyre të lidhur me Mbretërinë e Bashkuar në rrjetet terroriste. Lordi Bingham vazhdoi:

“33. ... Është e dukshme që seksionet 21 dhe 23 të Ligjit të vitit 2001 nuk i adresohen kërcënimeve të paraqitura nga shtetasit britanikë meqenëse ato nuk parashikojnë certifikimin dhe ndalimin e shtetasve të Mbretërisë së Bashkuar. Natyrisht që seksionet e tjera të Aktit të vitit 2001 dhe Ligjit të vitit 2000 zbatohen edhe tek shtetasit e Mbretërisë së Bashkuar, meqenëse ata nuk janë subjekt derogimi, nuk janë subjekt ankesash dhe zbatohen njësoj tek shtetasit e huaj. E megjithatë kërcënimi nga shtetasit e Mbretërisë së Bashkuar, nëse është më i vogël në sasi, nuk është më ndryshe në cilësi nga kërcënimi që vjen nga shtetasit e huaj. Po ashtu, është e qartë se seksionet 21 dhe 23 faktikisht i lejojnë një personi të certifikuar dhe të ndaluar të largohet nga Mbretëria e Bashkuar dhe të shkojë në një vend tjetër që e pranon, siç bënë dy prej kërkuesve kur u larguan nga Maroku dhe Franca, respektivisht... Një liri e tillë për t'u larguar është krejtësisht e shpjegueshme për sa i përket kontrollit të imigracionit: nëse autoritetet britanike duan të dëbojnë një shtetas të huaj por nuk mund ta dëbojnë në vendin 'A' për shkak se (*Chahal*) qëllimi i tyre po ashtu shërbehet nga kthimi i tij i vullnetshëm në vendin 'B'. Por lejimi i një terroristi ndërkombëtar për t'u larguar nga brigjet tona dhe për t'u nisur drejt një vendi tjetër, ndoshta një vend aq afër sa Franca, për të vazhduar me planet e tij kriminale, është e vështirë të mendohet paralelisht me besimin në kapacitetin e tij për të shkaktuar lëndime të rënda ndaj njerëzve dhe interesave të këtij vendi...

35. Hapi i pestë në argumentet e kërkuesve lejon pak shtjellim. Por duket e arsyeshme të presupozohet se ata terroristë të dyshuar ndërkombëtarë që janë shtetas të Mbretërisë së Bashkuar nuk injorohen nga autoritetet. Kur [kërkuesi i pestë] u lirua nga burgu me dorëzani nga SIAC..., kjo u bë me kusht që (mes të tjerash) ai të mbante pajisjen shënjuese elektronike gjatë gjithë kohës; që ai të qëndronte në ambientet e tij të banimit gjatë gjithë kohës; që ai të telefononte në një kompani sigurie pesë herë në ditë në kohë të caktuara; që ai t'i lejonte kompanisë të instalonte pajisje vëzhguese në ambientet e tij të banimit; që ai t'ia kufizonte hyrjen në banesën e tij familjarëve të tij, këshilltarit të tij juridik, personave që kujdeseshin për shëndetin e tij, dhe personave të tjerë të miratuar; që ai të mos kishte kontakte me persona të tjerë; që ai të mos kishte në banesën e tij kompjuter, celular apo pajisje të tjera elektronike komunikimi; që ai të shkyçte lidhjen ekzistuese telefonike në banesën e tij; që ai të instalonte një lidhje telefonike të dedikuar që i lejonte kontakte vetëm me kompaninë e sigurisë. Kërkuesit sugjeruan që këto lloj kushtesh, të zbatuara rreptësisht, do të ndalonin aktivitetin terrorist. Është e vështirë të mendohet përse nuk do të ishte kështu.

36. Në theksimin e rëndësisë themelore të së drejtës për liri personale, si hapi i gjashtë në argumentin e tyre lidhur me proporcionalitetin, kërkuesit arritën të argumentonin traditën e gjatë libertare të së drejtës angleze, që nga kapitulli 39 i Magna Cartas së vitit 1215, e cila merr zbatim nga mjeti i vjetër i habeas corpus, deklaruar në Peticionin e së Drejtës të vitit 1628, miratuar në një sërë vendimesh të rëndësishme përgjatë shekujve dhe ngërthyer në substancën dhe procedurën e së drejtës në ditët tona. ...Në trajtimin e saj të Nenit 5 të Konventës Europiane, Gjykata Europiane gjithashtu ka njohur rëndësinë parësore të lirisë personale...

43. Kontestimi i proporcionaliteti nga kërkuesit ndaj Urdhrit dhe seksionit 23, sipas mendimit tim, është i shëndoshë, për të gjitha arsyet që japin ata dhe për arsyet e dhëna nga Komisioneri për të Drejtat e Njeriut dhe Komisioni i Newtonit. Prokurori i Përgjithshëm nuk arriti të jepte një përgjigje bindëse.”

21. Përveç kësaj, shumica vendosi që Akti i vitit 2001 ishte diskriminues dhe i papërputhshëm me Nenin 14 të Konventës, nga i cili nuk kishte pasur derogim. Kërkuesit ndodheshin në një situatë të krahasueshme me shtetasit e Mbretërisë së Bashkuar të dyshuar si terroristë ndërkombëtarë, me të cilët ata kishin të përbashkëta karakteristikat e të qenit të pazhvendosshëm nga Mbretëria e Bashkuar dhe të konsideruarit kërcënim për sigurinë kombëtare. Meqenëse skema e ndalimit synonte fillimisht mbrojtjen e Mbretërisë së Bashkuar nga sulmet terroriste, e jo kontrollin e imigracionit, nuk kishte arsye objektive që kërkuesit të trajtoheshin ndryshe mbi bazat e kombësisë së tyre apo statusit të tyre të imigracionit.

22. Megjithëse apeli i kërkuesve përfshinte ankesa nga Nenet 3 dhe 16 të Konventës, Dhoma e Lordëve nuk e konsideroi të nevojshme të përcaktoheshin ato ankesa, meqenëse gjeti që derogimi ishte i paligjshëm mbi baza të tjera.

23. Ajo lëshoi një urdhrë anulimi lidhur me urdhrin e derogimit, dhe një deklaratë sipas seksionit 4 të Ligjit të të Drejtave të Njeriut (shih paragrafin 94 poshtë) që seksioni 23 i Ligjit të vitit 2001 ishte i papërputhshëm me Nenet 5 § 1 dhe 14 të Konventës po aq sa ishte në disproporcion dhe lejonte ndalimin diskriminues të terroristëve të dyshuar ndërkombëtarë.

### C. Procedurat e certifikimit: vendimi “i përgjithshëm” dhe apelet

24. Ndërkohë, seanca dëgjimore e SIAC mbi apelet individuale të kërkuesve kundër certifikimit filloi në maj 2003, pasi që Gjykata e Apelit e kishte dhënë vendimin në procedurat e derogimit por para marrjes së vendimit të mësipërm nga Dhoma e Lordëve.

25. Për qëllime të secilit apel drejtuar në SIAC, Sekretari i Shtetit depozitoi një “deklaratë të hapur” me përmbledhje të fakteve lidhur me vendimin për të certifikuar secilin kërkues dhe sa më shumë prova mbështetëse të cilat Sekretari i Shtetit konsideronte se mund të zbuloheshin pa shkaktuar ndonjë rrezik për sigurinë kombëtare. Më tej, para SIAC u depozitua edhe një deklaratë “e mbyllur” e fakteve dhe provave për secilin rast.

26. Më 29 tetor 2003, SIAC lëshoi një vendim “të përgjithshëm” në të cilin shënonte disa gjetje të zbatimit të përgjithshëm ndaj të gjitha apeleve kundër certifikimit.

Për sa u përket çështjeve paraprake, ai gjeti, *inter alia*, që kishte juridiksion për të dëgjuar një apel kundër certifikimit edhe kur personi i certifikuar ishte larguar nga Mbretëria e Bashkuar dhe certifikata ishte revokuar. Ai shënoi që testeve nëse ekzistonin bazat e arsyeshme për

dysheimin që një person ishte “terrorist” dhe për besimin që prania e tij në Mbretërinë e Bashkuar përbente rrezik për sigurinë kombëtare, në kuptim të seksionit 21 të Ligjit të vitit 2001, “në njëfarë mënyre u mungonin prova qoftë edhe për ekuilibrin e probabiliteteve”. Më tej, ai vërejti që “bazat e arsyeshme mund të mbështeteshin mbi materiale të cilat nuk do të ishin të pranueshme në një proces gjyqësor normal në gjykatë, siç janë provat e dëgjua nga një informator i pidentifikuar”. Pësha që do t’i jepej çdo lloj prove të vetme ishte çështje konsiderate duke marrë parasysh të gjitha provat në tërësi. Informacione të cilat mund të ishin marrë me anë të torturës nuk do të përjashtoheshin automatikisht, por gjykata duhet të merrte parasysh çdo provë në lidhje me mënyrën se si është marrë dhe të gjykojnë peshën dhe besueshmërinë e secilës përkatësisht.

SIAC deklaroi që dispozitat e ndalimit në Ligjin e vitit 2001 duhet të interpretohen nën dritën e kushteve të derogimit. Kërcënimi ndaj jetës së kombit nuk kufizohet me aktivitete brenda Mbretërisë së Bashkuar, sepse jeta e kombit përfshinte aktivitetet diplomatike, kulturore dhe turistike të tij jashtë vendit. Për më tepër, sulmet ndaj aleatëve të Mbretërisë së Bashkuar po ashtu mund të krijonin rrezik ndaj Mbretërisë së Bashkuar, duke pasur parasysh ndërvarësinë e vendeve që përballen me kërcënimin global të terrorizmit. Derogimi identifikoi kërcënimin si i tillë që vinte nga al’Qaeda dhe bashkëpunëtorët e saj. Prandaj, ishte e nevojshme, për sa u përket aspekteve të “sigurisë kombëtare” dhe “terroristit ndërkombëtar” të seksionit 21 të Ligjit të vitit 2001, që të tregoheshin baza të arsyeshme për dyshimin që personi i identifikuar ishte pjesë e një grupi i cili ishte i lidhur, direkt ose indirekt, me al’Qaedën. Edhe sikur fokusi kryesor i grupit në fjalë të ishte një betejë kombëtare, nëse ai përkrahte al’Qaedën në një pjesë të axhendës së saj dhe individi pavarësisht nga kjo mbështeste grupin, atëherë nënkuptohej në mënyrë legjitime që ai përkrahte dhe ndihmonte al’Qaedën.

SIAC po ashtu paraqiti një sërë gjetjesh faktike të zbatimit të përgjithshëm lidhur me organizatat që Sekretarja e Shtetit pretendonte se kishin lidhje me al’Qaedën. Këto gjetje bazoheshin si mbi materiale “të hapura”, ashtu edhe mbi materiale “të mbyllura”. Kështu, ai deklaroi që Grupi Salafist për Thirrje dhe Luftim (GSPC), i formuar në Algjeri në vitin 1998, ishte një organizatë terroriste e cila kishte lidhje me al’Qaedën përmes stërvitjeve dhe financimit, por që organizata e mëparshme algjerieane, Grupi i Armatosur Islamik (GIA) nuk ishte e tillë. Xhahadi Islamik Egjiptian (EIJ) ishte ose pjesë e al’Qaedës, ose i lidhur shumë ngushtë me të. Muxhahedinët Çeçeno-Arabë ishin një grup terrorist ndërkombëtar që ndiqte një axhendë anti-perëndimore përtej luftës për pavarësinë e Çeçenisë, me lidhje të afërta me al’Qaedën. SIAC po ashtu identifikoi si të atillë që ishte brenda kushteve të derogimit një grup të përbërë kryesisht nga ekstremistë algjerianë të përqendruar rreth Abu Doha, algjerian që kishte jetuar në Mbretërinë e Bashkuar që nga viti 1999. Pretendohej që Abu Doha kishte pasur një rol të lartë në kampet stërvitore në Afganistan dhe kishte

shumë kontakte me al'Qaedën, përfshirë edhe lidhje me celulën në Frankfurt e cila ishte akuzuar për vendosjen e bombës në tregun e Krishtlindjeve në Strasburg në dhjetor të vitit 2000. Abu Doha u arrestua në shkurt 2001, pas një kërkesë për ekstradim nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por grupi i tij vazhdoi të ishte aktiv.

27. Kërkuesit apelian kundër vendimit të SIAC që provat të cilat mund të ishin përftuar me anë të torturës ishin të pranueshme. Për qëllime të apelit, palët ranë dakord që procedurat para SIAC për kontestimin e certifikimit ishin brenda hapësirës së nenit 5 § 4 të Konventës dhe, si të tilla, duhet të përmbushnin kriteret bazë të një gjyqi të drejtë. Prandaj, nuk ishte e nevojshme të vendosej nëse Neni 6 ishte po ashtu i zbatueshëm dhe çështja u la e hapur.

Më 11 gusht 2004, Gjykata e Apelit, me shumicë, e miratoi vendimin e SIAC ([2004] EWCA Civ 1123).

Më 8 dhjetor 2005, Dhoma e Lordëve u shpreh njëzëri që provat e marra përmes torturës nga një i dyshuar apo dëshmitar ishin konsideruar për një kohë të gjatë si qenësisht të pabesueshme, të padrejta, fyese për standardet bazë të njerëzimit dhe mirësjelljes, dhe të papërputhshme me parimet mbi të cilat gjykata duhet të ushtrojë drejtësinë. Rrjedhimisht, prova të tilla mund të mos pranoheshin në mënyrë të ligjshme kundër një pale në procedurat brenda një gjykate të Mbretërisë së Bashkuar, pavarësisht se ku, nga kush dhe nën autoritetin e kujt ishin shkaktuar ato tortura. Meqenëse personi që kontestonte certifikimin kishte pasur vetëm qasje të kufizuar në materialet e paraqitura kundër tij në procedurat para SIAC-it, prej tij nuk pritej më shumë sesa dhënia e një arsyeje të mundshme që materiali mund të ishte përftuar në atë mënyrë dhe më pas i takonte SIAC-it të fillonte hetimet përkatëse. Prandaj, Dhoma e Lordëve i lejoi apelet e kërkuesve dhe ia përcolli secilën çështje SIAC-it për rishqyrtim ([2005] UKHL 71).

28. Përfundimet e SIAC për sa i përket çështjes së secilit kërkues parashtrohen në paragrafët 29-69 poshtë. Nga gjashtëmbëdhjetë individë, përfshirë njëmbëdhjetë kërkuesit, të ndaluar sipas Pjesës 4 të Ligjit të vitit 2001, njërit iu anulua certifikata nga SIAC.

#### **D. Procedurat e certifikimit: përcaktimet individuale**

##### *1. Kërkuesi i parë*

29. Kërkuesi i parë kishte lindur në një kamp refugjatësh palestinezë në Jordani, dhe kishte fituar leje qëndrimi për një kohë të pacaktuar në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 1997. Më 17 dhjetor 2001, kërkuesi i parë u certifikua nga Sekretari i Shtetit si terrorist ndërkombëtar i dyshuar sipas seksionit 21 të Ligjit të vitit 2001. Më 18 dhjetor 2001, u mor një urdhër dëbimi mbi të njëjtat baza.



30. Kërkuesi i parë u ndalua më 19 dhjetor 2001. Pas kësaj ai apeloj tek SIAC kundër certifikimit dhe vendimit për marrjen e urdhrin të dëbimit. Më 24 korrik 2002, ai u transferua në Spitalin e Sigurisë për të Sëmuretë Mendorë në Broadmoor.

31. Kërkuesi i parë dhe përfaqësuesit e tij morën materialin “e hapur” nga Sekretari i Shtetit, përfshirë edhe një raport policor që tregonte se shuma të mëdha parash kishin lëvizur nëpër katër llogari bankare në emrin e tij. SIAC dhe avokati special i udhëzuar në emër të kërkuesit të parë më tej prezantuan prova “të mbyllura”. Kërkuesi i parë dha dëshmi verbale në SIAC, me ndihmën e një përkthyesi, dhe thirri një dëshmitar për të dëshmuar lidhur me karakterin e tij të mirë. Gjithashtu, ai depozitoi katër raporte mjekësore lidhur me shëndetin e tij mendor. SIAC vërejti në vendimin e tij të datës 29 tetor 2003:

“Jemi thellësisht të vetdijshëm që materiali i hapur që shërben si bazë kundër kërkuesit është shumë i përgjithshëm dhe që çështja varet kryesisht nga konstatimet të cilat janë gjerësisht të pambështetura. Pretendimi qendror është që ai ka qenë i përfshirë në mbledhjen e fondeve dhe në shpërndarjen e atyre fondeve për grupet terroriste të lidhura me al’Qaedën. Gjithashtu, thuhet se ai ka paraqitur dokumentacion fals dhe ka ndihmuar lehtësimin e lëvizjeve të vullnetarëve të Xhihadit drejt kampeve stërvitore në Afganistan. Ai thuhet se është i përfshirë nga afër me ekstremistë të rangut të lartë dhe bashkëpunëtorë të Osama Bin Ladenit si në Mbretërinë e Bashkuar, ashtu edhe jashtë saj. Argumenti i tij është dhe ka qenë gjithmonë që ai merret vetëm me projekte lidhur me ndihma sociale, në mënyrë të veçantë me një shkollë në Afganistan për fëmijët e arabisht-folësve atje, dhe projekte si ndërtimi i puseve dhe furnizimi me ushqim i komuniteteve në Afganistan. Ai gjithashtu ka mbledhur para për refugjatët nga Çeçenia. Çdo kontakt me të ashtuquajturit ekstremistë ka qenë në këtë kontekst, dhe ai nuk kishte arsye të besonte se ata ishin terroristë apo që ishin të interesuar për terrorizëm.

Ne i njohim vështirësitë reale që ka Kërkuesi në bërjen e këtij apeli. Ne kemi bërë lëshimet e duhura në lidhje me këto vështirësi dhe problemet e tij mendore. Ne shënojmë shqetësimet [e këshilltarit të tij] që ka pasur një mbithjeshtim madhor nga Shërbimet e Sigurimit të situatës e cila është, parashtron ai, tepër komplekse dhe me tendenca që presupozojnë se çdo mysliman i devotshëm që beson se mënyra e jetesës e praktikuar nga Talebanët në Afganistan është mënyra e vërtetë që duhet ndjekur duhet të jetë i dyshuar. Po ashtu, shënojmë që fillimisht Pala Përgjegjëse konstatoi që të gjitha aktivitetet fondmbledhëse të Kërkuesit ishin bërë me qëllim që të ndihmohej terrorizmi dhe që vetëm pasi Kërkuesi paraqiti prova për të treguar se kishte synime legjitime bamirësie ai e pranoi që të paktën një pjesë e parave ishte mbledhur për ato qëllime. Për sa kohë që u besohet lidhjeve me individë të cilëve u dihen emrat, ne kemi parasysh që disa prej tyre, të cilët akuzohen për përfshirje në terrorizëm, kanë apele në pritje... dhe që pretendimet kundër të tjerëve nuk janë testuar e as lidhjet e pretenduara nuk ka qenë e mundur të shpjegohen.

...

[Avokati i kërkuesit të parë] pranoi pabesueshmërinë e provave të Kërkuesit lidhur me lëvizjet e tij në vitet 1990, por na kërkoi që të mos e përdornim këtë kundër tij për shkak të gjendjes së tij mendore. Ne nuk mund ta bëjmë këtë. Gënjeshtrat ishin një përpjekje e qëllimshme për të kundërshtuar pretendimin që ai kishte qenë muxhahid në Afganistan, duke thënë se kishte kaluar tre vjet në një burg jordanez. Ka pasur një

mbideklarim nga policia lidhur me shumën e përfshirë në llogaritë bankare. Këtë e pranojmë, por sidoqoftë ishte një shumë e konsiderueshme ajo që ka kaluar nëpër ato llogari bankare. Dhe [avokati i kërkuesit] parashtrroi që pretendimi ishte se ai kishte paraqitur dokumentacion fals për të tjerët e jo për veten e tij. Kështu, pasaporta e tij fals irakiane ishte jo-materiale. Megjithatë, kjo tregon mundësinë për marrjen e një pasaporte fals. [Avokati i kërkuesit] sulmoi besueshmërinë e inteligjencës së marrë për bazë kundër Kërkuesit meqenëse ishte pranuar me vonesë që ai kishte qenë i përfshirë në punë vërtet bamireshë dhe që disa nga paratë që kalonin përmes llogarisë së tij dhe të mbledhura nga ai shërbenin për këtë qëllim. Ne njohim rrezikun që të gjitha aktivitetet e ndërmarra nga një person i dyshuar mund të shihen si të dyshimta dhe që mund të mos i jepet konsideratë e drejtë të gjithë materialit për të parë nëse vërtet ai e mbështet dyshimin. Ne e kemi shqyrtuar të gjithë materialin, në mënyrë të veçantë materialin që është i mbyllur, me atë rrezik në mendje.

Siç kemi thënë, provat e hapura të marra në izolim nuk mund të ofrojnë arsyet për të cilat ne e hedhim poshtë këtë ankesë dhe i kuptojmë shqetësimet e [avokatit të kërkuesit të parë] që ai ka pasur një detyrë shumë të vështirë. Nuk na la mbresa kërkuesi si dëshmitar, pavarësisht se e kuptonim gjendjen e tij mendore dhe vështirësitë me të cilat ai përballëj. Ai ishte shpesh evaziv dhe i turbullt, dhe dihet që ka folur gënjeshtër në lidhje me lëvizjet e tij në vitet 1990. Shpjegimet e tij lidhur me disa nga transaksionet e regjistruara në llogaritë e tij bankare e kemi pasur të vështirë t'i kuptonim apo t'i pranonim. Duhet të themi se nuk konsiderojmë që argumentet e Palës Përgjegjëse avancohen aq shumë nga ajo që është thënë lidhur me përfshirjen e Kërkuesit në Algjeri apo Çeçeni; çështja varet në provat lidhur me marrëdhëniet e Kërkuesit me Afganistanin dhe me terroristët të njohur për lidhjet me al'Qaedën.

Është e qartë e Kërkuesi ishte një fondmbledhës i suksesshëm dhe, më së rëndësishmi, ai e kishte mundësinë t'i dërgonte paratë në Afganistan. Pavarësisht nga problemet e tij, ai ishte në gjendje dhe atij i besohej që të ofronte një shërbim efikas. Shpjegimet e tij se kush ishin terroristët të njohur fëmijët e të cilëve ishin në shkollë dhe mbi pagesat e ndryshme më substanciale që shiheshin në llogaritë bankare nuk janë bindëse. Ai ishte i paqartë aty ku, duke pasur parasysh akuzat kundër tij, do të kishim pritur disa detaje.

...

Ne i kemi shqyrtuar të gjitha provat me sy kritik. Materiali i mbyllur e konfirmon pikëpamjen tonë që certifikimi në këtë rast ka qenë i saktë. Ekziston edhe besimi i arsyeshëm që prania e Kërkuesit në Mbretërinë e Bashkuar përbën rrezik ndaj sigurisë kombëtare, edhe dyshimi i arsyeshëm që ai është terrorist brenda kuptimit të seksionit 21 të Ligjit të vitit 2001. Rrjedhimisht, ky apel rrëzohet.”

32. Në përputhje me kushtet e Ligjit të vitit 2001, çështja e kërkuesit të parë u shqyrtua nga SIAC pas gjashtë muajsh. Në vendimin e tij të datës 2 korrik 2004, SIAC gjeti që:

“Materiali i hapur i përgjithshëm i përditësuar... vazhdon të tregojë që ekziston një kërcënim i drejtpërdrejtë terrorist ndaj Mbretërisë së Bashkuar nga një grup ose grupe ekstremistësh islamikë kryesisht veri-afrikanë, të lidhur në mënyra të ndryshme me al'Qaedën.

Megjithëse disa prej kontakteve të tij janë ndaluar, natyra e ekstremistëve ekzistues në grupe të ndryshme ishte e tillë që ai nuk do ta kishte të vështirë dhe vazhdon të ketë vullnetin dhe mundësinë e vazhimit të eksperiencës së tij të konsiderueshme në përkrahjen logjistike të tyre në vijim të axhendës ekstremiste islamike në Mbretërinë e Bashkuar. Certifikata mbetet ashtu siç është.”

33. SIAC e shqyrtoi çështjen përsëri më 15 dhjetor 2004 dhe gjeti përsëri që certifikata do të mbetej ashtu siç ishte.

## 2. Kërkuesi i dytë

34. Kërkuesi i dytë është shtetas i Marokut i lindur më 28 shkurt 1996. Ai ka hyrë në Mbretërinë e Bashkuar si vizitor në vitin 1985 dhe i është lejuar qëndrimi si student. Më 21 qershor 1988 atij iu lejua qëndrimi në kohë të pacaktuar për shkak të martesës së tij me një shtetase britanike, martesë e cila më pas u prish. Në vitin 1990 dhe përsëri në vitin 1997 ai aplikoi për natyralizim, por lidhur me këto aplikime nuk u mor asnjë vendim. Në vitin 2000 ai u martua me një shtetase tjetër britanike me të cilën ka një fëmijë.

35. Më 17 dhjetor 2001, kërkuesi i dytë u certifikua nga Sekretari i Shtetit si i dyshuar terrorist ndërkombëtar sipas seksionit 21 të Ligjit të vitit 2001. Në të njëjtën datë u mor një urdhër dëbimi. Kërkuesi i dytë u ndalua më 19 dhjetor 2001. Ai apeloj kundër certifikimit dhe urdhrin për dëbim, por pavarësisht nga kjo zgjodhi të largohej nga Mbretëria e Bashkuar për në Marok më 22 dhjetor 2001. Ai i vazhdoi apelet e tij nga Maroku.

36. Argumentet “e hapura” kundër kërkuesit të dytë u përmbledhën nga SIAC në vendimin e datës 29 tetor 2003, si më poshtë:

“(1) ai ka lidhje edhe me GIA-n, edhe me GSPC [grupe terroriste algjeriane: shih paragrafin 26 lart] dhe është bashkëpunëtor i afërt i disa ekstremistëve islamikë të lidhur me al’Qaedën dhe/ose Bin Laden.

(2) ai është përfshirë në përgatitjen dhe/ose nxitjen e akteve të terrorizmit ndërkombëtar duke ofruar pajisje të teknologjisë së lartë (përfshirë pajisje komunikimi) për GSPC dhe/ose ekstremistë islamikë në Çeçeni nën udhëheqjen e Ibn Khattab, dhe gjithashtu ka siguruar edhe veshje për këtë grupin e fundit.

(3) ai ka mbështetur një apo më shumë fraksione të GIA, GSPC dhe Ibn Khattab në Çeçeni përmes përfshirjes së tij në mashtrim të kryer me qëllim të lehtësimit të financimit të ekstremistëve dhe ruajtjes e administrimit të videove propaganduese që promovojnë xhihadin.

Argumenti i hapur i Sekretarit të Shtetit i shtjellon këto pretendime dhe më tej tregon përdorimin e të paktën një pseudonimi dhe një modeli të asociuar me individë të njohur ose të vlerësuar si njerëz të përfshirë në terrorizëm [pesë individë janë identifikuar]. Të gjithë u përshkruan nga [këshilltari i Sekretarit të Shtetit] si ‘ekstremistë të njohur islamikë algjerianë’.

Dëshmitari B [i Sekretarit të Shtetit] konfirmoi që pretendimi kundër [kërkuesit të dytë] ishte se ai ishte anëtar i një rrjeti, e jo anëtar i ndonjë organizate të veçantë siç është GSPC apo GIA”.

SIAC vazhdoi të shpjegonte gjetjet kundër kërkuesit:

“Ashtu si kërkuesit e tjerë, [kërkuesi i dytë] nuk akuzohet në këto procedura për një seri veprash individuale. Çështja është nëse, po të marrim provat në tërësi, është e arsyeshme që ai të dyshohet si terrorist ndërkombëtar (sipas përkufizimit). Kur e shohim materialin që kemi përpara, ne e trajtojmë në mënyrë kumulative. Mund të ndodhë që materiali lidhur vetëm me mashtrimin, apo vetëm me veshjet, apo vetëm

me videot, apo vetëm me asociimet, në vetvete nuk do të vërtetonte që një person është i përfshirë në çfarëdo mënyre në terrorizëm apo në mbështetjen e terrorizmit. Por ne duhet të vlerësojmë situatën kur gjenden faktorë të kombinuar tek i njëjti person. Këto faktorë janë si vijon. Së pari, është përfshirja e tij në vepra mashtrimi, për të cilat ai duhet të jetë i vetdijshëm por për të cilat ai nuk tenton të ofrojë shpjegim, duke u shfajësuar me sa duket me faktin që ai nuk është në dijeni se cilin akt apo cilat akte konkrete ka në mend Sekretari i Shtetit. Së dyti, ai ka qenë i përfshirë në ndërgjegjësimin (e domethënë në mbledhjen e parave) lidhur me luftimet në Çeçeni, dhe këtë e ka bërë në një kontekst posaçërisht islamik (e jo thjesht humanitar), duke përdorur dhe shpërndarë filma të cilët, sipas provave që kemi përpara, zakonisht gjenden në komunitetet ekstremiste. Në kuadër të provave të përgjithshme kemi shqyrtuar edhe Muxhahedinët Çeçeno-Arabë dhe domethënien e mbështetjes për ta e cila, me sa kuptuam ne, është dhënë duke qenë në dijeni të plotë për planet e tyre më të gjera xhihadiste... [Ai] ka vepruar kështu si bashkëpunëtor i afërt i Abu Doha. Duke pasur parasysh informacionet që kemi për Abu Doha, tek të cilat, siç e kemi thënë, nuk kemi arsye të dyshojmë, ne e konsiderojmë pretendimin e [kërkuesit të dytë] që Abu Doha nuk po bënte asgjë të paligjshme (përveç faktit që fshihte aktivitetet e tij nga rusët) si krejtësisht të pabesueshëm... [Ai] ka pasur bashkëpunime me disa individë të tjerë të përfshirë në terrorizëm. Pjesa më e madhe e tyre janë të përmendur me emra në argumentet e hapura, por nuk përmenden në vetë deklaratën e tij...

Ka pesë karakteristika të cilat përmbushen në [kërkuesin e dytë]. Pa dyshim që Sekretari i Shtetit do të kishte mundur të argumentonte duke demonstruar kombinimet e ndryshme të tyre brenda një personi të vetëm. Me të pesta bashkë, ne e shohim argumentin si bindës. Jemi plotësisht të bindur që Sekretari i Shtetit është i arsyeshëm në dyshimin e tij që [kërkuesi i dytë] mbështet ose ndihmon GIA, GSPC dhe grupin jo aq të organizuar rreth Abu Doha, dhe në besimin e tij që çdo herë që [kërkuesi i dytë] ndodhet në Mbretërinë e Bashkuar, prania e tij përbën rrezik ndaj sigurisë kombëtare.”

### 3. Kërkuesi i tretë

37. Kërkuesi i tretë është shtetas tunizian, i lindur në vitin 1963 dhe banues në Mbretërinë e Bashkuar që nga viti 1994. Ai u certifikua nga Sekretari i Shtetit më 18 dhjetor 2001 dhe u ndalua po atë ditë.

38. Në vendimin e tij të datës 29 tetor 2003, ku rrëzohej apeli i kërkuesit të tretë kundër certifikimit, SIAC vërejti:

“Argumentet kundër Kërkuesit, siç përvijohen në materialin e hapur, janë se ai është anëtar kyç i një grupi ekstrem islamik të njohur si Grupi Luftëtar i Tunizisë (angl. TFG). Thuhet që ky grup është formuar gjatë vitit 2000 dhe fillimet e tij vinë nga Frontin Islamik Tunizian (i njohur si FIT meqenëse emri është në frëngjisht). Më tej, ai konstatoi që Kërkuesi ka mbajtur kontakte të rregullta me disa ekstremistë të njohur, përfshirë edhe disa që kanë qenë të përfshirë në aktivitete ose plane terroriste. Si FIT, ashtu edhe TFG thuhet se kanë lidhje me al’Qaedën.

Materiali i hapur kundër Kërkuesit nuk është fare substancial. Provat të cilat përbëjnë bazat kundër tij gjenden kryesisht në materialin e mbyllur. Kjo ka lënë të kuptohet se ai ka qenë në pozitë disavantazhi për t’u mbrojtur sepse ai nuk është në dijeni të atyre me të cilët pretendohet se ka qenë në kontakt.

...

Në deklaratën e tij Kërkuesi thotë që ai nuk ka dëgjuar kurrë për TFG dhe sigurisht që nuk është anëtar i këtij grupi. ... Ne nuk dyshojmë që TFG ekziston ... [dhe]

gjithashtu që ka lidhje me al'Qaedën. Arsyet tona për këtë përfundim duhet të jepen në vendimin e mbyllur.

Në maj 1998, Kërkuesi dhe 10 persona të tjerë u arrestuan gjatë një operacioni të përbashkët të Degës Speciale dhe Shërbimit të Sigurimit në vijim të urdhrave sipas Ligjit për Parandalimin e Terrorizmit. Kërkuesi u lirua pa akuza, dhe, pas një kohe, mori 18.500 paund për arrestim të gabuar. Arrestimet ishin në lidhje me pretendimet për përfshirje në komplot për shënjestrimin e Kupës së Botës në Francë. Natyrisht që ne i japim peshë mungesës së çdo prove të pranueshme që mbështet përfshirjen e Kërkuesit në komplotin e pretenduar, por kjo nuk është dhe nuk mund të jetë përgjigjja e këtij apeli. Ne duhet të shqyrtojmë të gjithë materialin për të parë nëse ka baza të arsyeshme për besimin apo dyshimin e llojit të përmendur në seksionin 21(a) ose (b) të Ligjit të vitit 2001.

...

Ne jemi të bindur që Kërkuesi është anëtar i TFG, organizatë terroriste sipas Ligjit të vitit 2001, dhe që ai ka lidhje me një grup terrorist ndërkombëtar. Ne e kemi të qartë që arsyet tona për të vepruar në këtë mënyrë janë të rralla. Kjo ndodh për shkak se materiali i cili na shpie në atë përfundim është kryesisht i mbyllur. Ne e kemi shqyrtuar atë me kujdes dhe, në kontekst të dijenisë, kërkuesi mohon çdo përfshirje në terrorizëm apo njohuri ose mbështetje të ditur ndaj ose përkrahje për terroristë. Prandaj, ne kemi bërë kujdes që të mbështetemi në materiale të cilat, sipas gjykimit tonë, nuk mund të kenë shpjegim të pafajshëm.”

39. SIAC arriti në të njëjtat përfundime në shqyrtimet e tij periodike më 2 korrik dhe 15 dhjetor 2004.

#### *4. Kërkuesi i katërt*

40. Kërkuesi i katërt ishte i lindur në Algjeri në vitin 1971 dhe për herë të parë kishte hyrë në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 1994. Në maj 1997 ai u arrestua dhe u akuzua për disa vepra penale, përfshirë edhe komplot për eksportimin në Algjeri të materialeve të cilat supozohej se do të përdroreshin për qëllime terrorizmi. U pretendua që ai ishte anëtar i GIA-s. Çështja kundër kërkuesit u braktis në mars 2000 kur një dëshmitar kyç, agjent i Shërbimit Sekret, i cili pritej të jepte dëshmi lidhur me nevojën e civilëve për t'u mbrojtur nga mizoritë që pretendoheshin të ishin kryer nga qeveria algjeriane, vendosi që ishte tepër e rrezikshme për të që të jepte dëshmi.

41. Në vitin 1998 kërkuesi i katërt u martua me një shtetase franceze. Ai u bë shtetas francez në maj 2001, megjithëse nuk i informoi autoritetet e Mbretërisë së Bashkuar lidhur me këtë. Sekretari i Shtetit e certifikoi atë sipas seksionit 21 të Ligjit të vitit 2001 më 17 dhjetor 2001 dhe ai u ndalua më 19 dhjetor 2001. Më 13 mars 2002 ai u largua për në Francë, ku u intervistua sapo arriti nga zyrtarët e sigurisë dhe më pas u lirua. Meqenëse ai ishte larguar nga Mbretëria e Bashkuar, certifikata kundër tij u revokua dhe revokimi u mbrapa-datua më 22 mars 2002.

42. Në vendimin e tij të datës 29 tetor 2003, SIAC u shpreh që mbrapa-datimi i revokimit nënkuptonte që kërkuesi i katërt nuk mund të konsiderohej si i atillë që kishte qenë i certifikuar në kohën kur ai paraqiti

apelin e tij dhe që, për këtë arsye, ai nuk kishte të drejtë të ankohej. Pavarësisht nga kjo, ai vendosi ta shqyrtonte apelin mbi bazën e faktit që ky përfundim mund të ishte i gabuar. Meqenëse Sekretari i Shtetit nuk mund ta kishte ditur në kohën e lëshimit të certifikatës që kërkuesi ishte shtetas francez dhe mund të zhvendosej lehtë për në Francë, nuk mund të thuhej mbi atë bazë që certifikata nuk duhet të ishte lëshuar. Prandaj SIAC vazhdoi me vlerësimin e provave kundër tij:

“Për të marrë vendimin, ne duhet të shqyrtojmë jo vetëm materialin e hapur, por edhe materialin e mbyllur. Kërkuesi duket se ka dyshuar që ishte nën vëzhgim për një pjesë të madhe të periudhës relevante.

Ne jemi të vetdijshëm për nevojën e të qenit shumë të kujdesshëm për të mos presupozuar fajësinë për shkak të asociimit. Duhet të ketë më shumë se miqësi apo bashkëpunim me ata që besohet të jenë të përfshirë në terrorizëm ndërkombëtar në mënyrë që të arsyetohet dyshimi i arsyeshëm se vetë Kërkuesi është i përfshirë në ato aktivitete ose të paktën që i përkrah apo i ndihmon me dijeninë e tij. Kemi parasysh shqetësimet e [këshilltari i tij juridik] që ajo që ka ndodhur këtu është një përpjekje për të ringjallur ndjekjen penale pa pasur asgjë për të shtuar për sa i përket aktiviteteve të tij që nga ajo kohë. Ndalimi duhet konsideruar si zgjidhja e fundit kështu që nuk mund të justifikohet vetëm mbi bazën e asociimit dhe sidoqoftë faji i bashkëpunëtorëve nuk është konstatuar asnjëherë...

Megjithatë, asociimi i vazhdueshëm me ato që dyshohen për përfshirje në terrorizëm ndërkombëtar me lidhje me al'Qaedën duke pasur parasysh dyshimin e arsyeshëm që Kërkuesi ka qenë vetë i përfshirë në aktivitete terroriste për GIA-n është një çështje e cila mund të shqyrtohet siç duhet. GSPC, e cila u shkëput nga GIA, ka lidhje me al'Qaedën dhe Kërkuesi ka vazhduar të shoqërohet më shumë me ata që i janë bashkuar GSPC-së sesa me ata të GIA-s. Në fakt, ne jemi bindur që jo vetëm që Kërkuesi ka qenë aktivisht i përfshirë me GIA dhe më pas me GSPC, por edhe që ai ka paraqitur dokumentacion fals për anëtarët e tyre dhe për Muxhahedinët në Çeçeni siç pretendohet në deklaratën e hapur. Por ne e pranojmë që aktivitetet e tij në vitin 2000 dhe 2001 justifikojnë përdorimin e shprehjes që ai nuk ishte ndier shumë, dhe ne e shprehim këtë vëzhgim duke pasur parasysh si materialin e hapur, ashtu edhe atë të mbyllur. Megjithatë, fakti që ai nuk është ndier nuk do të thotë që ai nuk vlen të konsiderohet si terrorist ndërkombëtar brenda kuptimit të seksionit 21. Duhet të bëhet një vlerësim i asaj që mund të bëjë ai duke pasur parasysh ato që ka bërë dhe faktin që ai ka treguar vullnet dhe aftësi për të ofruar ndihmë dhe mbështetje në të kaluarën dhe i vazhdon asociimet dhe dhënia e ndihmës (p.sh. përdorimi i furgonit të tij) është shumë relevante.

Neve nuk na është dukur fare i lehtë ky aspekt i argumenteve të Kërkuesit. I kemi dhënë rëndësi të plotë parashtrimeve të [këshilltarit të tij juridik] të cilat na u paraqitën në mënyrë aq bindëse, por në fund arritëm në përfundimin që, duke pasur parasysh provat në tërësi, vendimi për lëshimin e një certifikate nuk ishte i gabuar. Rrjedhimisht, ne nuk do ta kishim lejuar apelin kundër fakteve.”

##### 5. *Kërkuesi i pestë*

43. Kërkuesi i pestë ka lindur në Algjeri në vitin 1969. Në deklaratën e tij dhënë para SIAC ai pretendoi se kishte vuajtur nga poliomieliti kur kishte qenë fëmijë e për pasojë kishte mbetur me këmbën e djathtë të dobët dhe të

paralizuar përjetë. Ai u arrestua dhe u torturua nga qeveria algjeriane në vitin 1991, kur ai u largua nga Algjeria për në Arabinë Saudite. Në vitin 1992 ai lëvizi në Pakistan dhe udhëtoi për në Afganistan disa herë. Në gusht 1995 ai hyri në Mbretërinë e Bashkuar dhe kërkoi azil, duke pretenduar gjatë kësaj kërkese që këmba e tij ishte lënduar nga një predhë në Afganistan në vitin 1994. Kërkesa e tij për azil u refuzua dhe ankesa e tij kundër refuzimit u rrëzua në dhjetor 1999. Kërkuesi u martua me një shtetase franceze me të cilën pati një fëmijë.

44. Ai u certifikua nga Sekretari i Shtetit sipas seksionit 21 të Ligjit të vitit 2001 më 17 dhjetor 2001 dhe u ndalua më 19 dhjetor 2001. Në vendimin e 29 tetorit 2003, duke rrëzuar apelin e kërkuesit të pestë kundër certifikimit, SIAC vërejti:

“Deklaratat e hapura që janë ofruar për të justifikuar certifikimin nuk i referohen shumë materialeve burimore dhe kështu përbëhen kryesisht nga konstatime. Si me shumicën e këtyre apeleve, pjesa kryesore e provave gjendet në materialet e mbyllura kështu që, siç e dimë mirë, Kërkuesit kanë qenë në pozitë disavantazhi për sa i përket faktit që nuk kanë pasur mundësi të shtjellonin ato që mund të merren si prova inkriminuese. Avokatët e Posaçëm kanë arritur të kontestojnë disa çështje të caktuara dhe nganjëherë me efekte pozitive. Në fakt, kështu ndodhi në një çështje lidhur me një kamp në Dorset i frekuentuar nga disa prej personave, përfshirë edhe Kërkuesin, që i interesonin Shërbimit të Sigurimit...”

Argumenti kundër Kërkuesit është se ai ka qenë anëtar i GIA dhe, që nga shkëputja e GSPC nga GIA, anëtar i GSPC. Ai është asociuar me disa krye-udhëheqës ekstremistë, disa prej të cilëve janë gjithashtu anëtarë ose të Asociuar me GSPC, dhe ka dhënë mbështetje aktive në formë të paraqitjes së dokumenteve fallso dhe lehtësimit të udhëtimit të myslimanëve të rinj nga Mbretëria e Bashkuar për në Afganistan për t’u stërvitur për xhihad. Ai konsiderohet që ka marrë përsipër një rol të rëndësishëm në mbështetjen e aktiviteteve të ndërmarra në emër të GSPC dhe ekstremistëve të tjerë islamikë në Mbretërinë e Bashkuar dhe jashtë saj. Të gjithë këtë Kërkuesi e mohon dhe në deklaratën e tij ai jep shpjegime shfajësuese për bashkëpunimet për të cilat akuzohet. Ai vërtet ka qenë i afërt posaçërisht me algjerianë të tjerë në Mbretërinë e Bashkuar dhe, për sa i përket [kërkuesit të katërt], familjet ishin shumë të afërta sepse, përveç të gjitha të tjerave, gratë e tyre respektivisht ishin franceze. Ai shkonte në xhaminë e [kërkuesit të tetë]. Ai ishte një predikues mbresëlënës dhe kërkuesi thotë se e dëgjonte por kurrë nuk përfshihej. Në të vërtetë, ai nuk e njihte [kërkuesin e tetë] përveç se përmes ndihmës çeçene, të cilën kërkuesi dhe qindra myslimanë të tjerë e mbështesnin, dhe ai kurrë nuk kishte folur me të në telefon. Ai ishte takuar në disa raste me [kërkuesin e tetë] gjatë faljes së të premtës në xhami kur kishte pasur nevojë për këshillim lidhur me ndonjë problem social.”

SIAC iu referua raporteve të vëzhgimit “të hapur” i cili tregonte që kërkuesi kishte pasur kontakt me anëtarë të tjerë të supozuar të GIA-s dhe GSPC-së, përfshirë një rast në një kamp në Dorset në korrik 1999. Prova të tjera “të hapura” përfshinin përgjigjet e tij “të padobishme” dhe “jo krejtësisht të vërteta” ndaj pyetjeve të oficerëve të Shërbimit të Sigurimit në korrik dhe shtator 2001. SIAC vazhdoi:

“Jemi bazuar në artikuj të ndryshëm që kemi gjetur në shtëpinë e tij kur ai u arrestua. Ato përfshijnë një kopje të fatwa-s së lëshuar nga Bin Laden. Kërkuesi thotë se nuk e ka parë kurrë atë dhe nuk ishte në gjendje të shpjegonte praninë e saj. Një komunikatë e GSPC ishte, siç thotë ai, mbase një prej atyre që shpërndahen në xhami. Analiza e diskut të brendshëm (hard drive) të kompjuterit të tij tregoi që ai kishte vizituar një faqe interneti të specializuar për teknologjinë ushtarake amerikane. Kjo nuk mund të ishte diçka që mund të ishte e lidhur me studimet e Kërkuesit. Po kështu edhe një diagramë e vizatuar me dorë e një predhe rakete që ai nuk e kishte parë ndonjëherë. Ai thotë se kjo mund të ketë qenë në një libër për Islamin që ai e kishte blerë më çmim të ulët në xhami.

Ne i kemi parasysh mohimet, por duhet të konsiderojmë edhe provat. Siç do të qartësohet nga ky vendim, ne kemi arsye të dyshojmë tek disa prej konstatimeve të Kërkuesit. Por materiali i mbyllur e konfirmon pikëpamjen tonë që vërtet ekziston dyshimi i arsyeshëm që Kërkuesi është terrorist ndërkombëtar brenda kuptimit të seksionit 21 dhe besimin e arsyeshëm që ai ka qenë i përfshirë në prodhimin e dokumentacionit fals, ka ndihmuar myslimanë të rinj që të udhëtonin për në Afganistan për t’u stërvitur për xhihad, dhe ka ndihmuar aktivisht terroristë të cilët kanë lidhje me al’Qaedën. Ne njëkohësisht jemi të bindur që ai ka ndihmuar në mënyrë aktive edhe GSPC-në. Këtë apel e rrëzojmë pa asnjë hezitim.”

45. Më 22 prill 2004, për shkak të shqetësimeve shëndetësore, kërkuesi i pestë u lirua nga burgu me dorëzani në kushte të rrepta, çka nënkuptonte arrest shtëpiak me kontrole të mëtejshme. Në vendimin e tij të rishikuar të 2 korrikut 2004, SIAC u shpreh:

“... në dhënien e dorëzarisë, [SIAC] nuk e rishikoi pikëpamjen e vet për sa i përket bazave për të besuar se ai ishte terrorist ndërkombëtar dhe kërcënim për sigurinë kombëtare. Kërcënimin mund të menaxhohej proporcionalisht në rastin e tij duke pasur parasysh sëmundjen e tij të rëndë mendore. Megjithatë, kjo nuk është arsye për anulimin e certifikatës. Mund të ketë rrethana në të cilat ai shkel kushtet e dorëzarisë ose për arsye të tjera ishte i nevojshëm revokimi i saj. Nevoja që certifikata të vazhdojë duhet të varet nga fakti nëse kushtet e statutit dhe të derogimit vazhdojnë të përmbushen.

Disa prej personave të tij të kontaktit mbeten në arrati përfshirë edhe disa të cilët konsiderohen të përfshirë aktivisht në planifikim terrorist. Nuk ka asgjë që sugjeron që sëmundja e tij mendore e ka zvogëluar përkushtimin e tij ndaj kauzës ekstremiste islamike; ai ka përvojën dhe kapacitetin për t’u përfshirë në aktivitete të mëtejshme ekstremiste. Kufizimet e dorëzarisë ndaj tij janë thelbësore; ato caktohen në përputhje me certifikimin e tij dhe me rrëzimin nga SIAC të apelit të tij kundër këtij certifikimi. Certifikata mbetet ashtu siç është.”

46. Më 15 dhjetor 2004, SIAC përsëri shqyrtoi çështjen e tij dhe vendosi që certifikata duhet të mbetet ashtu siç është.

#### 6. *Kërkuesi i gjashtë*

47. Kërkuesi i gjashtë ka lindur në Algjeri në vitin 1967 dhe është banues në Mbretërinë e Bashkuar nga viti 1989. Sekretari i Shtetit lëshoi një certifikatë kundër tij më 17 dhjetor 2001 dhe ai u ndalua më 19 dhjetor 2001.



## 48. Në vendimin e datës 29 tetor 2003, SIAC vërejti si më poshtë:

“Megjithëse ne duhet ta marrim vendimin tonë mbi bazën e materialit të hapur dhe atij të mbyllur, është me rëndësi të tregohet çështja e [kërkuesit të gjashtë] ashtu siç është përkufizuar nga Sekretari i Shtetit në materialin e hapur, sepse aty janë argumentet me të cilat [kërkuesi i gjashtë] e di që do të përballet. Në vlerësimin e deklaratës së tij si dhe provave dhe argumenteve të tjera të paraqitura në emër të tij, ne kujtojmë gjithmonë që ai nuk ka dijeni për materialin e mbyllur të Sekretarit të Shtetit, por sidoqoftë ai nuk është krejtësisht në zbrazëtitirë për shkak të akuzave të hapura; dhe ne mund t'i testojmë vetë argumentet e Kërkuesit nga mënyra se si ai i qaset atyre akuzave.

Argumentet e Sekretarit të Shtetit kundër [kërkuesit të gjashtë] përmblihen si vijon:

(1) ai i përket dhe/ose është anëtar i GSPC-së, dhe përpara ka qenë i përfshirë në GIA;

(2) ai ka mbështetur dhe ndihmuar GSPC-në (dhe përpara saj GIA-n) përmes përfshirjes së tij në mashtrime me karta krediti, çka ka qenë burim kryesor të ardhurash për GSPC-në në Mbretërinë e Bashkuar;

(3) nga gushti i vitit 2000, [kërkuesi i gjashtë] mori një rol të rëndësishëm në sigurimin e pajisjeve të telekomunikimit për GSPC-në dhe ofrimin e përkrahjes logjistike për telefonat satelitorë përmes blerjes dhe caktimit të kohës ajrore për ato telefona;

(4) ai gjithashtu ka luajtur një rol të rëndësishëm në prokurimin e pajisjeve të telekomunikimit dhe pajisjeve të tjera për luftimet e muxhahedinëve në Çeçeni – domethënë për fraksionin i cili deri në vitin 2002 ishte nën komandën e Ibn Khattab.”

SIAC më pas shqyrtoi provat e hapura që kishte përpara në lidhje me blerjen nga Abu Doha, me ndihmën e kërkuesve të gjashtë dhe të shtatë, të disa telefonave satelitorë dhe pajisjeve të tjera të telekomunikimit në vlerë 229.265 paund britanikë, si dhe natyrën dhe shtrirjen e lidhjeve mes kërkuesit të gjashtë dhe kërkuesit të shtatë. SIAC arriti në përfundimin që:

“Në rrethanat që kemi përpara, neve na duket që Sekretari i Shtetit ka baza të bollshme për dyshimin e arsyetuar që aktivitetet e prokurimit të [kërkuesit të gjashtë] ishin të orientuara drejt mbështetjes për fraksionin ekstremist arab islamist që luftonte në Çeçeni. Mbështetja del nga lidhjet e [kërkuesit të gjashtë] dhe përkrahja e tij ndaj GSPC-së. Ne theksojmë, ashtu si edhe me kërkuesit e tjerë, që është akumulimi i faktorëve, ku secili mbështet të tjerët dhe nuk i dobëson ata, duke i dhënë ngjyrim dhe kontekst aktiviteve të para në tërësi, ajo çka është bindëse; do të ishte gabim të merrej një copëz e izoluar, sepse kështu do të zvogëlohej domethënia e tij dhe do të humbiste pasqyra e përgjithshme. Vendimi i përgjithshëm i mbështet këto përfundime. Këto janë aktivitete që bien brenda kuadrit të derogimit. [Kërkuesi i gjashtë] ka ofruar vetëm mohime të pambështetura dhe nuk ka arritur të ofrojë shpjegime të besueshme alternative. Kjo është e mjaftueshme për të përcaktuar apelin e tij, pa iu referuar më tej akuzave të tjera të Sekretarit të Shtetit të cilat, siç u konstatua në deklaratën e hapur dhe në provat e hapura para [SIAC], mund të vërtetohen si duhet vetëm duke shqyrtuar materialin e mbyllur.”

49. SIAC e shqyrtoi çështjen më 2 korrik 2004 dhe më 28 shkurt 2005, dhe, në secilin rast, vendosi se kishte ende baza për mbajtjen në fuqi të certifikatës.

### 7. Kërkuesi i shtatë

50. Kërkuesi i shtatë ka lindur në Algjeri në vitin 1971 dhe me sa duket ka hyrë në Mbretërinë e Bashkuar duke përdorur dokumente identifikimi franceze fals në ose rreth vitit 1994. Më 7 dhjetor 2001 ai u shpall fajtor për disa vepra në trafik dhe u dënua me katër muaj burg. Ai u certifikua nga Sekretari i Shtetit më 5 shkurt 2002 dhe u ndalua në vijim të certifikatës sapo përfundoi afati i burgimit të tij më 9 shkurt 2002.

51. Në vendimin e datës 29 tetor 2003, SIAC shënoi që akuzat kundër kërkuesit të shtatë ishin që ai kishte qenë anëtar i GSPC-së që nga viti 1997 ose 1998, dhe para saj anëtar i GIA-s; që kontaktet e tij me anëtarë kryesues të GSPC-së në Mbretërinë e Bashkuar tregonin që ai ishte pjesëtar i besuar i organizatës; dhe që ai kishte qenë i përfshirë me Abu Doha dhe me kërkuesin e gjashtë në blerjen e pajisjeve të telekomunikimit për përdorim nga ekstremistët në Çeçeni dhe Algjeri. Më tej, SIAC shënoi që:

“[Kërkuesi i shtatë] nuk dha dëshmi para [SIAC-it] dhe, në fakt, zgjodhi që të mos merrte pjesë në seancën dëgjimore mbi apelin e tij. Deklarata e tij, të cilën natyrisht që e kemi lexuar, në përgjithësi, dhe, mbase jo çuditërisht, parashtrësat [e këshilltarit të tij], si verbale ashtu edhe me shkrim, ishin ngjashëm të përgjithshme. Mënyra se si [kërkuesi i shtatë] i konsideron procedurat aktuale kundër tij dhe fakti që ai nuk ka dhënë dëshmi verbale ose deklarata të hollësishme me shkrim nuk janë çështje që duhen peshuar kundër tij. Ne e kuptojmë vështirësinë që kanë Kërkuesit në rrethana në të cilat akuzat kundër tyre jepen vetëm të përmbledhura dhe një pjesë e madhe e provave mbi të cilat bazohen ato akuza, për arsye sigurie kombëtare, nuk mund t’u komunikohen Kërkuesve vetë. Megjithatë, [kërkuesi i shtatë] është në pozicionin më të mirë për të ditur se cilat kanë qenë aktivitetet dhe motivet e tij gjatë periudhës relevante. Asgjë nuk e ndalon atë nga dhënia e një përshkrimi dhe llogarie të lidhur me ato aktivitete nëse dëshiron ta bëjë. Fakti që ai ka zgjedhur të mos japë deklarata të detajuar të aktiviteteve të tij tregon se ai nuk ka ofruar material për të kundërshtuar provat dhe argumentet e të tjerëve.”

SIAC doli me përfundimin se materiali i hapur dhe ai i mbyllur mbështesnin akuzat kundër kërkuesit të shtatë, dhe e rrëzoi apelin e tij.

52. Në vendimet e rishikuara të 2 korrikut dhe 15 dhjetorit 2004, SIAC vendosi që certifikata të mbetet ashtu siç është.

### 8. Kërkuesi i tetë

53. Kërkuesi i tetë është shtetas i Jordanisë, i lindur në Bethlehem në vitin 1960. Ai ka ardhur në Mbretërinë e Bashkuar më 16 shtator 1993 dhe ka kërkuar azil. Ai është njohur si refugjat dhe është lejuar të qëndrojë deri më 30 qershor 1998. Më 8 maj 1998 ai aplikoi për qëndrim të pacaktuar por vendimi në lidhje me aplikimin nuk ishte marrë ende në kohën kur Ligji i vitit 2001 hyri në fuqi.

54. Kërkuesi i tetë u shpall fajtor *in absentia* në Jordani për përfshirjen e tij në sulme terroriste atje dhe në lidhje me një komplot për vendosjen e bombave që do të koinçidonin me fundin e mijëvjeçarit. Ai u hetua në shkurt 2001 nga policia e kundër-terrorizmit në lidhje me planet për

shkaktimin e shpërthimeve në tregun e Krishtlindjeve në Strasburg në dhjetor të vitit 2000, por kundër tij nuk u ngritën akuza. Kur Ligji u miratua në vitin 2001, ai kaloi në fshehtësi. Ai u arrestua më 23 tetor 2002 ku menjëherë iu lëshua certifikata sipas seksionit 21 dhe u ndalua. Në të njëjtën datë u mor një urdhër dëbimi kundër tij.

55. Në vendimin e datës 8 mars 2004, ku rrëzohej apeli i kërkuesit të tetë kundër certifikimit, SIAC vërejtë si vijon:

“[Këshilltari i kërkuesit të tetë], me udhëzim të kërkuesit, na informoi që klienti i tij kishte zgjedhur të mos ishte i pranishëm në seancën dëgjimore dhe të mos merrte pjesë fare. Ai kishte lexuar vendimet lidhur me kërkuesit që ishin certifikuar me hyrjen në fuqi të Ligjit të vitit 2001 dhe vendimin e përgjithshëm, kështu që ndihej i sigurt që rezultati i apelit të tij ishte një përfundim i sakrifikuar. Roli i tij ishte përmendur shumë në apelet e tjera dhe disa ishin certifikuar dhe ndaluar, të paktën pjesërisht, mbi bazën e faktit që kishin lidhje me të. Meqenëse kjo lidhje konsiderohej e mjaftueshme për të arsyetuar burgimin e tyre në vazhdim, ai konsideronte që vendimi mbi apelin e tij efektivisht tashmë ishte marrë. Ai bëri zgjedhjen që të mos merrte pjesë fare sepse nuk kishte besim tek kapaciteti i sistemit për të arritur tek e vërteta. Ai konsideroi që procedura e SIAC ishte vendosur me qëllim në mënyrë që të shmangte hetimin e thellë publik të çështjes së të akuzuarit, e cila i privonte individët nga mundësia për të kontestuar akuzat që ngrihen kundër tyre.

Duke pasur parasysh këtë, [këshilltari i kërkuesit të tetë] e bëri të qartë që apeli nuk po tërhiqej. Rrjedhimisht, ishte e nevojshme që ne ta shqyrtonim atë dhe të merrnim parasysh deklaratën e bërë nga apeluesi. [Këshilltari i tij] theksoi disa çështje të cilat, siç sugjeroi ai, duhet të konsideroheshin si të favorshme për deklarinimin e apeluesit që ai nuk ishte dhe nuk kishte qenë kurrë i përfshirë në terrorizëm brenda kuptimit të Aktit të vitit 2001. Për më tepër, akuzat tregonin që shërbimet e sigurimit kishin një qasje të shtrembëruar dhe të mbithjeshtuar të aktiviteteve të apeluesit dhe rolit të tij si mësues i respektuar dhe besimtar i të drejtave të komunikimit të Islamit në botë.

Duhet të qartësojmë që ne i kemi shqyrtuar argumentet kundër apeluesit mbi themelet e tyre. Nuk jemi ndikuar nga gjetjet e apeleve të tjera apo vendimet e përgjithshme. Një prej arsyeve pse ky vendim ka marrë një kohë të gjatë për t'u përgatitur ka qenë domosdoshmëria që ne të lexonim me kujdes dhe të shqyrtonim provat, si ato të hapura ashtu edhe ato të mbyllura, që na ishin paraqitur. Këtu ka më shumë informata sesa në shumicën e apeleve të tjera. Ky është pasqyrim i faktit që apeluesi ka bashkëpunuar dhe ka pasur të bënte me shumë prej të tjerëve që janë certifikuar dhe me individë dhe grupe po ashtu të lidhura me al'Qaedën. Ne nuk shohim ndonjë arsye për të ndryshuar pikëpamjet e shprehura në vendimin e përgjithshëm lidhur me domethënien e individëve dhe grupeve të ndryshme të përmendura në të. Por kjo nuk do të thotë që ne i kemi pranuar mendimet aty automatikisht. Ne tërheqim vëmendjen drejt faktit se komisioni i cili ka nxjerrë vendimin e përgjithshëm nuk kishte të njëjtën përbërje si ky komision, dhe kontributi i dhënë nga kryetari i këtij komisioni në vendimin e përgjithshëm ka qenë i kufizuar brenda çështjeve ligjore. Ne e kemi shqyrtuar çështjen e apeluesit mbi bazën e materialit që na është paraqitur në këtë apel...

Për sa i përket seancës së mbyllur, Avokatët e Posaçëm na informuan se, pas shqyrtimit të kujdesshëm, ata kishin vendosur që nuk do të ishte në interes të apeluesit që ata të merrnin pjesë në procedura. Ne u shqetësuam shumë për këtë, duke menduar se vendimi ishte i gabuar. Apeli vazhdonte të qëndronte dhe apeluesi nuk e dinte se cilat ishin bazat e argumenteve kundër tij në materialin e mbyllur. Ne nuk arritëm të

kuptonim se si në këto rrethana nuk do të ishte në interes të tij nga ana e Avokatëve të Posaçëm me iniciativën e vet të nxirrin apo të identifikonin çështje në favor të apeluesit dhe të bënin parashtrësia para nesh për të na bindur që provat faktikisht ishin jo të besueshme ose nuk justifikonin vlerësimet e bëra. Kur i kërkuam [njërit nga dy Avokatët e Posaçëm, të emëruar, në lidhje me kërkesën e tetë] që të na tregonte përse kishte vendosur ashtu siç na tha, ai u përgjigj se nuk mund të vepronte ashtu sepse do të ishte në kundërshtim me interesat e apeluesit. Ne e shtymë seancën për t'u dhënë mundësi Avokatëve të Posaçëm që të përpiqeshin të kuptonin nga apeluesi përmes përfaqësuesve të tij nëse ai dëshironte që ata të bënin atë që mundeshin në emër të tij, dhe po ashtu kontaktuam Kryeavokaten e Përgjithshme Juridike prej ku ishin caktuar Avokatët e Posaçëm për të kërkuar ndihmën e saj që ajo të përpiqej t'i bindte ata të na ndihmonin. Përfaqësuesit e apeluesit treguan që ata nuk kishin asgjë për të thënë lidhur me çështjen në fjalë, dhe Këshilltarja e Përgjithshme Juridike u shpreh që çdo ndërhyrje e saj do të ishte e gabuar. Përpyekjet tona të mëtejshme për të bindur Avokatin e Posaçëm të ndryshonin mendje dështuan, dhe meqenëse nuk mund t'i detyronim për të vepruar në një mënyrë të caktuar u desh të vazhdonim pa ata. [Këshilltari i Sekretarit të Shtetit], me kërkesën tonë, identifikoi disa çështje të cilat mund të konsideroheshin me gjasë shfajësuese dhe ne vetë ngritëm çështje të tjera gjatë seancës së mbyllur.

Ne jemi të vetdijshëm që mungesa e një Avokati të Posaçëm e bën detyrën tonë edhe më të vështirë nga ç'është zakonisht, dhe që drejtësia potenciale ndaj apeluesit është edhe më e dukshme. Ne nuk dyshojmë që Avokatët e Posaçëm besonin që kishin arsye të forta për të marrë qëndrimin që morën, dhe po ashtu jemi të sigurt që ata e kanë menduar gjatë dhe thellë nëse kjo ishte gjëja e duhur. Por duhet të shënojmë mendimin tonë që ata e kishin gabim dhe që nuk mund të kishte arsye për mos vazhdimin e pjesëmarrjes në apelin që ishte në proces... Në fakt, provat kundër apeluesit në këtë rast janë aq të forta saqë asnjë Avokat i Posaçëm, sado i shkëlqyer, nuk do të kishte arritur të na bindte që nuk ishte vendosur dyshimi i arsyeshëm që arsyetonte certifikimin. Kështu mungesa e Avokatëve të Posaçëm nuk e ka paragjykuar apeluesin..."

56. Më pas SIAC bëri një përmbledhje të argumenteve të hapura kundër kërkesit, pra faktin që ai kishte bashkëpunuar dhe kishte vepruar si udhëheqës shpirtëror i disa individëve dhe grupeve të lidhur me al'Qaedën. Ai kishte pikëpamje ekstreme dhe fundamentaliste dhe ishte raportuar që, gjatë fjalimeve të tij në xhaminë e Londrës, kishte bekuar vrasjen e hebrenjve dhe amerikanëve kudo që janë. SIAC arriti në përfundimin që:

"Ne jemi të bindur që aktivitetet e kërkesit kanë shkuar përtej kështillimit. Ai me siguri ka ofruar përkrahjen e Kuranit për ata që dëshirojnë të jetësojnë qëllimet e al'Qaedës dhe të përfshihen në vetëvrasje me bombë dhe aktivitete të tjera vrasëse. Provat janë të mjaftueshme për të vërtetuar që ai ka qenë i përfshirë në nxitjen e akteve të terrorizmit ndërkombëtar. Por këshilla shpirtërore e dhënë me vetëdijen e qëllimeve dhe përdorimeve për të cilat po shfrytëzohet konsiderohet dhënie e ndihmës brenda kuptimit të seksionit 21(4) të Ligjit të vitit 2001.

...

Këtu ngrihen shumë akuza. Nuk e gjykojmë me vend që të merremi me to *seriatim*. Ne e kemi treguar përse kemi krijuar pikëpamjen që çështja kundër kërkesit është argumentuar në mënyrë të vendosur. Në fakt, sikur standardi të ishte më lart se dyshimi i arsyeshëm, ne nuk do të kishim pasur asnjë dyshim që ai është përmbushur. Apeluesi ka qenë i përfshirë seriozisht, në fakt ka qenë në qendër të aktiviteteve

terroriste në Mbretërinë e Bashkuar që ka lidhje me al'Qaedën. Ai është vërtet individ i rrezikshëm dhe këto apele rrëzohen.”

#### *9. Kërkuesi i nëntë*

57. Kërkuesi i nëntë është algjerian i lindur në vitin 1972. Në vitin 1991 ai u largua nga Algjeria për në Afganistan ku mësoi arabisht në një kamp refugjatësh. Ai kërkoi azil në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 1993. Në vitin 1994 atij iu dha leje qëndrimi për katër vjet, dhe në vitin 2000 iu dha leje qëndrimi i pacaktuar mbi bazën e faktit që do të konsiderohej refugjat. Në katër raste, i fundit prej të cilëve në maj 1998, kërkuesi u arrestua dhe u lirua pa u akuzuar. I pari i tre arrestimeve ishte në lidhje me mashtrim të kartave të kreditit. Arrestimi në maj 1998 u bë në lidhje me aktivitetet e pretenduara terroriste dhe kërkuesit më pas iu pagua kompensim nga policia për arrestim të gabuar.

58. Kërkuesi i nëntë u certifikua nga Sekretari i Shtetit dhe kundër tij u lëshua një urdhër dëbimi më 22 prill 2002. Ai u ndalua në të njëjtën ditë. Sipas provave të njërit prej dëshmitarëve për Sekretarin e Shtetit, ai nuk u certifikua, me kërkuesit e tjerë, në dhjetor 2001 sepse një prej dosjeve të tij kishte humbur.

59. Në vendimin e 29 tetorit 2003, SIAC vërejti që akuzat kundër kërkuesit të nëntë ishin që ai ishte mbështetës i GSPC-së dhe kishte mbledhur shuma të konsiderueshme parash për të përmes mashtrimit. Kishte prova që kërkuesi në të kaluarën ishte gjetur nga zyrtarët doganorë të kishte tentuar të hynte në Mbretërinë e Bashkuar me traget me shuma të mëdha parash me vete dhe që ai kishte lidhje të ngushta me të tjerë që ishin dënuar për mashtrim me karta krediti. SIAC u shpreh që provat për përfshirjen në mashtrim nuk e vërtetonin përfshirjen në terrorizëm. Megjithatë, ai shënoi që kërkuesi ishte qenë i pranishëm në një kamp në Dorset në shoqërinë e kërkuesit të pestë dhe disa të tjerëve që dyshohen të jenë përkrahës të GSPC-së dhe që në shtëpinë e tij ishte gjetur një faturë telefoni, në kohën e arrestimit të tij, në emër të Yarkas, i cili ishte arrestuar në Spanjë në nëntor 2001 për shkak të lidhjeve që pretendohet të kishte me al'Qaedën. Kërkuesi kishte dhënë prova por nuk kishte qenë bindës dhe nuk kishte ofruar shpjegim të besueshëm lidhur me ngjarjen e lartpërmendur. Provat e mbyllura i mbështetën akuzat e Sekretarit të Shtetit dhe prandaj SIAC e rrëzoi apelin e kërkuesit kundër certifikimit.

60. Në vendimin e datës 2 korrik 2004 dhe 15 dhjetor 2004, SIAC u shpreh që certifikata mbetej e pandryshuar.

#### *10. Kërkuesi i dhjetë*

61. Kërkuesi i dhjetë është shtetas algjerian. Pas shpërthimit të një bombe në Algjeri, dorën e majtë ia kishin prerë deri te kyçi dhe krahun e djathtë ia kishin prerë deri poshtë bërrylit. Në vitin 1999 ai udhëtoi për në Mbretërinë e Bashkuar përmes Abu Dhabit dhe Afganistanit, dhe kërkoi

azil. Kërkesa e tij u refuzua më 27 shkurt 2001. Më pas ai u ndalua, pasi ishte arrestuar më 15 shkurt 2001 nën akuza për posedim artikujsh për qëllime të dyshuara terroriste, komplot për mashtrim dhe komplot për bërjen e instrumenteve fallso. Në kohën e arrestimit ai u gjet në posedim të rreth 40 patentave të shoferit franceze, kartave të identitetit dhe pasaportave, një lexues kartash krediti, plastifikues dhe pajisje stampimi. Megjithatë, procedura e akuzave nuk u vazhdua më tej dhe kërkuesi u lirua më 17 maj 2001.

62. Më 14 janar 2003 Sekretari i Shtetit lëshoi një certifikatë kundër tij sipas seksionit 21 të Ligjit të vitit 2001 dhe ai u ndalua. Kundër tij u lëshua një urdhër dëbimi po në të njëjtën ditë.

63. Në vendimin e datës 27 janar 2004, SIAC vërejti që thelbi i çështjes kundër kërkuesit të dhjetë ishte se që nga ardhja e tij në Mbretërinë e Bashkuar ai kishte qenë i lidhur ngushtë me një rrjet ekstremistësh të lidhur në të kaluarën me Abu Doha (shih paragrafin 26 lart). Në mënyrë të veçantë, u pretendua që ai kishte siguruar mbështetje logjistike në formën e dokumentacionit fals dhe para të mbledhura me anë të mashtrimit me karta krediti. Ai kishte kaluar shumë kohë në Xhaminë e Finsbury Parkut, një qendër e njohur e ekstremizmit islamik, dhe pretendohet se kishte marrë pjesë në një takim atje në qershor 2001 në të cilin ishin bërë kërcënime kundër samitit të G8-ës në Genova.

Kërkuesi paraqiti një deklaratë me shkrim më 28 qershor 2003 ku i mohonte akuzat kundër tij. Megjithatë, ai nuk mori pjesë në seancën dëgjimore të apelit të tij, siç shpjegoi SIAC në vendimin e vet:

“Ai ishte, siç tha [këshilltari i tij], një refugjat i mirëfilltë, jo anëtar i asnjë grupi apo organizate, dhe jo i përfshirë në terrorizëm apo në përkrahjen e terrorizmit. Ai nuk kishte dijeni për asnjë sulm të planifikuar terrorist dhe nuk mund ta kuptonte përse ishin ngritur akuza kundër tij. Ai nuk kishte parë asnjë prej materialeve në dispozicion dhe nuk kishte mundësi ta sfidonte atë. Faktikisht, ai nuk mund të bënte asgjë më shumë sesa të konstatonte që ai material nuk mund të arsyetonte përfundimin që ai ishte terrorist ndërkombëtar brenda kuptimit të Ligjit meqenëse ai nuk ishte i tillë. Atij i ishin lexuar vendimet e [SIAC] mbi apelet e mëparshme. Duke pasur parasysh rëndësinë që i është dhënë materialit të mbyllur dhe testit statusor në dispozicion, ai ndiente që rezultati ishte një përfundim i sakrifikuar. Ai nuk dëshironte të merrte pjesë në apel për të krijuar përshtypjen fals që ai ishte në gjendje të merrej me provat mbi të cilat bazoheshin akuzat kundër tij. Ai nuk kishte besim tek procedurat. Rrjedhimisht, ai nuk do të merrte pjesë aktive në to përtej deklaratës dhënë nga [këshilltari i tij] në emër të tij.

Ai nuk e tërhoqi apelin e tij. Ndërkohë që ne i kuptojmë pengesat me të cilat përballen kërkuesi dhe të gjithë kërkuesit e tjerë, duam të qartësojmë se asnjë apel nuk është një përfundim i sakrifikuar. Ne duhet t'i marrim dhe i marrim në konsideratë provat para nesh, qofshin të hapura apo të mbyllura, me kujdes sepse e kemi të qartë që rezultati është paraburgim për një periudhë të papërcaktuar pa gjyq. Ndërkohë që e kemi të qartë që Avokati i Posaçëm ka një detyrë të vështirë meqenëse nuk mund të marrë udhëzime nga materiali i mbyllur, ai ka mundësi të testojë provat nga Shërbimi i Sigurimit dhe të theksojë para nesh materialin i cili i ndihmon argumentet e kërkuesit.”

SIAC gjeti që kishte prova të shumta për të mbështetur këndvështrimin që kërkuesi ishte i përfshirë në aktivitete mashtruese. Provat në dispozicion, shumica të mbyllura, ishin të mjaftueshme për të përcaktuar që ai po e bënte këtë për të mbledhur para për aktivitete terroriste dhe për të mbështetur ata që ishin të përfshirë në terrorizëm. Prandaj, SIAC e rrëzoi apelin kundër certifikimit.

64. SIAC mori vendime të ngjashme në vendimet e rishikuara të datës 4 gusht 2004 dhe 16 shkurt 2005. Në këtë të fundit, ai vërejti që megjithëse kërkuesi ishte transferuar në Spitalin e Sigurisë për Sëmundjet Mendore në Broadmoor për shkak të problemeve mendore, kjo nuk e ndryshonte vlerësimin e rrezikut që do t'i kanosej sigurisë kombëtare nëse ai do të lirohej.

### *11. Kërkuesi i njëmbëdhjetë*

65. Kërkuesi i njëmbëdhjetë është shtetas algjerian. Ai hyri në Mbretërinë e Bashkuar në shkurt 1998 duke përdorur kartë identiteti italiane fals, dhe kërkoi azil një javë më pas. Ndërkohë që kërkesa e tij ishte në pritje, në korrik 2001, ai udhëtoi për në Gjeorgji duke përdorur pasaportë franceze fals dhe u dëbua drejt Mbretërisë së Bashkuar, ku u informua që udhëtimi i tij jashtë Mbretërisë së Bashkuar i kishte dhënë fund kërkesës së tij për azil. Ai bëri një kërkesë të dytë për azil e cila u refuzua më 21 gusht 2001. Kërkuesi u arratis. Ai u arrestua më 10 tetor 2001 dhe u mbajt në një Qendër Ndalimi të Imigracionit, prej ku u arratis në shkurt 2002. Ai u arrestua përsëri më 19 shtator 2002 dhe u mbajt në Burgun e Belmarshit sipas dispozitave ligjore mbi imigracionin.

66. Më 2 tetor 2003 Sekretari i Shtetit e certifikoi atë si terrorist ndërkombëtar sipas seksionit 21 të Ligjit të vitit 2001 dhe mori një urdhër dëbimi kundër tij mbi bazat e sigurisë kombëtare.

67. Në vendimin e 12 korrikut 2004, ku rrëzohej apeli i kërkuesit të njëmbëdhjetë kundër certifikimit, SIAC filloi çështjen e hapur kundër tij. U pretendua që ai ishte anëtar i përcaktuar dhe i lartë i grupit të Abu Doha (shih paragrafin 26 lart). Në korrik 2001 ai kishte tentuar të udhëtonte për në Çeçeni dhe, pasi ishte arrestuar nga policia gjeorgjiane, ishte gjetur në posedim të disa numrave telefonash të asociuar me një anëtar të lartë të grupit të Abu Doha dhe një anëtar i GSPC-së i përmendur me emër, i cili dihej që ishte i përfshirë në mbledhjen e fondeve për muxhahedinët çeçenë. Ai pretendonte se kishte siguruar para dhe mbështetje logjistike për një rrjet islamik ekstremist afrikano-verior me seli në Pakistan dhe Afganistan, që kishte lidhje me al'Qaedën, dhe se kishte ndihmuar anëtarët e grupit të Abu Doha për të udhëtuar për në Afganistan, Pakistan dhe Çeçeni. Ai kishte banuar në Xhaminë e Parkut Funsbury për rreth një vit në 1999-2000. Ai ishte shumë i kujdesshëm për sigurinë dhe gjatë një udhëtimi për në St Albans në shtator 2001 ai kishte marrë masa që të shmangte ndjekjen. Kur u arrestua në shtator 2002 ai u gjet në posedim të një pasaporte belge fals me

fotografinë e një anëtari të lartë të grupit të Abu Doha. Ai pretendohet se ishte thellësisht i përfshirë në furnizimin me dokumente fals dhe përdorimin mashtrues të blloqeve të çeqeve dhe kartave të kreditit.

68. Kërkuesi depozitoi një deklaratë me shkrim ku e mohonte që ishte terrorist ndërkombëtar. Ai e pranoi kishte udhëtuar për në Afganistan në vitin 1999, dhe që kishte tentuar të shkonte në Çeçeni në vitin 2001, por pretendonte se interesimi i tij për këto vende nuk ishte më shumë sesa ai që tregohet nga shumë myslimanë të devotshëm. Ai refuzoi të merrte pjesë në seancën dëgjimore për apelin e tij apo të përfaqësohej nga një avokat, në shenjë proteste ndaj padrejtësisë themelore të procedurës. Duke pasur parasysh pozicionin e kërkuesit, Avokatët e Posaçëm vendosën që interesave të tij do t'u shërbenin më mirë duke mos bërë parashtrësia në emër të tij apo duke mos u drejtuar pyetje dëshmitarëve në seancë të mbyllur.

69. Në rrëzimin e apelit të kërkuesit, SIAC u shpreh si vijon:

“Ne i kemi të qarta vështirësitë me të cilat përballet Kërkuesi i cili sheh vetëm materialin e hapur dhe ne mund ta kuptojmë perceptimin e [kërkuesit të njëmbëdhjetë] që procedurat janë të padrejta. Megjithatë, çdo çështje ka faktet e veta individuale, dhe do të ishte gabim të krijohej përshtypja, siç kërkoi të bënte [këshilltari i tij juridik], që ky kërkues ishte vënë në pozitë të tillë ku ishte i ndaluar, për shkak të procedurave sipas Ligjit, nga paraqitja e një mbrojtjeje efektive ndaj akuzave që ishin ngritur kundër tij.

Ne e kemi përmbledhur informacionin në dispozicion ndaj [kërkuesit të njëmbëdhjetë] në faza të ndryshme të procedurës... dhe përgjigjen [e tij] ndaj këtij informacioni në Deklaratën me Shkrim të tij. Ndërkohë që disa nga vlerësimet në materialin e hapur mund të përshkruhen si konstatime të përgjithshme të pambështetura nga prova dokumentuese, në përgjigje të të cilave [kërkuesi i njëmbëdhjetë] nuk do të kishte qenë në gjendje të jepte më shumë sesa një mohim po kaq të përgjithshëm, është e qartë që, për sa u përket vlerësimeve të tjera, [atij] i është vënë në dispozicion një sasi e konsiderueshme informacioni: emra, data, vende dhe dokumentacion mbështetës.

[Kërkuesi i njëmbëdhjetë] është në pozicionin më të mirë për të treguar lidhur me vendndodhjet dhe aktivitetet e tij që nga koha kur ka kërkuar azil për herë të parë në viti 1998. Deklarata e tij me shkrim është domethënëse jo për ato që thotë aq sa për ato që nuk thotë. Shembull: vizita për në St Albans dhe kabina e fotografimit ku [kërkuesi i njëmbëdhjetë] thotë se konstatimi specifik i palës përgjegjëse është ‘krejtësisht i gabuar’... [Kërkuesi i njëmbëdhjetë] nuk e ka mohuar që ai ka shkuar në St Albans. Ai e di se kush e ka shoqëruar dhe përse kanë shkuar atje. Ai nuk e ka shpjeguar përse ata kanë shkuar atje, as nuk ka identifikuar shoqëruesin e tij, pavarësisht se iu paraqitën fotografi të marra gjatë operacionit të vëzhgimit. ...”

SIAC vazhdoi duke shënuar mospërputhjet në tregimet e ndryshme të të kërkuesit lidhur me udhëtimet e tij në Afganistan, Gjeorgji, dhe Dubai dhe dështimi i tij për t'u përballur me pretendimet e Sekretarit të Shtetit që ai e kishte asociuar me anëtarë të ndryshëm të grupit Abu Doha, të identifikuar me emra. SIAC vazhdoi:



“Çështjet të cilave u referohemi... nuk përbëjnë një listë shteruese, thjesht shembuj më të dukshëm të mënyrës se si deklarata me shkrim e [kërkuesit të njëmbëdhjetë] nuk i përgjigjet dot argumenteve të hapura kundër tij. Duke pasur parasysh natyrën jo bindëse të deklaratës, ne nuk i japim dot peshë domethënëse mohimeve të përgjithshme që përmbahen aty... Ne i kemi shqyrtuar këto çështje me hollësi sepse ato janë ilustrime të dobishme të shkallës deri ku [kërkuesi i njëmbëdhjetë] do të kishte qenë në gjendje t’i bënte ballë argumenteve kundër tij, sikur të kishte zgjedhur që të vepronte kështu. Ndërkohë që ne nuk nxjerrim ndonjë përfundim të pafavorshëm nga dështimi [i tij] për të dhënë dëshmi, ose për të marrë pjesë në seancën dëgjimore të apelit të tij, ne duhet të vendosim në lidhje me apelin e tij në bazë të provave dhe mbetemi në qëndrimin që nuk ka pasur kontestim efektiv nga pala përgjegjëse përmes provave, marrjes në pyetje të dëshmitarëve të palës së kundërt apo parashtrimin të materialit të hapur.

...

Standardi i provave i parashikuar nga seksioni 25(2) i Ligjit të vitit 2001 është relativisht i ulët: a ka baza të arsyeshme për besim apo dyshim. Siç shpjegohet më lart, ne jemi të bindur që ky kufi i ulët kalohet lehtë vetëm mbi bazën e materialit të hapur. Nëse shqyrtohet tërësia e materialit të hapur dhe të mbyllur, nuk kemi dyshim që [kërkuesi i njëmbëdhjetë] ishte një anëtar i lartë dhe aktiv i grupit të Abu Doha siç përshkruhet në dëshminë e palës përgjegjëse.”

#### **E. Kushtet e ndalimit dhe efekti i ndalimit mbi shëndetin e kërkuesit**

70. Kërkuesit e ndaluar fillimisht u mbajtën në Burgun Belmarsh në Londër. Kërkuesi i gjashtë u transferua në Burgun Woodhill kurse kërkuesi i parë, i shtatë dhe i dhjetë u transferuan në Spitalin e Sigurisë për të Sëmurët Mendorë në Broadmoor.

71. Ata u mbajtën në burg në të njëjtin regjim si të burgosurit e tjerë të rrezikut standard të Kategorisë A, çka u konsiderua si klasifikimi i përshtatshëm i sigurisë mbi bazën e rrezikut që paraqisnin ata. Atyre u lejoheshin vizitorë, pasi këto vizitorë kontrolloheshin nga sigurimi, dhe mund të shoqëroheshin me të burgosurit e tjerë, të bënin telefonata, si dhe të shkruanin dhe të merrnin letra. Ata kishin mundësi të kishin një imam dhe të takoheshin me përfaqësuesit e tyre ligjorë. Ata kishin të njëjtën qasje ndaj kujdesit shëndetësor, ushtrimeve fizike, arsimit dhe punës si çdo i burgosur tjetër i kategorisë së tyre të sigurisë.

Pas një rekomandimi të inspektorit të emëruar sipas Ligjit të vitit 2001 për të shqyrtuar regjimin e ndalimit, Qeveria krijoi një Njësi Speciale në Burgun Woodhill për të mbajtur të ndaluarit e Ligjit të vitit 2001. Njësia, e cila u rinovua në konsultim me kërkuesit e ndaluar dhe me përfaqësuesit e tyre dhe kishte një staf të zgjedhur dhe trajnuar në mënyrë të posaçme, do të lejonte një regjim më të relaksuar, përfshirë edhe më shumë kohë për qëndrim jashtë qelisë. Megjithatë, kërkuesit zgjodhën që të mos lëviznin tek kjo Njësi, vendim i cili sipas inspektorit ishte për keqardhje.

72. Kërkuesi i parë, i cili pretendoi se kishte një histori keqtrajtimi në burg në Izrael dhe së pari ishte mjekuar për depresion në maj 1999, pësoi

një përkeqësim të thellë të shëndetit të tij mendor ndërkohë që mbahej në Burgun Belmarsh. Ai u transferua në Spitalin e Sigurt për të Sëmurët Mendorë në Broadmoor në korrik 2002.

73. Kërkuesi i shtatë raportoi se kishte trashëgimi familjare të çrregullimeve psikiatrike dhe kishte vuajtur nga depresioni gjatë adoleshencës. Ai pretendoi se kishte vuajtur gjithmonë e më shumë gjatë burgimit nga depresioni, paranoia, dhe halucinacionet auditive. Ai u përpoq të bënte vetëvrasje në maj 2004 dhe u transferua në Spitalin e Sigurt për të Sëmurët Mendorë në Broadmoor më 17 nëntor 2004.

74. Kërkuesi i dhjetë, me dy duar të këputura, pretendoi se ishte burgosur dhe torturuar në Algjeri. Ai pati një përkeqësim të shëndetit të tij fizik dhe mendor në Burgun Belmarsh. Ai filloi një grevë urie në maj/qershor 2003 dhe refuzoi të përdorte protezat që i ishin dhënë ose të bashkëpunonte me infermierët e tij. Në fillim të nëntorit 2003, autoritetet e burgut i tërhoqën infermierët që kujdeseshin për të. Përfaqësuesit e tij ligjorë bënë kërkesë për shqyrtim gjyqësor të këtij vendimi dhe në dhjetor 2003 kujdesi infermierik rifilloi pas urdhrin të Gjykatës Administrative. Më 1 nëntor 2003 kërkuesi i dhjetë u transferua në Spitalin e Sigurt për të Sëmurët Mendorë në Broadmoor.

75. Komisioni European për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin apo Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruës (angl. "CPT") vizitoi kërkuesit e ndaluar në shkurt 2002 dhe përsëri në mars 2004, dhe bëri disa kritika lidhur me kushtet në të cilat mbaheshin kërkuesit e ndaluar. Qeveria i mohoi këto kritika (shih paragrafët 101-102 poshtë).

76. Në tetor 2004, me kërkesë të përfaqësuesve ligjorë të kërkuesve, tetë konsulentë psikiatër përgatitën një Raport Psikiatrik të Përbashkët në lidhje me kërkuesit e ndaluar, i cili arriti në përfundimin që:

“Të ndaluarit vinë nga vende ku sëmundja mendore është tepër e stigmatizuar. Përveç kësaj, për myslimanët e devotshëm vetëvrasja ndalohet rreptësisht. Kjo është posaçërisht domethënëse duke marrë parasysh numrin e atyre që kanë tentuar apo e mendojnë vetëvrasjen. Të gjithë të ndaluarit kanë probleme të rënda mendore të cilat janë rezultat i drejtpërdrejtë, ose janë acaruar më tej nga natyra e papërcaktuar e ndalimit të tyre. Problemet mendore në të shumtën e rasteve shprehen në formën e çrregullimeve të mëdha depresive dhe ankthit. Disa të ndaluar kanë shprehur simptoma psikotike ndërkohë që gjendja e tyre është përkeqësuar. Disa të ndaluar po përjetojnë edhe PTSD [stresi post traumatik] ose si rezultat i traumave para-imigracionit, ose si pasojë e rrethanave të arrestimit dhe burgosjes së tyre, ose nga kombinimi i të dyjave.

Përkeqësimi i vazhdueshëm i shëndetit të tyre mendor po ashtu ndikohet edhe nga natyra e - dhe mosbesimi i tyre në - regjimin e burgut dhe procesi i apeleve si dhe faktori qendror i natyrës së papërcaktuar të mbajtjes së tyre. Sistemi i Kujdesit Shëndetësor i Burgut nuk mund të përmbushë nevojat e tyre për kujdes shëndetësor si duhet. Vetëlëndimi dhe sjellja e stresuar nuk perceptohet si pjesë e një gjendjeje klinike por shihet thjesht si manipulim. Nuk ofrohet aq sa duhet për problemet komplekse të shëndetit fizik.

Problemet e tyre mendore nuk kanë gjasë të zgjidhen për sa kohë që ata mbahen në gjendjen e tyre të tanishme dhe duke pasur parasysh provat e intervistave të përsëritura ka shumë mundësi që gjendja e tyre të keqësohet edhe më tej në burg.

Problemet e përshkruara nga të ndaluarit janë dukshëm të ngjashme me problemet e identifikuara në literaturën që studion ndikimet e ndalimit në procedurë imigracioni. Kjo literaturë përshkruan nivele të larta depresioni dhe ankthi dhe shpjegon me shumë elokuencë që kohëzgjatja e paraburgimit është e lidhur drejtpërdrejt me rreptësinë e simptomave dhe që është vetë paraburgimi ai që shkakton keqësimin e këtyre problemeve.”

77. Për qëllime të procedurave aktuale, Qeveria i kërkoi një Psikiatri Konsulent, Dr. J., që të komentonte lidhur me Raportin e Përbashkët Psikiatrik të përmendur më lart. Dr. J. kritikoi metodologjinë dhe përfundimet e autorëve të Raportit të Përbashkët. Në mënyrë të veçantë, ai shkroi (duke iu referuar raporteve të tjera të hequra):

“Unë do të komentoja që shumë prej konstatimeve të bëra nuk vinë nga hulumtimi i thellë. Për shembull, në rastin e [kërkuesit të parë], pas një vlerësimi të kujdesshëm dhe të hollësishëm, unë gjeta që gjendja e tij mendore pas paraburgimit dhe gjatë qëndrimit në Spitalin e Sigurt për të Sëmurët Mendorë në Broadmoor përgjithësisht nuk ishte as më e keqe, as më e mirë nga ç’kishte qenë para arrestimit. As të dhënat e tij nuk sugjerojnë përmirësime fillestare në Spitalin në Broadmoor. Unë gjeta që gjendja e tij u përkeqësua në Spitalin Belmarsh sepse ai vendosi të hynte në grevë urie dhe që gjendja e tij qe e paqëndrueshme në Spitalin Broadmoor megjithëse ai pranoi të hante, por sjellja e tij melodramatike në thelb ishte e njëjtë në të dy vendet. Në rastin e tij unë gjeta që diagnoza ishte Çrregullim Personaliteti, e jo diagnozat e Çrregullimeve të Mëdha Depresive, psikozës dhe PTSD (stres post-traumatik). Për më tepër, gjeta që vetlëndimi i tij i vazhdueshëm ishte vërtet manipulativ.

...

Unë nuk jam i vetmi që kam konstatuar se diagnozat e raportuara nga autorët e këtij raporti janë të gabuara, dhe unë tërheq vëmendjen në raportin tim lidhur me skepticizmin e disa të tjerëve që kanë raportuar mbi [kërkuesin e parë dhe kërkuesin e shtatë]. Prandaj nuk qëndron fakti që ka konsensus mendimesh siç pretendohet në raport dhe unë shënoj që në të dy rastet që kam vlerësuar [kërkuesin e parë dhe kërkuesin e shtatë], simptomat e tyre të ashtuquajtura psikotike të pretenduara prej disa raportuesve dhe kinse jo ekzistuese para ndalimit të tyre, faktikisht kanë ekzistuar përpara se ata të arrestoheshin.

Shqetësimi më i madh sipas meje është çështja që ka të bëjë me pranimin e heshtur të informacionit të përfutur nga vetraportimi. Duket se është pranuar nga autorët e raportit, për shembull, që tre prej të ndaluarve kanë qenë viktimat e ndalimit dhe torturës dhe të gjithë e kanë ndier veten seriozisht të kërcënuar para migrimit. Askund nuk kam parë ndonjë provë që i vërteton këto pretendime apo që tenton t’i kontrollojë ato. Meqenëse nga azilkërkuesit dhe imigrantët kërkohet që të arsyetojnë përpjekjet e tyre për t’iu lejuar hyrja në një vend tjetër, a nuk është e mundur apo a nuk ekziston probabiliteti që disa mund të mos jenë gjithmonë krejtësisht të sinqertë rreth përvojës së tyre në të kaluarën apo simptomave të tyre të tanishme? Kur flitet për terroristë të presupozuar duhet të kemi parasysh që ata i kanë mohuar këto akuza pavarësisht nga provat e hapura dhe të mbyllura kundër tyre, të cilat janë shqyrtuar deri në shkallën më të lartë. A nuk duhet të ngrinte kjo natyrshëm dyshime lidhur me sinqeritetin e tyre?”

## F. Lirimi i kërkuesit të pestë me dorëzani

78. Më 20 janar 2004, SIAC vendosi që parimisht duhet të lejonte dorëzanimin për kërkuesin e pestë. Sekretari i Shtetit u përpoq të apelonte kundër këtij vendimi por u informua nga Gjykata e Apelit me anë të një vendimi të përkohshëm të datës 12 shkurt 2004 që nuk kishte juridiksion për të shqyrtuar apelin.

79. SIAC shpjegoi hollësisht arsyet e veta për lejimin e dorëzimit në një vendim të datës 22 prill 2004. Aty thuhej që sipas Ligjit të vitit 2001 ai kishte pushtetin të lejonte dorëzanimin vetëm në raste të jashtëzakonshme, kur ishte i bindur që nëse nuk lejohej dorëzania gjendja mendore apo fizike e të ndaluarit do të përkeqësohej në masë të tillë që burgimi i tij i mëtijshëm do të përbënte shkelje të Nenit 3 të Konventës, si çnjerëzor, ose Neni 8, si jo proporcional.

80. SIAC vërejti që stafi i burgut kishte shprehur shqetësim lidhur me shëndetin mendor të kërkuesit të pestë në maj 2002, megjithëse këto shqetësime nuk i ishin komunikuar përfaqësuesve të tij ligjorë. Në dhjetor 2003 ai kishte rënë në gjendje të rëndë depresive me simptoma psikotike, përfshirë halucinacione auditive dhe mendime vetvrasëse. Ai ishte vizituar nga disa psikologë dhe psikiatër, me kërkesë të përfaqësuesve të tij ligjorë dhe me iniciativë të Ministrisë së Brendshme (angl. Home Office), dhe ishin pajtuar që ai ishte i sëmurë rëndë dhe që shëndeti i tij mendor me gjasë do të përmirësohej nëse ai do të lejohej të shkonte në shtëpi. SIAC arriti në përfundimin që:

“Ne nuk mendojmë se është tejkaluar kufiri ku do të kishte shkelje të të drejtave të njeriut tek [kërkuesi i pestë]. Jurisprudenca e [Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut] thekson kufirin e lartë që duhet tejkaluar dhe që burgimi nuk ka gjasa të konsiderohet si jo proporcional për sa kohë që gjatë periudhës së tij nuk ka trajtim që do të përbënte shkelje të Nenit 3. Por ne jemi të bindur që, nëse ai nuk lirohet, do të ketë një shkelje të tillë. Të lejojmë që një person të arrijë në një gjendje ku atij i duhet trajtim në spital special apo kujdes dhe vëmendje të vazhdueshme për t’u siguruar që ai nuk lëndon veten mund të përbëjë shkelje të Nenit 8, për sa kohë që nuk ka alternativë tjetër të mundshme ndaj burgimit, dhe mbase edhe të Nenit 3. Siç e kemi thënë, ne nuk duhet të presim deri sa situata të ndodhë. Për sa kohë që ne të bindemi, siç jemi të bindur, që kushtet që caktojmë janë të mjaftueshme për të minimizuar rrezikun ndaj sigurisë së shtetit nëse [kërkuesi i pestë] lirohet, ne mund të veprojmë ashtu siç kemi vepruar.

Ne duhet të theksojmë që lejimi i dorëzimit është i jashtëzakonshëm. Ne po veprojmë kështu vetëm sepse provat mjekësore tregojnë kështu dhe ndalimi ka shkakuar sëmundje mendore e cila do të keqësohet më tej...”

81. Kështu, kërkuesi i pestë u lirua me dorëzani më 22 prill 2004 në kushtet e arrestit shtëpiak. Ai nuk ishte i lejuar të largohej nga vendbanimi i tij dhe duhet të mbante pajisjen elektronike me vete gjatë gjithë kohës. Ai nuk kishte qasje në internet dhe kishte vetëm një lidhje telefonike me Shërbimin e Sigurimit. Ai duhet të raportonte me telefon në Shërbimin e Sigurimit pesë herë në ditë dhe të lejonte agentët e Shërbimit të Sigurimit

që të vinin në shtëpinë e tij në çdo kohë. Atij nuk i lejohej kontakti me persona të tjerë përveç gruas dhe fëmijës së tij, përfaqësuesit ligjor dhe një mjeku të miratuar nga Ministria e Brendshme ose të priste vizitorë pa leje paraprake nga Ministria e Brendshme.

### **G. Ngjarjet pas vendimit të Dhomës së Lordëve më 16 dhjetor 2004**

82. Deklarimi i papërputhshmërisë nga Dhoma e Lordëve më 16 dhjetor 2004, ashtu si të gjitha deklaratat e këtij lloji, nuk ishte detyrues ndaj palëve të përfshira në çështje (shih paragrafin 94 poshtë). Kërkuesit vazhduan të qëndronin në burg, përveç kërkuesit të dytë dhe të katërt të cilët kishin zgjedhur të largoheshin nga Mbretëria e Bashkuar dhe kërkuesit të pestë që ishte liruar me dorëzani në kushtet e arrestit shtëpiak. Për më tepër, asnjëri prej kërkuesve nuk lejohej, sipas ligjit vendas, të merrte kompensim për burgimin e tyre. Prandaj, kërkuesit bënë një kërkesë drejtuar Gjykatës më 21 janar 2005.

83. Në fund të janarit 2005, Qeveria shprehu synimet e saj për të hequr Pjesën 4 të Aktit të vitit 2001 dhe për ta zëvendësuar atë me një regjim urdhrash kontrolli, i cili do të caktonte disa kufizime mbi individët, pavarësisht nga kombësia, për të cilët kishte arsye të dyshohej se ishin të përfshirë në terrorizëm.

84. Kërkuesit që ishin ende në burg u liruan më 10-11 mars 2005 dhe menjëherë kaluan nën efektin e urdhrave të kontrollit sipas Ligjit për Parandalimin e Terrorizmit të vitit 2005, i cili hyri në fuqi më 11 mars 2005.

85. Qeveria e tërhoqi notën e derogimit më 16 mars 2005.

86. Më 11 gusht 2005, pas negociatave të filluara nga fundi i vitit 2003 për të kërkuar nga Qeveritë e Algjerisë dhe Jordanisë garanci që kërkuesit nuk do të keqtrajtoheshin nëse do të ktheheshin, Qeveria u dërgoi Letër për Qëllim Dëbimi kërkuesve të pestë, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë, dhjetë dhe njëmbëdhjetë. Këto kërkues u morën në burgim imigracioni në pritje të largimit për në Algjeri (kërkuesi i pestë, i gjashtë, i shtatë, i nëntë, i dhjetë dhe i njëmbëdhjetë) dhe Jordani (kërkuesi i tetë). Më 9 prill 2008 Gjykata e Apelit vendosi që kërkuesi i tetë nuk mund të ekstradohej ligjërisht për në Jordani, sepse kishte gjasa që provat të cilat ishin marrë përmes torturës mund të përdroreshin kundër tij atje në gjyq, në shkelje flagrante të së drejtës së tij për gjyq të drejtë. Në datën e miratimit të vendimit në fjalë, çështja ishte në pritje para Dhomës së Lordëve.

## B. LIGJI DHE PRAKTIKA PËRKATËSE VENDASE

### A. Ndalimi në pritje të dëbimit para miratimit të Ligjit të vitit 2001

87. Sipas seksionit 3(5) të Ligjit të Imigracionit të vitit 1971, Sekretari i Shtetit mund të merrte një urdhër dëbimi kundër një jo-shtetasi, me arsytim që dëbimi bëhej për të mirën publike, për arsye të sigurisë kombëtare, *inter alia*. Një person që i nënshtrohej një urdhri dëbimi mund të mbahej i ndaluar në pritje të dëbimit (Ligji i vitit 1971, Skema 3 paragrafi 2). Megjithatë, në *R. Kundër Guvernatorit të Burgut Durham ex parte Hardial Singh* [1984] 1 WLR 704 u vendos që pushteti për të ndaluar sipas dispozitave të mësipërme ishte i kufizuar për një periudhë kohore të arsyeshme brenda së cilës do të mundësohej realizimi i procesit të dëbimit. Pra, ndalimi nuk ishte i lejueshëm sipas Ligjit të vitit 1971 ku dëbimi dihej se ishte i pamundur, qoftë për shkak se asnjë vend nuk ishte i gatshëm ta pranonte personin në fjalë, apo qoftë për shkak se ekzistonte rreziku i torturës apo keqtrajtimit serioz ndaj të depërtuarit të propozuar pas kthimit të tij në vendin e origjinës.

### B. Ligji i Terrorizmit i vitit 2000

88. Në korrik të vitit 2000 Parlamenti miratoi Ligjin e Terrorizmit 2000. Siç vërejtj Lordi Bingham në vendimin e tij lidhur me çështjen në fjalë, “kjo ishte një masë substanciale, me 131 seksione dhe 16 Skema, me qëllim të transformimit, modernizimit dhe fuqizimit të ligjit lidhur me problemin në ritje të terrorizmit”. “Terrorizmi” u përkufizua, në seksionin 1 të Ligjit, si:

“... përdorimi ose kërcënimi për veprim aty ku—

- (a) veprimi hyn brenda nën-seksionit (2),
  - (b) përdorimi apo kërcënimi synon të ndikojë tek qeveria apo të frikësojë publikun ose një pjesë të publikut, dhe
  - (c) përdorimi apo kërcënimi bëhet me qëllim të avancimit të një kauze politike, fetare apo ideologjike.
- (2) Veprimi hyn brenda këtij nën-seksioni nëse ai—
- (a) përfshin dhunë serioze kundër një personi,
  - (b) përfshin dëme të rënda ndaj pronës,
  - (c) rrezikon jetën e një njeriu tjetër, jo të personit që kryen veprimin,
  - (d) shkakton rrezik serioz ndaj shëndetit ose sigurisë së publikut apo një pjese të publikut, ose
  - (e) është përgatitur me qëllim që të ndërhyjë ose të çrregullojë seriozisht një sistem elektronik.

(3) Përdorimi apo kërcënimi për veprim brenda nën-seksionit (2) i cili përfshin përdorimin e armëve të zjarrit ose mjeteve shpërthyesë është terrorizëm pavarësisht nga përmbushja ose jo e nën-seksionit (1)(b).

(4) Në këtë seksion—

(a) ‘veprim’ përfshin veprimet jashtë Mbretërisë së Bashkuar,

(b) referenca ndaj një personi apo prone është referencë ndaj personit apo pronës, kudo qofshin,

(c) referenca ndaj publikut përfshin referencën ndaj publikut të një shteti tjetër, jo Mbretërisë së Bashkuar, dhe

(d) ‘qeveria’ nënkupton qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar, e një pjese të Mbretërisë së Bashkuar ose të një vendi tjetër, jo Mbretërisë së Bashkuar.

(5) Në këtë Ligj, referenca ndaj veprimit të marrë për qëllime terrorizmi përfshin referencën ndaj veprimit të marrë në dobi të organizatës së ndaluar”.

Për qëllime të Aktit, një organizatë është “e ndaluar” nëse:

3. (1) ...

(a) është e renditur në Skemën 2, ose

(b) vepron me të njëjtin emër si një organizatë e renditur në atë Skemë.

(2) Nën-seksioni (1)(b) nuk zbatohet në lidhje me një organizatë të renditur në Skemën 2 nëse vendosja e tij aty është subjekt i një shënimi në atë Skemë.

(3) Sekretari i Shtetit mundet që përmes një urdhri—

(a) të shtojë një organizatë në Skemën 2;

(b) të heqë një organizatë nga ajo Skemë;

(c) ta ndryshojë Skemën në ndonjë mënyrë tjetër.

(4) Sekretari i Shtetit mund të ushtrojë pushtetin e tij sipas nën-seksionit (3)(a) në lidhje me një organizatë vetëm nëse ajo beson se kjo organizatë është e lidhur me terrorizëm.

(5) Për qëllime të nën-seksionit (4) një organizatë është e lidhur me terrorizëm nëse—

(a) kryen apo merr pjesë në akte terrorizmi,

(b) përgatitet për terrorizëm,

(c) promovon apo nxit terrorizmin, ose

(d) është e lidhur në mënyra të tjera me terrorizëm.”

89. Pjesa II e Ligjit krijoi vepra penale të anëtarësimit dhe mbështetjes për organizata të ndaluara; ajo krijoi vepra për mbledhjen e fondeve, përdorimin dhe posedimin e fondeve të terrorizmit, hyrja në marrëveshje për transferimin e fondeve terroriste, shpëlarja e parave dhe mos-zbulimi i shpëlarjes së dyshuar të parave. Kishte disa vepra substantive në Pjesën IV, përfshirë vepra lidhur me trajnimin për armë; drejtim terrorizmi; posedim, pa justifikim të arsyeshëm, të artikujve që mund të përdoren nga një person që kryen apo përgatit një akt terrorist; dhe grumbullimi, pa justifikim të

arsyeshëm, të informacionit që mund të përdoret nga një person që kryen apo përgatit një akti terrorist. Përmes seksionit 62, Ligji ishte hapësirë veprimi ekstra-territoriale, çka nënkupton se një person brenda juridiksionit të Mbretërisë së Bashkuar mund të ndiqej penalisht për cilëndo prej veprave të lartpërmendura pavarësisht se ku janë kryer aktet lidhur me jetësimin e atyre veprave.

### C. Ligji për Anti-Terrorizëm, Krim dhe Siguri i vitit 2001

90. Pjesa 4 e Ligjit të vitit 2001 (shih paragrafin 12 lart), i cili titullohej “Imigracioni dhe Azili”, përcaktonte pushtetin i cili mundësonte ndalimin e jo-shtetasve të dyshuar si terroristë ndërkombëtarë, edhe kur dëbimi i tyre ishte i pamundur në atë kohë. Ligji i vitit 2001 parashikonte, për sa kohë që materiali:

“PJESA 4

IMIGRACIONI DHE AZILI

*Terroristët e dyshuar ndërkombëtarë*

#### 21. Terrorist i dyshuar ndërkombëtar: certifikimi

(1) Sekretari i Shtetit mund të lëshojë një certifikatë sipas këtij seksioni në lidhje me një person nëse Sekretari i Shtetit me arsye-

(a) beson që prania e atij personi në Mbretërinë e Bashkuar është rrezik për sigurinë kombëtare, dhe

(b) dyshon që personi është terrorist.

(2) Në nën-seksionin (1)(b) ‘terrorist’ nënkupton një person i cili-

(a) është ose ka qenë i lidhur në kryerjen, përgatitjen apo nxitjen e akteve të terrorizmit ndërkombëtar,

(b) është anëtar i ose i përket një grupi terrorist ndërkombëtar, ose

(c) ka lidhje me një grup terrorist ndërkombëtar.

(3) Një grup quhet grup terrorist ndërkombëtar për qëllime të nën-seksionit (2)(b) dhe (c) nëse—

(a) i nënshtrohet kontrollit apo ndikimit të personave jashtë Mbretërisë së Bashkuar, dhe

(b) Sekretari i Shtetit dyshon që ai është i lidhur në kryerjen, përgatitjen apo nxitjen e akteve të terrorizmit ndërkombëtar.

(4) Për qëllime të nënseksionit (2)(c) një person ka lidhje me një grup terrorist ndërkombëtar vetëm nëse ai e mbështet ose e ndihmon atë.

(5) Në këtë Pjesë—

“terrorizëm” ka kuptimi që i jepet nga seksioni 1 i Ligjit të Terrorizmit të vitit 2000 (c. 11), dhe

“terrorist i dyshuar ndërkombëtar” nënkupton një person të certifikuar sipas nën-seksionit (1).



(6) Kur Sekretari i Shtetit lëshon një certifikatë sipas nën-seksionit (1), sa më shpejt që të jetë praktike dhe e arsyetuar ajo do të-

(a) ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të lajmëruar personin e certifikuar, dhe

(b) dërgojë një kopje të certifikimit Komisionit të Posaçëm për Ankesa të Imigracionit.

(7) Sekretari i Shtetit mund të revokojë një certifikatë të lëshuar sipas nën-seksionit (1).

(8) Një vendim i Sekretarit të Shtetit në lidhje me certifikimin sipas këtij seksioni mund të kontestohet me anë të procedurave ligjore vetëm sipas seksionit 25 ose 26.

(9) Një veprim i Sekretarit të Shtetit i marrë krejtësisht ose pjesërisht duke u mbështetur mbi një certifikatë sipas këtij seksioni mund të kontestohet me anë të procedurave ligjore vetëm sipas ose gjatë procedurave në përputhje me-

(a) seksionin 25 ose 26, ose

(b) seksionin 2 të Aktit të vitit 1997 mbi Komisionin e Posaçëm të Ankesave të Imigracionit (c. 68) (apeli).

## **22. Dëbimi, zhvendosja, etj.**

(1) Një veprim i llojit të specifikuar në nën-seksionin (2) mund të merret në lidhje me një terrorist të dyshuar ndërkombëtar pavarësisht nga fakti që (qoftë për kohësisht apo në kohë të pacaktuar) veprimi nuk mund të rezultojë në largimin e tij nga Mbretëria e Bashkuar për shkak të-

(a) një çështjeje ligjore e cila varet tërësisht ose pjesërisht nga një marrëveshje ndërkombëtare, ose

(b) një konsiderate praktike ...

(2) Veprimet e përmendura në nën-seksionin (1) janë—

...

(e) marrja e një urdhri për dëbim ...

(3) Veprimi i llojit të specifikuar në nën-seksionin (2) i cili ka efekt në lidhje me një terrorist të dyshuar ndërkombëtar në kohën e certifikimit të tij sipas seksionit 21 do të trajtohet si i rimarrë (në mbështetje të nën-seksionit (1) lart) menjëherë pas certifikimit.

## **23. Ndalimi**

(1) Një terrorist i dyshuar ndërkombëtar mund të ndalohet sipas një dispozite të specifikuar në nën-seksionin (2) pavarësisht nga fakti që largimi apo nisja e tij nga Mbretëria e Bashkuar është i ndaluar (qoftë për kohësisht apo në kohë të pacaktuar) me anë të-

(a) një çështjeje ligjore e cila tërësisht ose pjesërisht ndërlidhet me një marrëveshje ndërkombëtare, ose

(b) një konsideratë praktike.

(2) Dispozitat e përmendura në nën-seksionin (1) janë—

(a) paragrafi 16 i Skemës 2 të Ligjit të Imigracionit të vitit 1971 (c. 77) (ndalimi i personave që i nënshtrohen marrjes në pyetje ose largimit), dhe

(b) paragrafi 2 i Skemës 3 të atij Ligji (ndalimi në pritje të dëbimit).”

Pjesa 4 e Ligjit të vitit 2001 përfshinte një dispozitë që legjislacioni do të mbetej në fuqi vetëm për pesë vjet dhe duhet t’i nënshtrohej një rezolute konfirmuese vjetore nga të dyja Dhomat e Parlamentit.

#### **D. Komisioni i Posaçëm për Ankesat e Imigracionit**

91. Komisioni i Posaçëm për Ankesat e Imigracionit (angl. “SIAC”) u ngrit pas vendimit të Gjykatës në çështjen *Chahal kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], vendimi i datës 15 nëntor 1996, *Përmbledhje e Vendimeve*<sup>1</sup> 1996-V). Është një tribunal i përbërë nga gjyqtarë të pavarur, me të drejtën apelimi kundër vendimeve mbi çështje ligjore pranë Gjykatës së Apelit dhe Dhomës së Lordëve.

Sipas seksionit 25 të Ligjit të vitit 2005:

“(1) Një terrorist i dyshuar ndërkombëtar mund të apelojë tek Komisioni i Posaçëm për Ankesa të Imigracionit kundër certifikimit të tij sipas seksionit 21.

(2) Në lidhje me një apel [SIAC] mund ta anulojë certifikatën nëse–

(a) ai konsideron që nuk ka baza të arsyeshme për besimin apo dyshimin e llojit të specifikuar në seksionin 21(1)(a) ose (b), ose

(b) nëse ai konsideron që për arsye të tjera certifikata nuk duhet të ishte lëshuar.”

SIAC-it iu kërkua që të zhvillonte një shqyrtim të parë për t’u siguruar që certifikata vazhdonte të ishte e justifikuar gjashtë muaj pas lëshimit të saj ose gjashtë muaj pas vendimeve përfundimtarë lidhur me apelin kundër certifikimit, dhe më pas në intervale tre-mujore.

Sipas seksionit 30 të Ligjit të vitit 2001, çdo kontestim ligjor ndaj derogimit sipas Nenit 15 të Konventës do të duhet të paraqitej edhe para SIAC-it.

92. SIAC ka një procedurë të veçantë e cila i mundëson të shqyrtojë jo vetëm materialin i cili mund të bëhet publik (“materiali i hapur”) por edhe materialin i cili, për arsye sigurie kombëtare, nuk mund të bëhet publik (“materiali i mbyllur”). As kërkuesi, as këshilltari i tij ligjor nuk mund ta shohin materialin e mbyllur. Rrjedhimisht, një ose dy këshilltarë me autorizim sigurie, të quajtur “Avokat të posaçëm”, emërohen nga Kryeavokati i Përgjithshëm Juridik për të vepruar në emër të secilit kërkues.

93. Në apelet kundër certifikimeve që i janë paraqitur SIAC-it në rastin konkret, deklaratat e hapura dhe provat lidhur me secilin apelues janë paraqitur të parat, dhe Avokati i posaçëm e ka pasur mundësinë ta diskutonte këtë material me apeluesin dhe këshilltarët e tij ligjorë dhe të merrte udhëzime të përgjithshme. Pastaj materiali i mbyllur iu zbulua gjyqtarëve dhe Avokatit të posaçëm, dhe prej atij momenti nuk mund të kishte më kontakte mes këtij të fundit dhe apeluesit dhe/ose përfaqësuesve

<sup>1</sup> Mbi pranueshmërinë dhe themelin (*Shën. i përkth.*)

të tij pa lejen e SIAC-it. Roli i Avokatit të posaçëm gjatë seancave të mbyllura ishte që të bënte parashtrës në emër të apeluesit, si për sa u përket çështjeve procedurale, siç është nevojshmëria për zbulimin e mëtejshëm, ashtu edhe për sa i përket substancës së çështjes. Në lidhje me secilin apel kundër certifikimit, SIAC lëshoi një vendim të “hapur” dhe një vendim të “mbyllur”. Avokati i posaçëm mund t’i shihte të dy por i ndaluar dhe përfaqësuesit e tij mund të shihnin vetëm vendimin e hapur.

#### **E. Deklaratat e papërputhshmërisë sipas Ligjit të të Drejtave të Njeriut të vitit 1998**

94. Seksioni 4 i Ligjit të vitit 1998 parashikon që kur gjykata gjen që legjislacioni primar është në shkelje të Konventës, gjykata mund të bëjë një deklaratë papërputhshmërie. Një deklaratë e tillë nuk ndikon tek vlefshmëria e dispozitës në lidhje me të cilën bëhet, dhe nuk ka fuqi detyruese ndaj palëve në procedurën në të cilët ajo bëhet, por mund të duhen rregullime të veçanta (seksioni 10) për të ndryshuar dispozitën në mënyrë që të shmanget papërputhshmëria (shih më tej *Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], nr. 13378/05, §§ 21-24 dhe 40-44, KEDNJ 2008).

#### **F. Ligji i Terrorizmit i vitit 2006**

##### **95. Ligji i Terrorizmit i vitit 2006 hyri në fuqi më 20 mars 2006.**

Ligji i Terrorizmit i vitit 2006 hyri në fuqi më 30 mars 2006, duke krijuar një numër veprash për zgjerimin e përgjegjësisë penale për vepra përgatitore për vepra terroriste të krijuara nga Ligji i Terrorizmit i vitit 2000. Veprat e reja ishin inkurajimi, shpërndarja e botimeve, përgatitja dhe stërvitja. Veprat ishin hartuar për të ndërhyrë në një fazë të hershme të aktivitetit terrorist për të parandaluar kështu zhvillimin e veprimeve më të rënda. Po ashtu ato ishin hartuar në mënyrë të atillë që të ishin më të lehta për t’u vërtetuar.

#### **G. Konsideratat e përdorimit të Avokatëve të Posaçëm sipas Ligjit për Parandalimin e Terrorizmit të vitit 2005**

96. Më 31 tetor 2007 Dhoma e Lordëve mori vendim në çështjen *Sekretari i Shtetit për Departamentin e Punëve të Brendshme (Përgjegjës) kundër MB (FC) (Kërkuesi)* [2007] UKHL 46, i cili kishte të bënte me një kontestim të një urdhri kontrolli jo-derogues të marrë nga Sekretari i Shtetit sipas seksioneve 2 dhe 3 (1)(a) të Ligjit për Parandalimin e Terrorizmit të vitit 2005. Dhomës së Lordëve iu desh të vendoste, *inter alia*, nëse procedurat e parashikuara nga seksioni 3 i Ligjit të vitit 2005, të cilat përfshinin seancat dëgjimore të mbyllura dhe avokatët e posaçëm, ishin në përputhje me Nenin 6 të Konventës, duke pasur parasysh që, në rastin e

njëri prej kërkuesve, ato kishin rezultuar në një çështje kundër kërkuesit në thelb të saj krejtësisht e pazbuluar, me asnjë akuzë konkrete për aktivitet të lidhur me terrorizëm në materialin e hapur.

Dhoma e Lordëve njëzëri vendosi që procedurat në fjalë përcaktonin të drejtat dhe detyrimet civile dhe kështu kërkonin mbrojtjen e Nenit 6. Lidhur me çështjen e pajtueshmërisë, shumica (Baronesha Hale e Riçmondit, Lordi Carswell dhe Lordi Brown nga Eaton-under-Heywood) u shprehën që, megjithëse në shumë raste procedura e avokatit të posaçëm do të ofronte një kundërpeshë të mjaftueshme aty ku Sekretari i Shtetit dëshironte të mbante të pazbuluara materiale mbi të cilat ajo donte të bazohej për të konstatuar bazat e arsyeshme për dyshimin që i kontrolluari ishte ose kishte qenë i përfshirë në aktivitete të lidhura me terrorizëm, çdo rast duhet të shqyrtohej në mënyrë individuale. Baronesha Hale u shpreh si vijon:

“65. ... E gjitha varet nga natyra e çështjes; çfarë hapash janë marrë për të shpjeguar hollësitë e akuzave kundër personit të kontrolluar në mënyrë që ai të mund të parashikojë se çfarë materialesh mbështetëse mund të ketë; cilat hapa janë marrë për të përmbledhur materialin e mbyllur mbështetës pa zbuluar emra, data ose vende; natyra dhe përmbajtja e materialit të pazbuluar; sa efektivë kanë qenë avokatët e posaçëm në kontestimin e këtij materiali në emër të personit të kontrolluar; dhe çfarë ndryshimi do të mund të kishte pasur zbulimi i atij materiali. Të gjithë këta faktorë do të ishin relevantë ndaj faktit nëse personit të kontrolluar do t'i ishte ‘dhënë një mundësi domethënëse për të kontestuar bazën faktike’ të urdhrit.

66. Nuk mendoj se duhet të jemi të bindur që Strasburgu do të vendoste që çdo seancë për urdhër kontrolli në të cilën përdoret procedura e Avokatit të posaçëm, siç parashikohet nga Ligji i vitit 2005 dhe Pjesa 76 e Neneve të Procedurës Civile, do të ishte e mjaftueshme për të qenë në përputhje me Nenin 6. Megjithatë, me përpjekje të mëdha nga të gjithë, sado e vështirë dhe sado kohë që të marrë, zakonisht do të duhej të ishte e mundur që t'i lejohet personit të kontrolluar një ‘masë substanciale drejtësie procedurale’. Çdo person i përfshirë do të duhet të bëjë maksimumin e vet për të siguruar që ‘parimet e hetimeve gjyqësore’ të respektohen në masë sa më të madhe të mundshme. Sekretari i Shtetit duhet të japë një shpjegim sa më të plotë lidhur me arsyen përse ai konsideron që bazat në seksionin 2(1) kanë kuptim. Sa më i plotë që është shpjegimi i dhënë, aq më të plota janë udhëzimet që marrin avokatët e posaçëm nga klienti para se të shohin materialin e mbyllur. Si gjyqtari, ashtu edhe Avokati i Posaçëm duhet të hetojnë pretendimin që materiali i mbyllur duhet të mbetet i mbyllur me kujdes të madh dhe me skepticizëm të konsiderueshëm. Ka prova të bollshme nga diku tjetër lidhur me një tendencë për të mbi-pretenduar nevojën për fshehtësi në raste terrorizmi: shih Serrin Turner dhe Stephen J Schulhofer, Problemi i Fshehtësisë në Gjyqet e Terrorizmit, 2005, Qendra për Drejtësi Brennan në Fakultetin e Juridikut të Universitetit të Nju Jorkut (NYU School of Law). Si gjyqtari, ashtu edhe avokatët e posaçëm do të duhet të testojnë në mënyrë të rreptë materialin i cili mbetet i mbyllur. Të gjithë duhet ta kenë parasysh që ekziston mundësia që materiali mund të redaktohet ose thelbësohet në mënyrë të atillë që t'u mundësojë avokatëve të posaçëm që të kërkojnë udhëzimet e klientëve lidhur me të. Të gjithë duhet ta kenë parasysh që ekziston mundësia që avokatëve të posaçëm t'u jepet leje për të bërë pyetje specifike dhe të hartuara me kujdes në emër të klientëve të tyre. Megjithëse nuk parashikohet në mënyrë specifike në Nenet e Procedurës Penale nr. 76.24, avokati i posaçëm duhet të jetë në gjendje të ftojë ose të kërkojë të ftohen dëshmitarë për të kontestuar materialin

e mbyllur. Natyra e çështjes mund të jetë e atillë që klienti nuk ka nevojë t'i dijë të gjitha hollësitë e provave për t'i kontestuar efektivisht akuzat.

67. Gjyqtari më i mirë i faktit nëse procedurat kanë ofruar mbrojtje procedurale të mjaftueshme dhe substanciale në masë substanciale ka gjasë të jetë gjyqtari që udhëheq seancën dëgjimore...”

Lordi Carswell vërejt:

“Ekziston një spektër i gjerë çështjesh në lidhje me të cilat Sekretari i Shtetit bazohet mbi materialin e mbyllur. Nga njëra anë, mund të ketë çështje në të cilat provat e vetme kundër të kontrolluarit ndodhen në materialin e mbyllur, atij nuk mund t'i tregohet se cilat janë provat as cili është thelbi i tyre, dhe avokati i posaçëm nuk është në pozicion që të marrë udhëzime të mjaftueshme për të hartuar një kontestim efektiv të akuzave kundër klientit. Nga ana tjetër, mund të ketë çështje ku efekti provues i materialit të mbyllur është shumë i lehtë apo thjesht vërtetues i provave të forta në materialin e hapur dhe nuk ka pengesa për paraqitjen e mbrojtjes. Ndërkohë, ekzistojnë lloje pa fund çështjesh të mundshme mes këtyre dy llojeve të përmendura. Ekuilibri mes materialit të hapur dhe materialit të mbyllur dhe natyrës provuese të secilit prej tyre ndryshon nga çështja në çështje. Avokati i posaçëm mund të jetë në gjendje të dallojë me qartësi të mjaftueshme se si ta administrojë materialin e mbyllur pa marrë udhëzime të drejtpërdrejta nga i kontrolluari. Këto janë çështje që i peshon dhe vlerëson gjyqtari gjatë marrjes së vendimit nëse i kontrolluari ka pasur një gjyq të drejtë. Vlerësimi është ... i hollësishtëm me fakte. Gjyqtari që i ka parë edhe materialin e mbyllur edhe materialin e hapur dhe ka pranuar kontributet e avokatit të posaçëm është në pozicionin më të mirë për ta bërë këtë. Megjithatë, unë ende konsideroj që i kontrolluari mban një peshë relativisht të rëndë për sa i përket përcaktimit të ekzistimit të shkeljes së Nenit 6, meqenëse interesit legjitim publik të fshehjes së materialit mbi baza të vlefshme duhet t'i jepet pesha e duhur. Gjykatat nuk duhet të jenë tepër të gatshme për të vendosur që një disavantazh i të kontrolluarit përmes fshehjes së materialeve përbën shkelje të Nenit 6.”

Lordi Brown u shpreh si vijon:

“Mbase mund të ketë çështje, sado të pazakonta që mund të jenë, ku, pavarësisht nga përpjekjet më të mira të të gjitha palëve përmes redaktimit, anonimizimit, dhe thelbësimit, është thjesht e pamundur të tregohet mjaftueshëm nga argumentet e Sekretarit të Shtetit sa për t'i mundësuar të dyshuarit që të paraqesë një kontestim efektiv të tyre. Vetëm nëse në këto raste gjyqtari mund të ndihet mjaft i sigurt që sido që të jetë asnjë kontestim i mundshëm nuk do të mundte kurrsesi të fitonte (një përfundim i vështirë por jo i pamundur, do të thoja...), ai do të duhej të arrinte në përfundimin që marrja ose, sipas rastit, konfirmimi i një urdhri vërtet do të përbënte padrejtësi të konsiderueshme ndaj të dyshuarit. Shkurt, të dyshuarit në një rast të tillë nuk do t'i ishte dhënë as ‘një masë substanciale drejtësie procedurale’ (*Chahal* [cituar lart] § 131) pavarësisht nga përdorimi i procedurës së avokatit të posaçëm; ‘vetë thelbi i të drejtës [së tij] për [një seancë të drejtë] [do të kishte qenë] dëmtuar’ (*Tinnelly & Sons Ltd. dhe McElduff kundër Mbretërisë së Bashkuar* [cituar lart] § 72).

Lordi Bingham nuk kundërshtoi por zbatoi një arsyetim të ndryshëm. Ai u shpreh që ishte e nevojshme të shikohej procesi në tërësi dhe të konsiderohej nëse procedura e zbatuar përmbante padrejtësi të konsiderueshme ndaj të kontrolluarit; ndërkohë që përdorimi i avokatëve të posaçëm mund të ndihmonte në fuqizimin e shkallës së drejtësisë procedurale ofruar të kontrolluarit, ai nuk mund të kompensonte plotësisht

disavantazhet serioze të një personi që nuk ishte në dijeni të argumenteve kundër tij dhe nuk ishte në gjendje, rrjedhimisht, të udhëzonte avokatin e posaçëm në mënyrë efektive.

Lordi Hoffman, i cili kundërshtoi, u shpreh që pasi gjyqtari vendos që zbulimi do të ishte në kundërshtim me interesat publike, përdorimi i avokatëve të posaçëm ofronte mbrojtje të mjaftueshme për të kontrolluarin dhe në këto rrethana nuk do të kishte kurrë shkelje të Nenit 6.

97. Në çështjen *Sekretari i Shtetit i Departamentit të Punëve të Brendshme (Home Department) kundër AF* [2008] EWCA Civ 1148, Gjykata e Apelit (Sër Anthony Clark MR dhe Waller JJ; Sedley LJ kundërshtuan), dha udhëzimet vijuese, duke u bazuar mbi mendimin e shumicës në *MB*, lidhur me respektimin e Nenit 6 në rastet e urdhrat të kontrollit me përdorimin e avokatëve të posaçëm (pjesë e shkëputur nga shënimi në krye):

(1) Gjatë marrjes së vendimit lidhur me faktin nëse seanca dëgjimore sipas seksionit 3(10) të Aktit të vitit 2005 kishte shkelur të drejtat e të kontrolluarit sipas Nenit 6, çështja ishte nëse, e marrë në tërësi, seanca ishte thelbësisht e padrejtë ndaj të kontrolluarit, apo atij nuk i ishte akorduar një shkallë substanciale drejtësie procedurale ose vetë thelbi i së drejtës së tij për seancë të drejtë ishte dëmtuar. E parë në spektër më të gjerë, çështja ishte nëse efekti i procesit ishte që i kontrolluari i ishte nënshtruar padrejtësisë së konsiderueshme. (2) Duhet të merren të gjitha hapat e duhur për t'i ofruar të kontrolluarit sa më shumë informacione që të jetë e mundur, qoftë në aspekt të akuzave apo të provave, nëse është e nevojshme duke ia thënë thelbin e përshtatshëm. (3) Aty ku nuk ishin dhënë akuzat dhe provat e plota për arsye sigurie kombëtare që në fillim, të kontrolluarit duhet t'i jepej një avokat i posaçëm. Në një rast të tillë u zbatuan parimet vijuese. (4) Nuk kishte një parim sipas të cilit një seancë dëgjimore do të ishte e padrejtë në mungesë të zbulimit të hapur ndaj të kontrolluarit të një minimumi të pashndërrueshëm akuzash ose provash. Përndryshe, po të kishte një parim të tillë, minimumi i pashndërrueshëm do të mund të përmbushej, varësisht nga rrethanat, me aq pak informacion sa jepej në çështjen AF, çka ishte vërtet shumë pak. (5) Nëse një seancë ishte e drejtë ose jo varej nga të gjitha rrethanat, përfshirë natyrën e çështjes, hapat e ndërmarrë për t'ia shpjeguar të kontrolluarit akuzat me detaje në mënyrë që ai të mund të planifikonte se çfarë materialesh mbështetëse duheshin, çfarë hapash ishin marrë për të përmbledhur materialin e mbyllur mbështetës pa zbuluar emra, data ose vende, natyra dhe përmbajtja e materialit të fshehur, sa me efektivitet ka arritur ta kontestojë avokati i posaçëm në emër të të kontrolluarit dhe çfarë dallimi do të bënte ose mund të bënte zbulimi i tij. (6) Duke konsideruar nëse zbulimi i hapur ndaj të kontrolluarit do të kishte shkaktuar ndonjë ndryshim në përgjigjen e dhënë ndaj pyetjes nëse kishte baza të arsyeshme për dyshimin që i kontrolluari ishte ose kishte qenë në aktivitete të lidhura me terrorizmin, gjykatës i duhej të mbante parasysh problemet e të kontrolluarit dhe avokatëve të posaçëm dhe të merrte parasysh të gjitha rrethanat e çështjes, përfshirë edhe informacionin që ishte zbuluar, nëse ndonjë informacion ishte zbuluar, dhe sa efektivë ishin në gjendje të tregoheshin avokatët e posaçëm. Mënyra e saktë për të administruar dhe për të matur peshën që i duhej dhënë çdo faktori të veçantë do të varej nga rrethanat specifike. (7) Nuk kishte parime të rrepta. Se çfarë ishte e drejtë ishte në dorë të gjyqtarit ta vendoste, dhe në vendimin e tij shumë rrallë ndërhynte Gjykata e Apelit.”

### III. KOMENTET NË VEND DHE JASHTË VENDIT MBI PJESËN 4 TË LIGJIT TË VITIT 2001

#### A. Komisioni Newton

98. Pjesa 4 e Ligjit të vitit 2001 parashikonte krijimin e një Komisioni Këshilltarësh të Brendshëm për shqyrtimin e operacioneve të tij. Komisioni, nën kryesinë e Lordit Newton, raportoi në dhjetor 2003. Pas shqyrtimit të argumentit të Ministrisë së Punëve të Brendshme (Home Office) që kërcënimi nga terrorizmi i al'Qaedës vinte në mënyrë dominuese nga të huajt, Komisioni Newton tërhoqi vëmendjen ndaj:

“provave të mbledhura që nuk është më kështu. Britanikët vetëvrasës me bombë që sulmuan Tel Avivin në maj 2003, Richard Reid (‘Bombarduesi me Këpuçë’), dhe arrestime të kohëve të fundit sugjerojnë që kërcënimi nga shtetasit e Mbretërisë së Bashkuar është real. Pothuaj 30% e të dyshuarve nga Akti i Terrorizmit i vitit 2000 gjatë vitit të kaluar janë britanikë. Na është thënë se, mes personave që u interesojnë autoriteteve për shkak të përfshirjes së tyre të dyshuar në terrorizëm ndërkombëtar, pothuaj gjysma e tyre janë shtetas britanikë.”

Duke pasur parasysh këto prova, Komisioni Newton vërejtë që jo vetëm që kishte argumente parimore kundër ekzistimit të dispozitave diskriminuese, por kishte argumente bindëse të efikasitetit të kufizuar në adresimin e kërcënimit terrorist. Prandaj, Komisioni Newton kërkoi futjen urgjentisht të ligjeve të reja të cilat do të merreshin me kërcënimin terrorist pa diskriminim mbi baza kombësie dhe të cilat nuk do të kërkonin derogim nga Neni 5 i Konventës.

99. Në shkurt 2004, Qeveria publikoi përgjigjen e saj ndaj raportit të Komisionit Newton. Ajo vazhdoi të pranonte faktin që kërcënimi terrorist “vinte në mënyrë dominuese, por jo ekskluzivisht vetëm nga, shtetasit e huaj” dhe bëri vërejtjen e mëposhtme në lidhje me sugjerimin e Komisionit Newton që masat anti-terroriste duhet të zbatoheshin ndaj të gjithë personave brenda juridiksionit pavarësisht nga kombësia:

“Ndërkohë që do të ishte e mundur të kërkohej pushtet tjetër për të ndaluar shtetasit britanikë të cilët mund të jenë të përfshirë në terrorizëm ndërkombëtar, ky do të ishte një hap shumë i rëndë. Qeveria beson se një pushtet i tillë drakonik do të ishte i vështirë për t’u justifikuar. Përvoja ka treguar rreziqet e një qasjeje të tillë dhe dëmin që mund t’i shkaktojë kohezionit të komunitetit e rrjedhimisht mbështetjes nga të gjitha shtetasit e publikut e cila është kaq thelbësore për përballimin e kërcënimit terrorist.”

Qeveria gjithashtu tregoi që po punohej për të arritur marrëveshje kornizë me vende të mundshme destinacioni për qëllime dëbimi të të dyshuarve terroristë.

## B. Komisioni i Përbashkët Parlamentar për të Drejtat e Njeriut

100. Komisioni i Përbashkët mban përgjegjësi kushtetuese në Mbretërinë e Bashkuar për këqyrjen e legjislacionit për t'u siguruar që të jetë në përputhje me të drejtat e Konventës. Në Raportin të tij të Dytë të Sesionit 2001-2002, hartuar pak pas publikimit të Ligjit i cili u bë Ligji i vitit 2001, Komisioni i Përbashkët shprehu shqetësimin e tij mbi efektin me gjasë diskriminues të masës së propozuar, si vijon:

“38. Së dyti, duke u mbështetur mbi ligjin për imigracionin për të ofruar bazën për ndalimin e terroristëve të dyshuar ndërkombëtarë, Ligji rrezikon të diskriminojë, duke autorizuar ndalimin pa akuza, mes atyre terroristëve të dyshuar ndërkombëtarë që i nënshtrohen kontrollit të imigracionit dhe atyre që kanë të drejtë të pakushtëzuar qëndrimi në Mbretërinë e Bashkuar. Ne jemi të shqetësuar që kjo mund të çojë në diskriminim të gëzimit të së drejtës për liri mbi baza kombësie. Nëse nuk arrihet të tregohet që kjo nuk ka një synim, një justifikim racional dhe proporcional, mund të çojë drejt veprimeve të cilat mund të jenë në shpërputhje me Nenin 5 të KEDNJ-së i marrë vetëm ose në kombinim me të drejtën për të qenë i lirë nga diskriminimi në gëzimin e të drejtave të Konventës sipas nenit 14 të KEDNJ-së. Po ashtu, mund të çonte në shkeljen e së drejtës për të qenë i lirë nga diskriminimi sipas Nenit 26 dhe të drejtën për liri sipas nenit 9 të Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (angl. ICCPR).

39. Ne e ngritëm këtë çështje me Sekretarin e Punëve të Brendshme në provë verbale. Pas shqyrtimit të përgjigjes së tij, ne nuk jemi të bindur që rreziku i diskriminimit mbi baza kombësie në dispozitat e Pjesës 4 të Ligjit është marrë parasysh aq sa duhet.”

Në Raportin e tij të Gjashtë të Sesionit 2003-2004 (23 shkurt 2004), Komisioni i Përbashkët shprehu shqetësim të thellë “lidhur me implikimet e të drejtave të njeriut në bërjen e pushtetit për ndalim si aspekt të ligjit për imigracionin dhe jo ligjit të kundër-terrorizmit” dhe paralajmëroi për “rrezikun e konsiderueshëm që Pjesa 4 shkel të drejtën për të qenë i lirë nga diskriminimi sipas Nenit 14 të KEDNJ-së”. Pas Raportit të Komisionit Newton dhe artikullit të Sekretarit të Shtetit të publikuar në përgjigje ndaj tij, Komisioni i Përbashkët iu rikthye kësaj çështjeje në Raportin e vet të Tetëmbëdhjetë të Sesionit 2003-2004 (21 korrik 2004), paragrafët 42-44:

“42. Artikulli i refuzon rekomandimet e Raportit Newton që ligjet e reja që zëvendësojnë Pjesën 4 [të Ligjit të vitit 2001] duhet të zbatohen në mënyrë të barabartë ndaj të gjitha kombësive përfshirë edhe shtetasit britanikë. Aty deklarohet që Qeveria beson se është e mbrojtshme të dallohet mes shtetasve të huaj dhe shtetasve britanikë për shkak të të drejtave dhe përgjegjësisë të ndryshme të tyre.

43. Në vazhdimisht kemi shprehur shqetësimin që dispozitat e Pjesës 4 [të Ligjit të vitit 2001] diskriminojnë në mënyrë të pajustificueshme mbi baza kombësie dhe prandaj përbëjnë shkelje të nenit 14 të KEDNJ-së. Ashtu si Lordi Newton, edhe ne e konsiderojmë të jashtëzakonshëm faktin që artikulli konstaton që kërkimi i pushtetit të njëjtë për ndalimin e shtetasve britanikë do të ishte ‘një hap shumë i rëndë’ dhe që ‘një pushtet i tillë drakonik do të ishte i vështirë për t'u justifikuar’.

44. Interesat e rrezikuara për një shtetas të huaj dhe një shtetas britanik janë të njëjta: e drejta e tyre themelore për liri sipas nenit 5 të KEDNJ-së dhe të drejtat



procedurale të ndërlidhura. neni 1 i KEDNJ-së kërkon që Shtetet t'ua sigurojnë të drejtat e Konventës të gjithëve brenda juridiksionit të tyre. Neni 14 kërkon që gëzimi i të drejtave të Konventës të sigurohet pa diskriminim mbi baza kombësie. Shpjegimi i Qeverisë në artikull lidhur me mungesën e vullnetit për të kërkuar të njëjtin pushtet në lidhje me shtetasit britanikë duket të sugjerojë se ajo i sheh interesat e lirisë së shtetasve të huaj si më pak të vlefshme për t'u mbrojtur sesa pikërisht të njëjtat interesa të lirisë për shtetasit britanikë, çka është e palejueshme sipas Konventës.”

### **C. Komisioni Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin apo Dënimin Çnjerëzor ose Poshtëruar (Këshilli për Parandalimin e Torturës, angl. CPT)**

101. CPT vizitoi kërkuesit e ndaluar në shkurt 2002 dhe përsëri në mars 2004. Në raportin e tij të publikuar më 9 qershor 2005, CPT kritikoi kushtet në të cilat mbaheshin kërkuesit në Burgun Belmarsh dhe në Spitalin Broadmoor dhe raportoi akuza për keqtrajtime nga stafi. Ai gjeti që regjimi në Burgun Woodhill ishte më i relaksuar. CPT gjeti që shëndeti i shumicës së kërkuesve të ndaluar ishte dobësuar për shkak të ndalimit të tyre, e posaçërisht për shkak të natyrës së pacaktuar të ndalimit. CPT deklaroi në raportin e vet:

“Në fakt, informacionet e mbledhura gjatë vizitës së vitit 2004 zbuluan që autoritetet nuk po dinë ta menaxhojnë këtë lloj të ndaluar, burgosur pa perspektivë reale lirimi dhe pa mbështetjen e nevojshme për të përballuar efektet dëmtuese të kësaj forme unike të burgosjes. Ata po ashtu theksojnë kapacitetin e kufizuar të sistemit të burgut për të përmbushur një detyrë e cila vështirë se përputhet me përgjegjësitë e tij normale. Objektiva e shënuar, në përgjigjen ndaj raportit të CPT-së lidhur me vizitën e shkurtit 2002, mbi formulimin e një strategjie që t'i mundësojë Shërbimit Korrektues menaxhimin në mënyrë më të përshtatshme të kujdesit dhe mbajtjes së personave sipas Ligjit të vitit 2001, nuk është arritur.

Dy vjet pasi CPT vizitoi këto të ndaluar, shumë prej tyre ndodheshin në gjendje të dobët mendore si rezultat i qëndrimit në burg, dhe disa ndodheshin po ashtu në gjendje të dobët fizike. Burgimi kishte shkaktuar çrregullime mendore në shumicën e të ndaluarve sipas [Aktit të vitit 2001] dhe për ata të cilët kishin përjetuar përvoja traumatike apo tortura në të kaluarën, ishte e qartë se kjo ia kishte rizgjuar përvojat e kaluara dhe bile kishte çuar në përsëritjen serioze të çrregullimeve të mëparshme. Trauma e burgimit ishte bërë edhe më shkatërruese për shëndetin e tyre nga se ishte kombinuar me mungesën e kontrollit si pasojë e natyrës së pacaktuar të qëndrimit të tyre në burg, vështirësinë e vazhdueshme të kontestimit të burgosjes së tyre, dhe faktin që nuk e dinin se çfarë provash ekzistonin kundër tyre për të certifikuar dhe/ose vërtetuar certifikimin e tyre si persona të dyshuar për terrorizëm ndërkombëtar. Për disa prej tyre, gjendja e tyre në kohën e vizitës mund të konsiderohej si e tillë që përbënte trajtim çnjerëzor dhe poshtëruar.”

102. Qeveria publikoi përgjigjen e saj ndaj raportit të CPT të vitit 2004 më 9 qershor 2005. Qeveria i kontestoi fuqimisht akuzat për keqtrajtim nga stafi i burgut dhe theksoi se kërkuesit e ndaluar kishin në dispozicion zgjidhje të parashikuara nga e drejta administrative dhe civile të cilat mund t'i shfrytëzonin për t'u ankuar për keqtrajtim. Përgjigjja e Qeverisë vazhdoi:

“Megjithëse Qeveria i respekton përfundimet e arritura nga delegatët e [CPT-së] bazuar mbi vëzhgimet gjatë ditës së vizitës, ajo kategorikisht e refuzon sugjerimin që në çfarëdo kohe gjatë periudhës së ndalimit të tyre të burgosurit e [Ligjit të vitit 2001] janë trajtuar në mënyrë ‘çnjerezore apo poshtëruese’ që mund të çonte në shkelje të detyrimeve të Mbretërisë së Bashkuar për të drejtat ndërkombëtare të njeriut. Qeveria beson në mënyrë të palëkundur që gjatë gjithë kohës të ndaluarit kanë pasur kujdesin dhe trajtimin e duhur në Belmarsh dhe kanë pasur mundësi për kujdes mjekësor, si fizik ashtu edhe psikologjik, nga stafi mjekësor dhe mjekët. Qeveria e pranon që individët kanë pasur histori të vështira nga e kaluara para ndalimit, por nuk e pranon që ‘burgimi ia ka shkaktuar çrregullimet mendore’. Disa nga të ndaluarit kanë pasur probleme mendore para burgimit, por kjo nuk i ka ndaluar që të angazhohen në aktivitete që kanë çuar deri tek certifikimi dhe ndalimi i tyre. Problemet e shëndetit mendor nuk e ndalojnë një person nga paraqitja e rrezikut për siguri kombëtare.

...

Qeveria nuk e pranon që të certifikuarit sipas [Ligjit të vitit 2001] janë ndaluar pa asnjë perspektivë lirim. ...

...

Në asnjë moment SIAC apo ndonjë gjykatë tjetër nuk kanë gjetur që kushtet e burgimit shkelnin detyrimin absolut të vendosur nga Qeveria sipas Neni 3 të [Konventës]. Qeveria është e mendimit se, duke pasur parasysh mbrojtjen e gjerë juridike që kanë në dispozicion të ndaluarit, qeveria nuk do të kishte mundur ta vendoste burgimin e këtyre të ndaluarve sikur pushteti për ta bërë këtë të kishte qenë shkelje e të drejtave të të ndaluarve nga Neni 3 në çfarëdo mënyre. Të sugjerohet ndryshe do të thotë të injorohen kontaktet e vazhdueshme që të ndaluarit kanë pasur me sistemin britanik të drejtësisë dhe detyrimin absolut mbi gjyqësorin që të sigurojë mbrojtje ndaj çdo shkeljeje të tillë.”

#### **D. Komisioneri European për të Drejtat e Njeriut**

103. Në gusht 2002 Komisioneri European për të Drejtat e Njeriut pranë Këshillit të Europës publikoi opinionin e tij lidhur me disa aspekte të caktuara të derogimit të Mbretërisë së Bashkuar nga Neni 5 i Konventës dhe Pjesës 4 të Ligjit të vitit 2001. Në atë Opinion ai shprehimisht kritikoi mungesën e hulumtimit të mjaftueshëm nga Parlamenti i dispozitave të derogimit dhe ngriti pyetjen nëse natyra e al’Qaedës ishte bazë e justifikuar për njohjen e një emergjence publike që kërcënonte jetën e kombit:

“Ndërkohë që i njohim mirë detyrimet e qeverive për të mbrojtur shtetasit e tyre nga kërcënimi i terrorizmit, Komisioneri është i mendimit që referencat e përgjithshme lidhur me rrezikun e shtuar për aktivitete terroriste pas 11 shtatorit 2001 nuk munden, në vetvete, të jenë të mjaftueshme për të arsyetuar derogimin nga Konventa. Disa shtete Europiane të cilat kanë mjaft kohë që përballen me aktivitete terroriste të vazhdueshme nuk e kanë gjykuar të nevojshëm derogimin nga të drejtat e Konventës. As nuk e kanë parë të nevojshme që të veprojnë kështu në rrethanat aktuale. Prandaj, duhet të paraqitet informacion i detajuar që do të tregonte një rrezik real dhe i pashmangshëm ndaj sigurisë publike në Mbretërinë e Bashkuar.”

Komisioneri vazhdoi, duke iu referuar skemës së ndalimit sipas Pjesës 4 të Ligjit të vitit 2001:

“Përderisa këto masa janë të zbatueshme vetëm për të huajt e padëbueshëm, ato mund të duken edhe më tej sikur po shkojnë drejt një drejtësie dykahore, ku standardet për të drejtave të njeriut që zbatohen për të huajt janë ndryshe nga standardet për të drejtat e njeriut që zbatohen për vendasit.”

104. Më 8 qershor 2005 Komisioneri publikoi një raport që doli pas vizitës së tij në Mbretërinë e Bashkuar në nëntor 2004. Ai iu referua në mënyrë të veçantë vendimit të Dhomës së Lordëve në rastin e kërkuesit dhe shënoi faktin që Qeveria nuk kishte kërkuar të rinovonte dispozitat përkatëse të Ligjit të vitit 2001 në mars 2005. Ai e mirëpriti vendimin e Dhomës së Lordëve, i cili përputhej me opinionin e tij të publikuar më parë, dhe gjithashtu e mirëpriti edhe lirimin e kërkuesve, duke theksuar që si rezultat i vizitës së tij ai ishte në gjendje që personalisht të dëshmonte lidhur me “gjendjen jashtëzakonisht të shqetësuar psikologjike që kishte vërejtur tek shumë prej tyre”. Si rezultat i intervistave që ai kishte zhvilluar, mes të tjerësh, me Sekretarin e Punëve të Brendshme, Lordin Kancelar, Prokurorin e Përgjithshëm, Kryegjyqtarin dhe Drejtorin e Prokurorisë Publike, Komisioneri po ashtu shprehu një përfundim lidhur me mundësinë e masave alternative për luftimin e kërcënimit të terrorizmit në Mbretërinë e Bashkuar mbi bazën e ligjeve britanike:

“Aktiviteti terrorist jo vetëm që duhet por edhe mund të luftohet brenda kornizës ekzistuese të garancive të të drejtave të njeriut, të cilat ofrojnë pikërisht një ekuilibër, në çështjet lidhur me sigurinë kombëtare, të të drejtave individuale dhe interesave publike dhe lejojnë shfrytëzimin e pushteteve të veçanta proporcionale. Ajo që kërkohet është veprim policor mbi burime të mirëinformuara, bashkëpunim ndërkombëtar, dhe zbatim i detyrueshëm i ligjit. Duhet nënvizuar, në këtë kontekst, se në Ligjin e Terrorizmit të vitit 2000, Mbretëria e Bashkuar tashmë ka legjislacionin më të rreptë dhe më gjithëpërfshirës të kundër-terrorizmit në Europë.”

#### **E. Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor**

105. Vëzhgimet Përfundimtare të Komisionit lidhur me Mbretërinë e Bashkuar më 10 dhjetor 2003, u shënuan në paragrafin 17:

“17. Komisioni është thellësisht i shqetësuar në lidhje me dispozitat e Ligjit për Kundër-Terrorizëm, Krim dhe Siguri të cilat parashikojnë burgimin e pacaktuar pa akuza ose gjyq, në pritje të dëbimit, të jo-shtetasve të Mbretërisë së Bashkuar të cilët dyshohen për aktivitete të lidhura me terrorizmin.

Ndërkohë që i njohim shqetësimet e palës Shtetërore lidhur me sigurinë kombëtare, Komisioni rekomandon që pala e Shtetit të kërkojë ekuilibrimin e atyre shqetësimeve me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe detyrimet ligjore ndërkombëtare. Në lidhje me këtë, Komisioni i tërheq vëmendjen palës së Shtetit ndaj deklaratës së tij të datës 8 mars 2002 ku ai nënvizon detyrimin e Shteteve për të ‘siguruar që masat e marra në luftën kundër terrorizmit të mos diskriminojnë në aspekt të qëllimit apo ndikimit mbi baza race, ngjyre, prejardhjeje, apo origjine kombëtare apo etnike.”

#### IV. MATERIALE TË TJERA RELEVANTE TË KËSHILLIT TË EUROPËS

##### A. Rezoluta 1271 e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës (2002)

106. Më 24 janar 2002 Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës miratoi Rezolutën 1271 (2002) e cila vendosi, në paragrafin 9, që:

“Në luftën e tyre kundër terrorizmit, anëtarët e Këshillit të Europës nuk duhet të parashikojnë asnjë derogim ndaj Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.”

Gjithashtu, të gjitha Shteteve Anëtare (paragrafi 12) u kërkohet që të:

“frenohen nga përdorimi i Nenit 15 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (derogimi në kushte emergjence) për kufizimin e të drejtave dhe lirive të garantuara sipas Nenit 5 (e drejta për liri dhe siguri).”

Përveç Mbretërisë së Bashkuar, asnjë Shtet tjetër Anëtar nuk ka zgjedhur të derogojë nga Neni 5 § 1 pas 11 shtatorit 2001.

##### B. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës

107. Pas takimit të datës 14 nëntor 2001 për të diskutuar “Demokracitë që përballen me terrorizmin” (CM/AS(2001) Rec 1534), Komisioni i Ministrave miratoi më 11 korrik 2002 “Direktivat mbi të drejtat e njeriut dhe luftën kundër terrorizmit”, ku parashikohej, *inter alia*:

###### I. Detyrimi i Shteteve për t’i mbrojtur të gjithë nga terrorizmi

Shtetet janë të detyruara të marrin masat e nevojshme për të mbrojtur të drejtat themelore të secilit brenda juridiksionit të tyre kundër akteve terroriste, sidomos të drejtën për jetë. Ky detyrim pozitiv e justifikon plotësisht luftën e Shteteve kundër terrorizmit në përputhje me direktivat në fjalë.

###### II. Ndalimi i arbitraritetit

Të gjitha masat e marra nga Shtetet për të luftuar terrorizmin duhet të respektojnë të drejtat e njeriut dhe parimin e sundimit të ligjit, ndërkohë që përjashtojnë çdo formë arbitrariteti, si dhe çdo trajtim diskriminues apo racist, dhe duhet t’i nënshtrohen mbikëqyrjes së duhur.”

##### C. Komisioni European kundër Racizmit dhe Intolerancës (angl. ECRI)

108. Në Rekomandimin për Politikën e Përgjithshme N° 8 mbi Luftimin e Racizmit gjatë Luftës kundër Terrorizmit, i publikuar më 8 qershor 2004, ECRI e konsideroi detyrë të Shtetit luftën kundër terrorizmit; theksoi që përgjigjja në vetvete nuk duhet t’i kalojë kufijtë e lirisë, demokracisë, drejtësisë, sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut dhe së drejtës ndërkombëtare; theksoi që lufta kundër terrorizmit nuk duhet të bëhet

pretekst për lulëzimin e diskriminimit racist; shënoi që lufta kundër terrorizmit që nga 11 shtatori 2001 në disa raste kishte rezultuar në miratimin e legjislacionit diskriminues, kryesisht mbi baza kombësie, origjine nacionale apo etnike, dhe feje; theksoi përgjegjësinë e Shteteve për të siguruar që lufta kundër terrorizmit të mos ketë ndikim negativ tek asnjë grup pakicë; dhe u rekomandoi Shteteve:

“të rishikonin legjislacionin dhe rregulloret e miratuara në lidhje me luftën kundër terrorizmit për t’u siguruar që ato nuk diskriminonin direkt ose indirekt ndaj personave apo grupeve të personave, kryesisht mbi baza ‘race’, ngjyre, gjuhe, feje, kombësie apo origjine nacionale ose etnike, dhe të abrogojnë çdo ligj të tillë diskriminues.”

#### V. NOCIONI I “EMERGJENCËS PUBLIKE” SIPAS NENIT 4 TË KONVENTËS NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE (angl. ICCPR)

109. Neni 4(1) i ICCPR-së thotë:

“Në kohë emergjencash publike të cilat kërcënojnë jetën e kombit dhe ekzistenca e të cilave shpallet zyrtarisht, Shtetet Palë në Konventën në fjalë mund të marrin masa deroguese nga detyrimet e tyre ndaj kësaj Konvente deri në atë shkallë sa ç’kërkohet rreptësisht nga urgjencat e situatës, dhe të sigurohen që këto masa të mos jenë në shpërputhje me detyrimet e tyre të tjera ndërkombëtare dhe të mos përfshijnë diskriminimin vetëm në baza race, ngjyre, gjinie, gjuhe, feje apo origjine sociale.”

Në pranverën e vitit 1984, një grup prej 31 ekspertësh të së drejtës ndërkombëtare, të mbledhur nga Komisioni Ndërkombëtar i Juristëve, Shoqata Ndërkombëtare e së Drejtës Penale, Shoqata Amerikane për Komisionin Ndërkombëtar të Juristëve, Instituti Urban Morgan për Të Drejtat e Njeriut dhe Instituti Ndërkombëtar i Studimeve të Larta në Shkencat e Kriminologjisë, u takuan në Sirakuzë të Italisë, për të diskutuar dispozitën e mësipërme, *inter alia*. Paragrafët 39-40 të dokumentin “Parimet e Sirakuzës mbi Kufizimet dhe Dispozitat e Derogimit në Konventën Ndërkombëtare mbi Të Drejtat Civile dhe Politike” që doli si rezultat deklarojnë si vijon nën kokën “Emergjenca Publike që Kërcënon Jetën e Kombit”:

“39. Një palë e shtetit mund të marrë masa që derogojnë nga detyrimet e saj sipas Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Ndërkombëtare në përputhje me Nenin 4 (prej këtu ‘masat e derogimit’) vetëm kur përballen me një situatë rreziku të jashtëzakonshëm ose të menjëhershëm i cili kërcënon jetën e kombit. Kërcënimi ndaj jetës së kombit është i tillë kur:

(a) ndikon tek e gjithë popullsia dhe në cilëndo pjesë të territorit apo tërësinë e territorit të Shtetit, dhe

(b) kërcënon integritetin fizik të popullsisë, pavarësinë politike ose integritetin territorial të Shtetit ose ekzistencën e institucioneve bazë funksionale për sigurimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njohura në Konventë.

40. Konflikti dhe trazirat e brendshme që nuk përbëjnë kërcënim të rëndë dhe të menjëhershëm ndaj jetës së kombit nuk mund t'i justifikojnë derogimet nga Neni 4.”

Parimet e Sirakuzës vazhdojnë në paragrafin 54:

“54. Parimi i domosdoshmërisë së rreptë do të zbatohet në mënyrë objektive. Çdo masë do të drejtohet drejt një rreziku faktik, të qartë, të pranishëm apo të menjëhershëm dhe nuk mund të vendoset vetëm për shkak të një perceptimi të rrezikut potencial.”

110. Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Të Drejtat e Njeriut, në “Komentin e Përgjithshëm nr. 29 mbi Nenin 4 të ICCPR-së (24 qershor 2001), vërejtje në paragrafin 2 që:

“Masat që derogojnë nga dispozitat e Konventës duhet të jenë të natyrës së jashtëzakonshme dhe të përkohshme.”

## VI. MATERIALE TË TJERA LIDHUR ME MOS-ZBULIMIN E PROVAVE NË ÇËSHTJE QË KANË TË BËJNË ME SIGURINË KOMBËTARE

111. Në *Charkaoui kundër Ministrit të Shtetësisë dhe Imigracionit* [2007] 1 SCR 350, McLachlin CJ, për Gjykatën Supreme të Kanadasë, vërejtje (§ 53):

“Së fundi, por jo më pak së rëndësishmi, një seancë dëgjimore e drejtë kërkon që personi i ndikuar të informohet mbi argumentet kundër tij apo saj, dhe të lejohet që të përgjigjet lidhur me to.”

Kjo e drejtë nuk ishte absolute dhe mund të kufizohej sipas interesave të sigurisë kombëtare (§§ 57-58) por (§ 64):

“... Prandaj gjyqtari nuk ka mundësi të kompensojë mungesën e hulumtimit të informuar, kontestimin dhe kundër-provat që një person që ka njohuri për çështjen mund të sjellë. Në një hulumtim të tillë qëndron tërësisht kuptimi i parimit që një njeri liria e të cilit është në rrezik duhet ta dijë se me çfarë argumentesh përballet. Këtu ai parim jo vetëm që është kufizuar; ai efektivisht është djegur. Si mund të përballet njeriu me akuzat kur nuk i di ato?”

112. Në çështjen *Hamdi kundër Rumsfeld* 542 US 507 (2004), O’Connor J, shumica e Gjykatës Supreme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës tha (fq. 533):

“Prandaj ne vendosim që një i ndaluar shtetas që kërkon të kontestojë klasifikimin e tij si luftëtar i armikut duhet të informohet mbi baza faktike lidhur me klasifikimin e tij, dhe duhet t’i jepet mundësia për të kundërshtuar konstatimet faktike të Qeverisë para një autoriteti asnjans vendimmarrës [autoriteti i cituar]. ‘Për më shumë se një shekull kuptimi qendror i gjyqit të drejtë procedural ka qenë i qartë: Palët të drejtat e të cilave do të preken kanë të drejtë të dëgjohen; dhe në mënyrë që ata të gëzojnë atë të drejtë ata së pari duhet të informohen..’ Këto premtime thelbësore kushtetuese nuk mund të zhduken.”

113. Komisioneri i Këshillit të Europës për Të Drejtat e Njeriut, në paragrafin 21 të këtij raporti të datës 8 qershor 2005 (shih paragrafin 104

lart), dhe në Komisionin e Përbashkët Parlamentar për të Drejtat e Njeriut (shih paragrafin 100 lart, në paragrafin 76 të Raportit të Dymbëdhjetë të tij për Sesionin 2005-2006, (HL Letra 122, HC 915) pati vështirësi të pranonte që një seancë dëgjimore mund të ishte e drejtë nëse një vendim i pafavorshëm mund të bazohej mbi materiale të cilat personi i kontrolluar nuk ka mundësi t'i kontestojë apo mohojë.

## LIGJI

### I. SHKELJET E PRETENDUARA TË NENIT 3 TË KONVENTËS DHE NENI 13 I MARRË NË LIDHJE ME NENIN 3

114. Kërkuesit pretenduan se ndalimi i tyre sipas Pjesës 4 të Aktit të vitit 2001 shkelte të drejtat e tyre nga Neni 3 i Konventës, i cili parashikon që:

“Askush nuk do t'i nënshtrohet torturës apo trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose poshtëruës.”

Më tej ata u ankuan që u ishte mohuar zgjidhje efektive për ankesat e tyre nga Neni 3, në shkelje të Nenit 13 të Konventës, i cili thotë:

“Çdo person të drejtat dhe liritë e të cilit parashtruar në [Konventë] shkelen do të ketë zgjidhje efektive para një autoriteti kombëtar pavarësisht nga fakti që shkelja është kryer nga personat që veprojnë në cilësi zyrtare.”

#### A. Parashtrimet e palëve

##### 1. Kërkuesit

115. Kërkuesit theksuan që secili prej tyre ndodhej në Mbretërinë e Bashkuar meqenëse mundësia e një strehe të sigurt u ishte mohuar në vendin e tyre apo diku tjetër. Kërkuesi i parë ishte palestinez pa shtet dhe nuk kishte ku të shkonte. Shumë prej tyre kishin përjetuar tortura para ardhjes në Mbretërinë e Bashkuar. Sipas Ligjit të vitit 2001 ata u vendosën në pozicion të tillë që u duhej të zgjidhnin mes kushteve të burgimit që ata i gjenin të patolerueshme dhe rrezikut të çfarëdo trajtimi që mund të përjetonin nëse do të binin dakord për dëbim. Për më tepër, përvojat e tyre të kaluara si dhe problemet para-ekzistuese mendore dhe fizike i kishin bërë ata posaçërisht të dobët kundrejt efekteve negative të ndalimit arbitrar. Diskriminimi ndaj tyre, meqenëse vetëm shtetasit e huaj i nënshtroheshin ndalimit sipas Ligjit të vitit 2001, ishte pjesë e pandashme e dhimbjes së tyre.

116. Kushtet e larta të sigurisë në Burgun Belmarsh dhe Spitalin Broadmoor ishin të papërshtatshme dhe dëmtuese për shëndetin e tyre. E megjithatë, më thelbësisht natyra e pacaktuar në kohë e ndalimit të tyre, së

cilës nuk i shihej fundi, dhe kohëzgjatja e saj e gjatë u shkaktonin vuajtje jo normale, edhe më shumë se vuajtjet e burgimit. Kjo kombinohej edhe me aspekte të tjera të regjimit, siç ishte natyra sekrete e provave kundër tyre. Fakti që indiferenca e autoriteteve ndaj situatës së kërkuesve ishte sanksionuar me statutin e Parlamentit nuk e zbuste vuajtjen e tyre.

117. Të marrë së bashku, këto faktorë u shkakton kërkuesve vuajtje në shkallë të lartë. Provat dhe raportet mjekësore të CPT-së dhe grupit të konsulentëve psikiatër (shih paragrafët 101 dhe 76 lart) treguan se regjimi i burgimit gjithashtu kishte dëmtuar ose kishte rrezikuar seriozisht dëmtimin e të gjithë atyre dhe, në rastin e kërkuesit të parë, pestë, shtatë dhe dhjetë, ky efekt kishte qenë në shkallë të gjerë.

118. Kërkuesit pretenduan që pushteti i SIAC-it për lejimin e dorëzimit nuk funksionoi në mënyrë efektive gjatë periudhës kur ata u ndaluan: së pari, për shkak se hapësira e zgjidhjes ishte e paqartë nga aspekti i juridiksionit; së dyti, për shkak se procedura u vonua; së treti, për shkak se kufiri i lejimit të dorëzimit ishte tepër i lartë. Për dorëzani një kërkuesi i duhej të paraqiste “probabilitet tronditës” që ndalimi i tij i vazhduar do të çonte drejt përkeqësimit fizik ose mendor të atillë që do të përbënte trajtim çnjerëzor dhe poshtërues në kundërshtim me nenin 4. Juridiksioni u përshkrua si “i jashtëzakonshëm”, ku kërkohet që “rrethanat të jenë ekstreme”. Edhe atëherë, e vetmja zgjidhje e mundshme ishte zëvendësimi i burgut me arrest shtëpiak (shih paragrafin 78 lart).

## 2. Qeveria

119. Qeveria e mohoi që të drejtat e kërkuesve sipas nenit 3 ishin shkelur. Ajo theksoi që SIAC dhe Gjykata e Apelit i kishin refuzuar ankesat e kërkuesve nga neni 3 dhe që Dhoma e Lordëve nuk e kishte parë të nevojshme t'i përcaktonte ato (shih paragrafët 15, 16 dhe 22 lart).

120. Ndalimi pa akuza në vetvete nuk ishte në kundërshtim me nenin 3 dhe në shumë raste ishte i lejuar sipas nenit 5 § 1. Burgimi ishte i pacaktuar por jo pa fund. Legjislacioni mbetej në fuqi vetëm për pesë vjet dhe i nënshtrohej rishikimit nga të dyja Dhomat e Parlamentit. Burgimi i secilit kërkues varej nga rrethanat individuale të secilit që vazhdonin ta justifikonin atë, përfshirë shkallën e kërcënimit ndaj sigurisë kombëtare që përfaqësonte secili kërkues dhe mundësia e dëbimit për në një vend tjetër të sigurt, dhe i nënshtrohej rishikimit çdo gjashtë muaj nga SIAC. Secili kërkues është informuar lidhur me arsyet e dyshimit kundër tij dhe i janë dhënë sa më shumë prova që ishte e mundur si dhe i është ofruar një procedurë sa më e drejtë që ishte e mundur për të kontestuar bazat për burgimin e tij. Për më tepër, SIAC ishte i gatshëm të lejonte dorëzimin nëse ishte e nevojshme. Prandaj kërkuesit nuk ishin ndaluar pa shpresa lirimi: përkundrazi, kishte mundësi për të bërë kërkesë për librim bashkë me rishqyrtimin e detyrueshëm nga gjykata për t'u siguruar që burgimi të mbetej i ligjshëm dhe proporcional në të gjitha rrethanat. Po ashtu, kërkuesit e kishin mundësinë të



largoheshin nga Mbretëria e Bashkuar, siç zgjodhën të bënin kërkuesi i dytë dhe i katërt.

121. Kërkuesit u gjykua se paraqisnin kërcënim serioz ndaj sigurisë kombëtare dhe rrjedhimisht u mbajtën në kushtet e sigurisë së lartë, të cilat nuk ishin çnjerëzore as poshtëruese. Secili mori trajtimin e duhur për gjendjen përkatëse fizike dhe problemet mendore dhe rrethanat individuale të secilit kërkues, përfshirë edhe shëndetin mendor, u morën parasysh kur u vendos se ku do të mbahej secili dhe nëse duhet të lirohej me dorëzani. U krijua një njësi speciale në Spitalin Woodhill të cilin kërkuesit refuzuan ta përdornin (shih paragrafin 71 lart).

122. Për aq sa kërkuesit u mbështetën në kushtet e tyre individuale të ndalimit dhe rrethanat e tyre personale, ata nuk i kishin shteruar mjetet vendase sepse nuk kishin bërë përpjekje për të paraqitur sfidat e nevojshme. Çdo ankesë lidhur me kushtet e burgimit mund të kishte qenë bazë për hapjen e një çështjeje gjyqësore të ndarë. Autoritetet e burgut iu nënshtruan kërkesave të Ligjit të 1998 (shih paragrafin 94 lart) dhe ishin të detyruara nga seksioni 6(1) që të vepronin në përputhje me të drejtat nga Neni 3 të kërkuesve që ata mbanin të ndaluar. Për aq sa ankesat e kërkuesve sipas Nenit 3 bazoheshin mbi natyrën e pacaktuar të burgimit të tyre, kjo parashikohej nga legjislacioni parësor (Pjesa 4 e Ligjit të vitit 2001), dhe Neni 13 nuk e importonte të drejtën e kontestimit në një gjykatë vendase të një zgjedhjeje të vullnetshme të shprehur nga legjislatura.

## **B. Vlerësimi i Gjykatës**

### *1. Pranueshmëria*

123. Gjykata vëren që kërkuesi i dytë u ndalua sipas Pjesës 4 të Ligjit të vitit 2001 më 19 dhjetor 2001 dhe që ai u lirua më 22 dhjetor 2001, pas vendimit të tij të vullnetshëm për t'u kthyer në Marok (shih paragrafin 35 lart). Meqenëse ai më pas u ndalua vetëm për pak ditë dhe meqenëse nuk ka prova se gjatë asaj kohe ai vuajti ndonjë keqtrajtim përveç vuajtjes që është pjesë e natyrshme e burgimit, ankesa e tij nga Neni 3 është dukshëm e pabazuar brenda kuptimit të Nenit 35 § 3 të Konventës.

Meqenëse Neni 13 kërkon ofrimin e një mjeti vendas për zgjidhje në lidhje me “ankesat e diskutueshme” sipas Konventës (shih, për shembull, *Ramirez Sanchez kundër Francës* [GC], nr. 59450/00, § 157, KEDNJ 2006-IX), rrjedh që ankesa e kërkuesit të dytë është po ashtu dukshëm e pabazuar.

Të dyja këto ankesa nga kërkuesi i dytë duhet të deklarohen rrjedhimisht të papranueshme.

124. Gjykata vëren konstatimin e Qeverisë që ka pasur mjete në dispozicion të kërkuesve sipas Ligjit të vitit 1998, përdorimin e të cilave ata e kanë neglizhuar. Megjithatë, meqenëse ata ankohen sipas Nenit 13 që

mjetet në dispozicion të tyre në lidhje me ankesat e tyre nga Neni 3 ishin jo efektive, Gjykata konsideron që është e nevojshme të shqyrtohet kundërshtimi i Qeverisë lidhur me mos-shterimin bashkë me themelet e ankesave nga Nenet 3 dhe 13.

125. Gjykata konsideron që, përveç ankesave të kërkuarit të dytë, ankesat e kërkuarëve nga Nenet 3 dhe 13 të Konventës ngrenë çështje komplekse ligji dhe faktesh, përcaktimi i të cilave do të varej nga një analizë e themeleve të tyre. Prandaj, ajo arriti në përfundimin që kjo pjesë e kërkesës nuk është dukshëm e pabazuar brenda kuptimit të Nenet 35 § 3 të Konventës. Baza të tjera papranueshmërie nuk kanë dalë, dhe ajo duhet të deklarohej e pranueshme.

## 2. Themelet

### a. Parimet e përgjithshme

126. Gjykata është thellësisht e vetëdijshme për vështirësitë me të cilat përballen Shtetet në mbrojtjen e popullsisë të tyre nga dhuna terroriste. Kjo e bën edhe më të rëndësishëm theksimin e faktit që Neni 3 ngërthen një nga vlerat më themelore të shoqërive demokratike. Ndryshe nga shumica e klauzolave substantive të Konventës dhe Protokolleve nr. 1 dhe 4, neni 3 nuk ka dispozitë për përjashtime dhe derogimi prej tij është i lejueshëm sipas nenet 15 § 2 pavarësisht nga ekzistenca e një emergjence publike që kërcënon jetën e kombit. Edhe në rrethanat më të vështira, siç është lufta kundër terrorizmit, dhe sjellja e pavarur e personave të përfshirë, Konventa e ndalon në mënyrë absolute torturën dhe trajtimin ose dënimin çnjerëzor dhe poshtëruar (*Ramirez Sanchez*, cituar lart, §§ 115-116).

127. Keqtrajtimi duhet të arrijë një nivel minimal rreptësia që të klasifikohet në lidhje me Nenin 3. Vlerësimi i këtij minimumi varet nga të gjitha rrethanat e çështjes, siç është kohëzgjatja e trajtimit, efektet e tij fizike ose mendore, dhe, në disa raste, gjinia, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës (shih *Kafkaris kundër Qipros* [GC], nr. 21906/04, § 95, KEDNJ 2008). Gjykata e ka konsideruar trajtimin “çnjerëzor” sepse, *inter alia*, ai ka qenë i paramenduar, është zbatuar për orë të tëra në vazhdim dhe ka shkaktuar ose lëndime trupore faktike ose vuajtje intensive fizike ose mendore. Ajo e ka konsideruar trajtimin “poshtëruar” sepse ishte i tillë që shkaktoi tek viktimat ndjenja frike, ankthi dhe inferioriteti të cilat mund t’i turpëronin dhe ulnin ata (shih, mes autoriteteve të tjera, *Kudla kundër Polonisë* [GC], nr. 30210/96, § 92, KEDNJ 2000-XI). Duke shqyrtuar nëse një dënim apo trajtim ishte “poshtëruar” brenda kuptimit të nenet 3, Gjykata do të marrë parasysh nëse synimi ishte poshtërimi dhe ulja e personit në fjalë dhe nëse, për sa u përket pasojave, ai ka pasur efekt negativ në personalitetin e tij/saj në mënyrë të papërputhshme me nenin 3. Megjithatë, mungesa e ndonjë qëllimi të tillë nuk mund të përjashtojë në mënyrë konkluzive gjetjen e një shkeljeje të Nenet 3. Që dënimi apo trajtimi të jenë

“çnjerezor” ose “poshtërues”, vuajtja apo poshtërimi duhet të shkojnë përtej atij elementi të pashmangshëm të vuajtjes apo poshtërimit që është i ndërlidhur me një formë të caktuar të trajtimit apo dënimit legjitim (*Ramirez Sanchez*, cituar lart, §§ 119).

128. Aty ku një person privohet nga liria e tij, Shteti duhet të sigurojë që ai mbahet i ndaluar në kushte të cilat janë në përputhje me respektin për dinjitetin e tij njerëzor dhe që mënyra dhe metoda e ekzekutimit të masës nuk e nënshtrojnë atë ndaj shqetësimeve apo vështirësive që e tejkalojnë nivelin e pashmangshëm të vuajtjes që burgimi ngërthen në vetvete (shih *Kudla*, cituar lart, §§ 92-94). Sado që Neni 3 nuk mund të perceptohet si i tillë që përcakton një detyrim të përgjithshëm për t’i liruar të ndaluarit mbi bazën e gjendjes shëndetësore, ai sidoqoftë vendos një detyrim ndaj Shtetit për të mbrojtur mirëqenien fizike dhe mendore të personave të privuar nga liria, për shembull duke vënë në dispozicion të tyre ndihmën e duhur mjekësore (shih *Hurtado kundër Zvicrës*, vendimi i datës 28 janar 1994, § 79 opinioni i Komisionit, Seria A nr. 280-A; *Mouisel kundër Francës*, nr. 67263/01, § 40, KEDNJ 2002-IX; *Aerts kundër Belgjikës*, vendimi i datës 30 korrik 1998, § 66, *Përmbledhje e Vendimeve 1998-V*; *Keenan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 27229/95, § 111, KEDNJ 2001-III). Në vlerësimin e kushteve të burgimit, duhet të merren parasysh efektet kumulative të atyre kushteve, si dhe pretendimet e veçanta të kërkuesit (*Ramirez Sanchez*, cituar lart, § 119). Imponimi i një dënimi me burgim të përjetshëm të reduktueshëm ndaj një të rrituri, pa perspektivë lirimi, mund të ngrejë problem ligjor nga Neni 3, por aty ligji kombëtar lejon mundësinë e rishikimit të burgimit të përjetshëm me qëllim të zëvendësimit, lehtësimit, ndërprerjes apo lirimit me kusht të një të burgosuri, kjo do të jetë e mjaftueshme (*Kafkaris*, cituar lart, §§ 97-98).

#### **b. Zbatimi i fakteve në çështjen në fjalë**

129. Gjykata vëren se tre prej kërkuesve janë mbajtur të ndaluar për rreth tre vjet e tre muaj ndërkohë që të tjerët janë mbajtur për periudha më të shkurtra kohore. Gjatë një pjese të madhe të këtij burgimi, kërkuesit nuk do të kishin mundur të parashikonin se kur do të liroheshin, nëse kjo do të ndodhte ndonjëherë. Ata i referohen gjetjeve të Raportit të Përbashkët Psikiatrik dhe arsyetojnë që natyra e pacaktuar e ndalimit të tyre ka shkaktuar apo ka acaruar probleme të rënda mendore tek secili prej tyre. Qeveria e kundërshton këtë përfundim dhe mbështetet në Raportin e Dr. J., i cili kritikon metodologjinë e autorëve të Raportit të Përbashkët (shih paragrafët 76-77 lart).

130. Gjykata konsideron që pasiguria lidhur me pozicionin e tyre dhe frika e burgimit të pacaktuar duhet pa dyshim të ketë shkaktuar tek kërkuesit ankth dhe shqetësim të madh, siç do t’i ndodhte çdo të dyshuari tjetër në kushtet e tyre. Për më tepër, ka mundësi që stresi të ketë qenë mjaft i rëndë dhe i vazhduar aq sa ka ndikuar në shëndetin mendor të disa prej të

kërkuesve. Ky është një prej faktorëve të cilët Gjykata duhet t'i marrë parasysh në vlerësimin e faktit nëse kufiri i Neni 3 është arritur.

131. Megjithatë, nuk mund të thuhet që kërkuesit kanë qenë pa perspektivë apo shpresë lirimi (shih *Kafkaris*, cituar lart, § 98). Në mënyrë të veçantë, ata kanë pasur mundësi të ngrenë procedura për kontestimin e ligjshmërisë së skemës së burgimit sipas Ligjit të vitit 2001 dhe ia dolën me sukses para SIAC më 30 qershor 2002 dhe Dhomës së Lordëve më 16 dhjetor 2004. Përveç kësaj, secili kërkues pati mundësi të ngrinte një kundërshtim individual ndaj vendimit për certifikimin e tij dhe SIAC-it i kërkohet me statut që të shqyrtonte çështjen në vazhdim për burgim çdo gjashtë muaj. Prandaj, Gjykata nuk konsideron që situata e kërkuesve ishte e krahasueshme me një dënim të pareduktueshëm me burgim të përjetshëm, të llojit të hartuar në vendimin *Kafkaris* si i tillë që me gjasë do t'i jepte shtysë një argumenti ligjor nga Neni 3.

132. Më tej, kërkuesit argumentojnë që kushtet në të cilat janë mbajtur kanë kontribuar drejt një shkalle të patolerueshme të vuajtjeve. Gjykata vëren në këtë aspekt që Raporti i Përbashkët Psikiatrik po ashtu përmban kritika ndaj sistemit të Kujdesit Shëndetësor të Burgut dhe arriti në përfundimin që nuk ishin ofruar kushte të mjaftueshme për problemet komplekse shëndetësore të kërkuesve. Këto shqetësime u shprehën më tej edhe nga CPT, e cila ngriti pretendime të hollësishme lidhur me kushtet dhe arriti në përfundimin që për disa prej kërkuesve "situata e tyre në kohën e vizitës mund të konsiderohej si e tillë që shkonte deri tek trajtimi çnjerëzor dhe poshtëruës". Qeveria i kundërshtoi fuqimisht këto kritika në përgjigjen e saj ndaj raportit të CPT-së (shih paragrafët 101-102 lart).

133. Gjykata vëren që secili kërkues ka pasur në dispozicion mjetet që mund të përdoren nga të gjithë të burgosurit sipas ligjit administrativ dhe civil për të kontestuar kushtet e burgimit, përfshirë çdo mungesë të pretenduar në aspektin e kujdesit dhe trajtimit mjekësor. Kërkuesit nuk janë përpjekur t'i shfrytëzonin këto mjete dhe prandaj nuk i janë përmbajtur kërkesës nga Neni 35 i Konventës për shterimin e mjeteve në vend. Rrjedhimisht, Gjykata nuk mund t'i shqyrtojë ankesat e tyre lidhur me kushtet e burgimit; as nuk mundet, për pasojë, të marrë parasysh kushtet e burgimit në formimin e një vlerësimi global mbi trajtimin e kërkuesve për qëllime të Neni 3.

134. Në të gjitha rrethanat e lartpërmendura, Gjykata nuk gjen që burgimi i kërkuesve e ka arritur kufirin e trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës.

135. Kërkuesit po ashtu janë ankuar që nuk kanë pasur mjete efektive në vend për ankesat e tyre nga Neni 3, në shkelje të Neni 13. Në lidhje me këtë, Gjykata përsërit gjetjen e mësipërme që mjetet nga ligji administrativ dhe civil kanë qenë në dispozicion të kërkuesve nëse ata do të kishin dashur të ankoheshin lidhur me kushtet e burgimit. Për sa i përket aspektit më themelor të ankesave, që vetë natyra e skemës së burgimit në Pjesën 4 të Ligjit të vitit 2001 përbënte shkelje të Neni 3, Gjykata kujton që Neni 13

nuk garanton zgjidhje që lejon kontestimin e legjislacionit të shkallës së parë para një autoriteti kombëtar mbi bazën e të qenit kundër Konventës (*James dhe të Tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i datës 21 shkurt 1986, § 85, Seria A nr. 98; *Roche kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], nr. 32555/96, § 137, KEDNJ 2005-X).

136. Prandaj, në përfundim, Gjykata nuk gjen shkelje të Nenit 3, të marrë vetëm apo në lidhje me Nenin 13.

## II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 5 § 1 TË KONVENTËS

137. Kërkuesit pretenduan se burgimi i tyre ishte i paligjshëm dhe në shpërputhje me Nenin 5 § 1 të Konventës.

138. Në vëzhgimet e para me shkrim, pas komunikimit të kërkesës nga Dhoma, Qeveria tregoi se ajo nuk do të kërkonte të ngrinte çështjen e derogimit sipas Nenit 15 të Konventës si mbrojtje ndaj pretendimit të bazuar mbi Nenin 5 § 1, por do ta linte atë pikë si të vendosur kundër tyre nga Dhoma e Lordëve. Përkundrazi, ata synonin ta fokusonin argumentin në mbrojtjen që kërkuesit ishin burgosur në mënyrë të ligjshme me qëllim të dëbimit, brenda kuptimit të Nenit 5 § 1.

Megjithatë, në vëzhgimet e tyre me shkrim drejtuar Dhomës së Madhe, më datë 11 shkurt 2008, Qeveria tregoi për herë të parë që ajo dëshironte të argumentonte se burgimi i kërkuesve në asnjë moment nuk përbënte shkelje të Nenit 5 § 1 sepse derogimi i Mbretërisë së Bashkuar sipas Nenit 15 ishte i vlefshëm.

139. Neni 5 § 1 i Konventës parashikon, për aq sa është relevant:

“1. Secili ka të drejtën për liri dhe siguri të personit. Askush nuk do të privohet nga liria përveç rasteve të mëposhtme dhe në përputhje me një procedurë të parashikuar nga ligji:

...

(f) arrestimi apo ndalimi i ligjshëm i një personi... kundër të cilit po ndërmerren veprime me qëllim të dëbimit apo ekstradimit.”

Neni 15 i Konventës deklaron:

“1. Në kohë lufte apo emergjence tjetër publike që kërcënon jetën e kombit secila Palë e Lartë Kontraktuese mund të marrë masa që derogojnë nga detyrimet e tyre sipas [Konventës] deri në atë shkallë sa është rreptësisht e kërkuar nga urgjenca e situatës, duke u siguruar që këto masa të mos jenë në shpërputhje me detyrimet e tjera sipas së drejtës ndërkombëtare.

2. Asnjë derogim nga Neni 2, përveç se në lidhje me vdekjet që vinë si pasojë e akteve të luftës, ose nga Nenit 3, 4 (§ 1) dhe 7 nuk do të bëhet sipas kësaj dispozite.

3. Çdo Palë e Lartë Kontraktuese që shfrytëzon të drejtën e derogimit do ta informojë hollësisht Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës lidhur me masat që ka marrë dhe arsyet përkatëse. Po ashtu, do të informojë Sekretarin e Përgjithshëm

të Këshillit të Europës kur masa të tilla kanë pushuar së vepruari dhe dispozitat e Konventës po ekzekutohen sërish në formë të plotë.”

## A. Parashtrimet e palëve

### 1. Kërkuesit

140. Kërkuesit kundërshtuan për faktin që, para gjykatave vendase, Qeveria nuk kishte kërkuar të argumentonte që ata ishin ndaluar si “person[a] kundër të cilëve po ndërmerren veprime me qëllim të dëbimit apo ekstradimit”, por ishte mbështetur tek derogimi sipas Nenit 15. Në këto rrethana, kërkuesit u shprehën se ishte abuzive dhe në kundërshtim me parimin e subsidiaritetit nga ana e Qeverisë që të dilte me argument të ri para Gjykatës dhe që ajo duhet të ndalohej nga të vepruarit në këtë mënyrë.

141. Në rast kur Gjykata mendoi se mund ta shqyrtonte parashtrësën e Qeverisë, kërkuesit theksuan se garancia e nenit 5 ishte me rëndësi themelore dhe përjashtimet duhet të interpretoheshin me saktësi të madhe. Aty ku, si në rastin e tyre, dëbimi nuk ishte i mundur për shkak të rrezikut të trajtimit në kundërshtim me nenin 3 në vendin pranues, neni 5 § 1(f) nuk do ta autorizonte ndalimin, pavarësisht nëse individi paraqiste rrezik për sigurinë kombëtare. Thjesht ruajtja e mundësisë së dëbimit nën shqyrtim nuk nënkuptonte “veprim... që ndërmerret me qëllim të dëbimit”; ai ishte veprim, pa lidhje me ndonjë procedurë ekzistuese dëbimi, që mund ta bëjë dëbimin një mundësi në të ardhmen. Ndalimi si pasojë e një “veprimi” kaq më mjegullt dhe jo-specifik do të ishte arbitrar. Për më tepër, ishte e qartë që gjatë periudhave kur çështjet e kërkuesve shqyrtoheshin nga SIAC lidhur me apelin (korrik 2002 – tetor 2003), qëndrimi i Qeverisë ishte që ata nuk mund të dëboheshin në përputhje me Nenin 3 dhe që asnjë negociatë për konkretizimin e dëbimit nuk duhet të tentohej me Shtetet pranuese të propozuara. Kështu, faktikisht Qeveria nuk po e mbante mundësinë e dëbimit të kërkuesve “nën shqyrtim aktiv”.

142. Më tej kërkuesit u ankuan se ishte abuzive nga ana e Qeverisë, kaq vonë në procedurën para Dhomës së Madhe, që të kontestonte vendimin e Dhomës së Lordëve për rrëzimin e derogimit. Sipas mendimit të kërkuesve, do të ishte në shpërputhje me Nenin 19 dhe parimin e subsidiaritetit nëse Gjykatës do t’i kërkohej nga një Qeveri që të rishikonte gabimet e pretenduara në fakte ose në ligj të kryera nga vetë Gjykatat kombëtare të asaj Qeverie. Qëndrimi i Qeverisë në lidhje me kontestimin e gjetjeve të gjykatës së vet supreme mbi legjislacionin që Parlamenti kishte zgjedhur të anulonte me qëllim të kufizimit të të drejtave të njeriut të njohura sipas ligjit vendas duke qenë kështu në konflikt me Nenin 53 të Konventës. Meqenëse legjislacioni ishte revokuar dhe derogimi ishte tërhequr, Qeveria efektivisht po kërkonte të merrte nga Gjykata një opinion këshillues mbi të cilin mbase do të mund të mbështetej në një fazë më të vonshme. Përpjekja për të lejuar Qeverinë të procedonte do të kishte ndikim substancial mbi të drejtën për

kërkesë individuale sipas Nenit 34 duke i penguar kërkuesit nga bërja e ankesave për shkak të frikës që Qeveria do t'i përmbyste vendimet e gjykatave të veta supreme.

143. Në rast se Gjykata do të vendoste të rishikonte ligjshmërinë e derogimit, kërkuesit kundërshtuan duke thënë se Qeveria nuk duhet të lejohej të mbështetej mbi argumente të cilat nuk i kishte paraqitur para gjykatave vendase. Këto përfshinin, së pari, kundërshtimin që ishte e justifikueshme të ndaloheshin të dyshuarit terroristë jo-shtetas ndërkohë që shtetasit përjashtoheshin nga masa të tilla, për shkak të interesit të kultivimit të besnikërisë mes shtetasve myslimanë, në vend të ekspozimit të tyre ndaj kërcënimit të burgimit dhe rrezikut që ata rrjedhimisht të radikalizoheshin dhe, së dyti, argumentin që përdorimi i pushtetit për burgim kundër shtetasve të huaj linte në dispozicion kapacitetet e zbatimit të ligjit për t'u përqendruar tek shtetasit e Mbretërisë së Bashkuar (shih paragrafin 151 poshtë). Meqenëse Qeveria po përpiqej t'i përfshinte këto justifikime për derogimin i cili nuk u paraqit kurrë para gjykatave vendase, Gjykatës po i kërkohet të vepronte si tribunal i shkallës së parë mbi çështje tepër kontradiktore.

144. Përsëri, nëse Gjykata vendoste të shqyrtonte ligjshmërinë e derogimit, nuk kishte arsye për t'i dhënë peshë të veçantë gjetjeve të gjykatave kombëtare lidhur me çështjen nëse ekzistonte emergjencë brenda kuptimit të Nenit 15. Në parashtrirat e kërkuesve nuk kishte precedentë juridikë për të njohur një frikë të pathemeltë nga një sulm terrorist, i cili nuk ishte deklaruar të ishte i afërt. Të gjithë shembujt në jurisprudencën e Konventës në lidhje me derogimet e prezantuara për të luftuar terrorizmin në vazhdim çka qartazi rrezikonte të tërë infrastrukturën e Irlandës Veriore dhe Turqisë Juglindore. Autoritetet vendase kishin gabuar në interpretimin e Nenit 15 si lejim i një derogimi ku kërcënimi nuk drejtohej drejtpërdrejt ndaj Mbretërisë së Bashkuar por ndaj vendeve të tjera me të cilat ajo ishte aleate.

145. Sidoqoftë, miratimi i Pjesës 4 të Ligjit të vitit 2001 dhe pushteti i përmbajtur aty për ndalimin e shtetasve të huaj për një kohë të pacaktuar pa akuza nuk "kërkohej rreptësisht nga urgjenca e situatës", siç gjeti Dhoma e Lordëve. Masat e kundërshtuara nuk ishin lidhur në mënyrë racionale me nevojën e parandalimit të një sulmi terrorist mbi Mbretërinë e Bashkuar dhe ato përfshinin një diskriminim të pajustificuar mbi baza kombësie. SIAC – i cili ka parë si materialin e mbyllur, ashtu edhe atë të hapur – arriti në përfundimin që kishte prova të bollshme që shtetasit britanikë paraqisnin një kërcënim shumë domethënës. Nuk mund të kishte baza për të vendosur që e drejta themelore për liri ishte më pak e rëndësishme për një jo-shtetas sesa për një shtetas. Të huajt gëzonin të drejtën e trajtimit të barabartë jashtë kontekstit të imigracionit dhe aktivitetit politik, si çështje e vendosur e ligjit të brendshëm, Konventës dhe së drejtës publike ndërkombëtare. Kishte masa të tjera më pak ndërhyrëse të cilat do të mund të ishin përdorur për t'iu

adresuar kërcënimit, për shembull, përdorimi i urdhrave të kontrollit krijuar nga Ligji për Parandalimin e Terrorizmit të vitit 2005; krijimi i veprave penale të reja për të lejuar ndjekjen penale të individëve të angazhuar në përgatitjen e aktiviteteve terroriste; ose heqja e ndalimit të përdorimit të materialeve të përfuara nga përgjimet e komunikimeve gjatë procedurave penale.

## 2. *Qeveria*

146. Qeveria tha se Shtetet janë të drejtën themelore sipas së drejtës ndërkombëtare që të kontrollojnë hyrjen, qëndrimin dhe përjashtimin e të huajve. Do të kërkohej gjuhë e qartë për të justifikuar përfundimin që Shtetet Kontraktuese synonin që përmes Konventës të hiqnin dorë nga aftësia e tyre për të mbrojtur vetveten para një rreziku ndaj sigurisë kombëtare të krijuar nga një jo-shtetas. Nga këndvështrimi i gjuhës së zakonshme, “veprimi i ndërmarrë me qëllim të dëbimit” mbulonte situatën ku një Shtet Kontraktues dëshironte të dëbonte një të huaj, e mbante këtë mundësi nën shqyrtim aktiv, dhe nuk e bënte këtë vetëm për shkak të rrethanave të mundshme jo thelbësore. Në çështjen *Chahal* cituar lart, një periudhë ndalimi prej mbi gjashtë vitesh, përfshirë tre vite gjatë të cilave kërkuesi nuk mund të zhvendosej për shkak të një mase të përkohshme të kërkuara nga Komisioni, u gjykua e pranueshme sipas nenit 5 § 1(f).

147. Secilit kërkues iu paraqit një Lajmërim i Qëllimit për Dëbim në të njëjtën kohë që u certifikua sipas Ligjit të vitit 2001. Kërkuesi i dytë dhe i katërt zgjodhën që të shkonin në Marok dhe Francë, respektivisht, dhe u lejuan të largoheshin nga Mbretëria e Bashkuar sapo të organizohej, në mënyrë që të mos dilnin probleme nga neni 5 § 1 për sa u përkiste atyre. Mundësia e dëbimit të kërkuesve të tjerë u mbajt nën shqyrtim aktiv gjatë tërë periudhës së burgimit. Kjo përfshinte monitorimin e situatës në vendet e tyre të origjinës. Më tej, nga fundi i vitit 2003 e në vazhdim, Qeveria ishte në negociata me Algjerinë dhe Jordaninë, me qëllim që të arrinte memorandume mirëkuptimi që kërkuesit që ishin shtetas të atyre vendeve nuk do të keqtrajtoheshin nëse do të ktheheshin.

148. Qeveria u mbështet mbi parimin e ekuilibrit të drejtë, i cili përshkon tërë Konventën, dhe arsyetoi që nën-paragrafi (f) i nenit 5 § 1 duhet të interpretohej në mënyrë të atillë që të vendoste një ekuilibër të drejtë mes interesave të individit dhe interesave të Shtetit në mbrojtjen e popullsisë së vet nga të huajt keqdashës. Burgimi e vendosi këtë ekuilibër duke avancuar qëllimin legjitim të Shtetit për të siguruar mbrojtjen e popullsisë pa sakrifikuar interesat mbizotëruese të të huajit për të shmangur kthimin në një vend ku ai përballej me torturën ose vdekjen. Ekuilibri i drejtë më tej u ruajt duke i ofruar të huajit mjete mbrojtëse të përshtatshme kundër ushtrimit arbitrar të pushtetit të ndalimit në rastet e sigurisë kombëtare.



149. Përndryshe, ndalimi i kërkuesve nuk ishte në shkelje të Konventës për shkak të derogimit sipas Nenit 15. Në kohën relevante ekzistonte një emergjencë publike që kërcënonte jetën e kombit. Ky vlerësim iu nënshtrua një hulumtimi të plotë nga gjykatat vendase. Provat mbështetëse, si të hapurat ashtu edhe të mbyllurat, u shqyrtuan nga SIAC me hollësi, edhe përmes seancave dëgjimore verbale ku dëshmitarët u morën në pyetje nga pala e kundërt. SIAC njëzëri e miratoi vlerësimin e Qeverisë, siç bëri po njëzëri edhe Gjykata e Apelit dhe tetë nga nëntë gjyqtarët e Dhomës së Lordëve. Duke pasur parasysh hapësirën e vlerësimit që u lejohet autoriteteve kombëtare lidhur me këtë pikë, nuk kishte bazë të përshtatshme mbi të cilën Gjykata të mund të arrinte një përfundim tjetër.

150. Qeveria shpjegoi që ajo e respektoi shumë vendimin e Dhomës së Lordëve dhe deklaratën e papërputhshmërisë, dhe që ajo e kishte anuluar ligjin shkelës. Pavarësisht nga kjo, kur u vendos që çështja t'i referohej Dhomës së Madhe, ajo vendosi që ishte e nevojshme të sfidohehin arsyetimet dhe përfundimet e Dhomës së Lordëve, duke pasur parasysh rëndësinë e gjerë kushtetuese të çështjes dhe nevojën e vazhdueshme që Shtetet Kontraktuese të kenë drejtim të qartë nga Dhoma e Madhe lidhur me masat që mund të përpiqen të marrin në mënyrë legjitime për të parandaluar konkretizimin e kërcënimit terrorist. Ajo parashtroi që Dhoma e Lordëve kishte gabuar kur iu ka dhënë Shteteve një hapësirë shumë të ngushtë për të vlerësuar se cilat masa ishin rreptësisht të nevojshme; në këtë aspekt, vlente të shënohej se Pjesa 4 e Ligjit të vitit 2001 nuk ishte i vetmi produkt i vendimit të Qeverisë por ishte gjithashtu çështje debati në Parlament. Për më tepër, gjykatat vendase e kishin shqyrtuar legjislacionin të përmbledhur, në vend që të shqyrtonin çështjet konkrete të kërkuesve, përfshirë edhe pamundësinë e zhvendosjes së tyre, kërcënimin që paraqiste secili për sigurinë kombëtare, pamjaftueshmërinë e vëzhgimit të shtuar, ose kontrole të tjera përveç burgimit dhe mjeteve procedurale në dispozicion të secilit kërkues.

151. Së fundi, përfundimi i Dhomës së Lordëve ishte kthyer jo në bazë të mohimit të nevojshmërisë së burgimit të kërkuesve, por në bazë të mungesës së pushtetit legjislativ për të ndaluar edhe një shtetas që paraqiste rrezik për sigurinë kombëtare dhe dyshohej si terrorist ndërkombëtar. Megjithatë, kishte arsye të forta për ndalimin e jo-shtetasve dhe Konventa shprehimisht dhe tërthorazi e njohu faktin që dallimi mes shtetasve dhe jo-shtetasve ishte i lejueshëm në fushën e imigrimit. Masa e parë që Qeveria dëshironte të ndërmernte kundër kërkuesve ishte dëbimi, një masë e lejuar për jo-shtetasit por jo për shtetasit. Analogjia e bërë nga Dhoma e Lordëve mes “të huajve [siç janë kërkuesit] të cilët nuk mund të dëbohen” dhe “shtetasve britanikë të cilët nuk mund të dëbohen” ishte fals, sepse kërkuesit në kohën e ndalimit të tyre nuk ishin të pazhvendosshëm në të njëjtën mënyrë në të cilën një shtetas britanik do të ishte i pazhvendosshëm. Më tej, gjatë periudhës në fjalë vlerësimi i Qeverisë ishte që rreziku nga jo-shtetasit

ishte më i madh dhe ishte legjitime për një Shtet, në kushtet e emergjencës kombëtare, që të procedonte hap pas hapi dhe të synonte të neutralizonte fillimisht atë që perceptohej si kërcënimi më i madh, duke lënë të lira burimet e duhura për t'u marrë me kërcënimin më të vogël nga shtetasit britanikë. Përveç kësaj, ishte e arsyeshme që Shteti të merrte parasysh ndjeshmërinë e popullsisë së tij myslimane në mënyrë që të reduktoheshin mundësitë e rekrutimit të pjesëtarëve të kësaj popullsie nga ekstremistët.

### *3. Pala e tretë, Liberty*

152. Liberty (shih paragrafin 6 lart) parashtroi që, duke rezervuar para gjykatave vendase çështjen nëse ndalimi ishte në përputhje me Nenin 5 § 1, Qeveria e kishte privuar Gjykatën nga pasja e pikëpamjeve të Dhomës së Lordëve dhe kishte ndjekur një linjë veprimi e cila nuk do të ishte e hapur ndaj një kërkuesi. Sidoqoftë, ndalimi nuk hynte në përjashtimin e Nenit 5 § 1(f), meqenëse Pjesa e Ligjit të vitit 2001 lejonte burgim në kohë të pacaktuar dhe meqenëse nuk kishte pritje konkrete që dëbimi i kërkuesve gjatë kohës relevante të ishte i mundur. Nëse Qeveria nuk pati mundësi t'i zhvendoste kërkuesit për shkak të të drejtave të tyre nga Neni 3, ajo nuk mundi të mbështetej siç duhej mbi shqetësimet lidhur me sigurinë kombëtare si bazë për dobësimin apo modifikimin e të drejtave të tyre nga neni 5. Në vend të kësaj, linja e duhur e veprimit ishte ose derogimi nga neni 5 deri në shkallën që kërkohet rreptësisht nga situata, ose ndjekja penale e individëve të lidhur me një nga veprat e shumta penale terroriste në statutet e Mbretërisë së Bashkuar, ku përfshiheshin anëtarësia e deklaruar në një organizatë të ndaluar, mos-lajmërimi i autoriteteve lidhur me aktivitete terroriste, posedimi i artikujve inkriminues dhe inkurajimi indirekt për kryerjen, përgatitjen apo nxitjen e akteve të terrorizmit (shih paragrafët 89 dhe 95 lart).

## **B. Vlerësimi i Gjykatës**

### *1. Sfera e çështjes para Gjykatës*

153. Gjykata duhet të fillojë duke vendosur mbi kundërshtimin fillestar paraprak të kërkuesve, që Qeveria duhet të jetë e përjashtuar nga paraqitja e mbrojtjes ndaj ankesave nga Neni 5 § 1 bazuar mbi përjashtimin në nën-paragrafin 5 §1(f), mbi bazën e faktit që ata nuk e kanë ngritur këtë çështje para gjykatave vendase.

154. Gjykata konceptohet si ndihmesë e sistemeve kombëtare në mbrojtje të të drejtave të njeriut. Prandaj, është me vend që gjykatat vendase të kenë fillimisht mundësinë të vendosin lidhur me çështje të përputhshmërisë së ligjit vendor me Konventën dhe që, nëse rrjedhimisht para Gjykatës del një kërkesë gjithsesi, ajo duhet të ketë benefitin e pikëpamjeve të gjykatave kombëtare, si organizma që janë në kontakt të

drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshëm me forcat e vendeve të tyre (shih *Burden*, cituar lart, § 42). Kështu pra, është me rëndësi që argumentet e paraqitura nga Qeveria para gjykatave kombëtare të jenë në të njëjtat linja me ato të paraqitura para kësaj Gjykate. Në mënyrë të veçantë, nuk i takon një Qeverie që t'i vendosë argumentet e Gjykatës të cilat janë në shpërputhje me qëndrimin e saj para gjykatave kombëtare (shih, *mutatis mutandis*, *Pine Valley Developments Ltd dhe të Tjerë kundër Irlandës*, vendimi i datës 29 nëntor 1991, § 47, Seria A nr. 222; *Kolompar kundër Belgjikës*, vendimi i datës 24 shtator 1992, §§ 31-32, Seria A nr. 235-C).

155. Megjithatë, Gjykata nuk konsideron që Qeveria është e ndaluar nga mbështetja tek nën-paragrafi (f) i Nenit 5 § 1 për të justifikuar ndalimin. Është e qartë se Qeveria shprehimisht e ka mbajtur të hapur, në tekstin e derogimit dhe gjatë procedurave të derogimit para gjykatave vendase, çështjen e zbatimit të Nenit 5. Për më tepër, shumica e Dhomës së Lordëve, qoftë shprehimisht apo në mënyrë të tërthortë, shqyrtuan nëse ndalimi ishte në përputhje me Nenin 5 § 1 para se të vlerësonin vlefshmërinë e derogimit (shih paragrafin 17 lart).

156. Kërkuesit më tej kundërshtuan duke thënë se Qeveria nuk duhet të lejohej të kontestonte para Gjykatës gjetjen e Dhomës së Lordëve që derogimi ishte i pavlefshëm.

157. Pa dyshim, situata aktuale është e pazakontë meqenëse Qeveritë zakonisht nuk shkojnë deri tek sfidimi, as nuk e shohin të nevojshëm kontestimin, e vendimeve të gjykatave të tyre më të larta para kësaj Gjykate. Megjithatë, nuk ekziston ndonjë ndalesë që një Qeveri të ngrejë sfida të tilla, sidomos nëse ajo konsideron që vendimi i gjykatës supreme të vendit është problematik nën prizmin e Konventës dhe që kërkohet këshillim i mëtejshëm nga Gjykata.

158. Në rastin konkret, për shkak se një deklarami papërputhshmërie nga Ligji i Të Drejtave të Njeriut nuk është i detyrueshëm mbi palët që janë pjesë e çështjes në vend (shih paragrafin 94 lart), sukcesi i kërkuesve në Dhomën e Lordëve nuk ka çuar as drejt lirimit të tyre të menjëhershëm, as drejt pagimit të kompensimit për ndalim të paligjshëm dhe prandaj ishte e nevojshme që ata të paraqisnin kërkesën në fjalë. Gjykata nuk konsideron që ka arsye, nga aspekti parimor, për të cilën, meqenëse kërkuesit e kanë kërkuar për të shqyrtuar ligjshmërinë e ndalimit të tyre, Qeveria tani nuk duhet ta kishte mundësinë për paraqitjen e të gjitha argumenteve që ka në dispozicion për të mbrojtur procedurat, edhe nëse kjo përfshin vënien në diskutim të përfundimit të gjykatës së vet supreme.

159. Prandaj, Gjykata i rrëzon dy kundërshtimet paraprake të kërkuesve.

## 2. *Pranueshmëria*

160. Gjykata konsideron që ankesat e kërkuesve nga Neni 5 § 1 i Konventës ngrenë çështje komplekse në aspekt të ligjit dhe fakteve, përcaktimi i të cilave duhet të varej nga shqyrtimi i themeleve të çështjes.

Prandaj, ajo përfundon që kjo pjesë e kërkesës nuk është qartazi e pabazuar brenda kuptimit të Nenit 35 § 3 të Konventës. Baza të tjera papranueshmërie nuk janë ngritur, prandaj kërkesa duhet të deklarohet e pranueshme.

### 3. Themelet

161. Gjykata duhet së pari të konstatojë me siguri nëse ndalimi i kërkuesve ka qenë i lejueshëm sipas Nenit 5 § 1(f), sepse nëse ai nën-paragraf nuk ofron mbrojtje ndaj ankesave nga Neni 5 § 1, nuk do të jetë e nevojshme të vendoset nëse derogimi ishte i vlefshëm apo jo (shih *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i datës 18 janar 1978, § 191, Seria A, nr. 25).

#### a. Nëse kërkuesit janë ndaluar në mënyrë të ligjshme në përputhje me Nenin 5 § 1(f) të Konventës

162. Neni 5 ngërthen një të drejtë themelore të njeriut, më saktë mbrojtjen e individit kundër ndërhyrjes arbitrare nga Shteti në të drejtën e tij/saj për liri (*Aksoy kundër Turqisë*, vendimi i datës 18 dhjetor 1996, § 76, *Përmbledhjet* 1996-VI). Teksti i Nenit 5 e bën të qartë se garancitë që parashikon ai janë të zbatueshme për “secilin”.

163. Nën-paragrafët (a) deri në (f) të Nenit 5 § 1 përmbajnë një listë përfshirëse të bazave të lejueshme mbi të cilat personat mund të privohen nga liria e tyre dhe asnjë privim nga liria nuk do të jetë i paligjshëm përveç se nëse bazohet mbi njërën nga këto baza (*Saadi kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], nr. 13229/03, § 43, KEDNJ 2008). Një nga përjashtimet, e përmbajtura në nën-paragrafin (f), i lejon Shtetit të kontrollojë lirinë e të huajve në kontekst imigracioni (idem., § 64). Qeveria kundërshton që ndalimi i kërkuesve ka qenë i justifikuar sipas pjesës së dytë të atij nën-paragrafi dhe që ata janë ndaluar ligjërisht si persona “kundër të cilëve po ndërmerren veprime me qëllim të dëbimit ose ekstradimit”.

164. Neni 5 § 1(f) nuk kërkon që ndalimi të konsiderohet në mënyrë të arsyeshme, për shembull për parandalimin e një individi nga kryerja e një vepre penale apo arratisja. Çdo privim nga liria sipas pjesës së dytë të nenit 5 § 1(f) do të jetë i justifikuar, sidoqoftë, vetëm për sa kohë që vazhdojnë procedurat e dëbimit ose ekstradimit. Nëse këto procedura nuk ndiqen me zellin e dukur, ndalimi do të pushojë së qeni i lejueshëm sipas nenit 5 § 1(f) (*Chahal*, cituar lart, § 113). Privimi i lirisë po ashtu duhet të jetë “i ligjshëm”. Aty ku “ligjshmëria” e ndalimit është çështje problematike, përfshirë edhe çështjen nëse është ndjekur një “procedurë e parashikuar me ligj”, Konventa i referohet në thelb ligjit kombëtar dhe parashtron detyrimin për t’iu përmbajtur rregullave substantive dhe procedurale të së drejtës vendase. Megjithatë, të vepruarit në përputhje me ligjin vendas nuk mjafton: neni 5 § 1 kërkon edhe më tej që çdo privim nga liria të bëhet në përputhje me qëllimin e mbrojtjes së individit nga arbitrariteti. Është një parim themelor që asnjë ndalim i cili është arbitrar nuk mund të jetë në përputhje

me nenin 5 § 1 dhe nocioni i “arbitraritetit” në nenin 5 § 1 shkon përtej mungesës së përputhshmërisë me ligjin kombëtar, kështu që privimi nga liria mund të jetë i ligjshëm në aspekt të ligjit vendas por edhe arbitrar e rrjedhimisht në kundërshtim me Konventën (*Saadi kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar lart, § 67). Për t’iu shmangur etiketimit si arbitrar, ndalimi sipas Nenit 5 § 1(f) duhet të zhvillohet në mirëbesim; duhet të jetë i lidhur ngusht me bazat e ndalimit mbi të cilat mbështetet Qeveria; vendi dhe kushtet e ndalimit duhet të jenë të përshtatshme; dhe kohëzgjatja e ndalimit nuk duhet ta tejkalojë periudhën e arsyeshme të parashikuar për qëllimin e synuar (shih *mutatis mutandis*, *Saadi kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar lart, § 74).

165. Kërkuesi i parë, i tretë, dhe i gjashtë u ndaluan dhe burgosën më 19 dhjetor 2001 në bazë të Ligjit të vitit 2001; kërkuesi i shtatë u ndalua më 9 shkurt 2002; kërkuesi i tetë më 23 tetor 2002; kërkuesi i nëntë më 22 prill 2002; kërkuesi i dhjetë më 14 janar 2003; dhe kërkuesi i njëmbëdhjetë më 2 tetor 2003. Anjëri nga këta kërkues nuk u lirua deri më 10-11 mars 2005. Kërkuesi i pestë u ndalua mes 19 dhjetorit 2001 dhe 22 prillit 2004, kur u lirua me dorëzani nën kushte të rrepta. Kërkuesi i dytë dhe i tretë po ashtu u ndaluan më 19 dhjetor 2001 por kërkuesi i dytë u lirua më 22 dhjetor 2001, pas vendimit të tij për të shkuar në Marok, dhe kërkuesi i katërt u lirua më 13 mars 2002, pas vendimit të tij për të shkuar në Francë. Kërkuesit u mbajtën gjatë tërë kohës në kushte sigurie të lartë qoftë në Belmarsh apo në Burgim Woodhill apo në Spitalin Broadmoor. Prandaj nuk mund të diskutohet që ata u privuan nga liria e tyre brenda kuptimit të nenit 5 § 1 (shih *Engel dhe të Tjerë kundër Hollandës*, vendimi i datës 8 qershor 1976, Seria A, nr. 22).

166. Kërkuesit ishin shtetas të huaj të cilët Qeveria do t’i kishte dëbuar nga Mbretëria e Bashkuar sikur të kishte qenë e mundur të gjendej një Shtet që t’i pranonte në të cilin ata nuk do të rrezikonin trajtim në kundërshtim me nenin 3 të Konventës (*Saadi kundër Italisë* [CG], nr. 37201/06, §§ 125 dhe 127, KEDNJ 2008). Megjithëse detyrimet e Shtetit përgjegjës sipas nenit 3 e ndalonin zhvendosjen e kërkuesve nga Mbretëria e Bashkuar, pavarësisht nga kjo Sekretari i Shtetit e konsideroi të nevojshme t’i ndalonte ata për arsye sigurie, sepse ai besonte që prania e tyre në vend përbënte rrezik ndaj sigurisë kombëtare dhe dyshonte që ata ishin ose kishin qenë të lidhur me kryerjen, përgatitjen ose nxitjen e akteve të terrorizmit ndërkombëtar dhe ishin anëtarë ose i përkisnin ose kishin lidhje me një grup terrorist ndërkombëtar. Një ndalim i tillë do të kishte qenë i paligjshëm sipas ligjit vendas para miratimit të Pjesës 4 të Ligjit të vitit 2001, meqenëse vendimi i vitit 1984 në çështjen *Hardial Singh* kishte të bënte me faktin që pushteti për të ndaluar nuk mund të ushtrohej nëse personi që i nënshtrohej urdhrin të dëbimit nuk mund të dëbohej brenda një periudhe kohore të arsyeshme (shih paragrafin 87 lart). Kështu, në lajmërimin për derogim që u bë sipas neni 15 të Konventës thuhej që kërkohet pushtet shtesë për të arrestuar dhe mbajtur

në ndalim një shtetas të huaj “ku zhvendosja ose dëbimi nuk është i mundur tani për tani, me pasojën që ndalimi do të ishte i paligjshëm sipas pushtetit të ligjit ekzistues vendas” (shih paragrafin 11 lart).

167. Një nga supozimet kryesore në kuadër të lajmërimit për derogim, Ligji i vitit 2001 dhe vendimi për t’i ndaluar kërkuesit, ishte pra që ata nuk mund të zhvendoseshin e as të dëboheshin “tani për tani” (shih paragrafët 11 dhe 90 lart). Nuk ka prova që gjatë periudhës së ndalimit të kërkuesve, përveç rastit të kërkuesit të dytë dhe të katërt, çdo perspektivë realiste që ata të përjashtoheshin pa i dhënë shkak një rreziku të vërtetë keqtrajtimi në kundërshtim me nenin 3. Në fakt, kërkuesi i parë është pa shtet dhe Qeveria nuk ka paraqitur ndonjë provë për të sugjeruar që kishte ndonjë Shtet tjetër që ishte i gatshëm ta pranonte. Nuk duket që Qeveria ka hyrë në negociata me Algjerinë apo Jordaninë, me qëllim të kërkimit të garancive që kërkuesit që janë shtetas të këtyre vendeve nuk do të keqtrajtohen nëse kthehen, deri në fund të vitit 2003, dhe deri në gusht 2005 nuk u mor asnjë garanci e tillë (shih paragrafin 86 lart). Në këto rrethana, Gjykata nuk konsideron që politika e Qeverisë përgjegjëse për ruajtjen e mundësisë së dëbimit të kërkuesve “nën shqyrtim aktiv” ishte aq e sigurt apo e vendosur sa të shkonte deri tek “veprimi... i ndërmarrë pa qëllim dëbimi”.

168. Përjashtimet ndaj këtij përfundimi u panë në rastin e kërkuesit të dytë, i cili u ndalua vetëm për tre ditë para kthimit të tij në Marok, dje kërkuesit të katërt, i cili u largua nga Mbretëria e Bashkuar për në Francë më 13 mars 2002, pasi kishte qenë i ndaluar vetëm për tre muaj (shih paragrafët 35 dhe 41 lart). Gjykata konsideron që gjatë këtyre periudhave të burgimit mund të thuhet me arsye se po merreshin veprime kundër këtyre kërkuesve me qëllim dëbimi, në kuptimin që duket se autoritetet ishin ende në atë kohë në fazën e vendosjes së kombësisë/shtetësisë së tyre dhe duke diskutuar nëse lëvizja e tyre për në vende të tjera të origjinës së tyre ose në vendet e tyre do të ishte e mundur (shih *Gebremedhin [Gaberamadhiën] kundër Francës*, nr. 25389/05, § 74, 26 prill 2007). Rrjedhimisht, nuk ka pasur shkelje të nenit 5 § 1 të Konventës në lidhje me kërkuesin e dytë dhe të katërt.

169. Është e vërtetë që edhe kërkuesit që janë mbajtur më gjatë nuk u mbajtën aq gjatë sa kërkuesit në çështjen *Chahal* (cituar lart), ku Gjykata nuk gjeti shkelje të nenit 5 § 1 pavarësisht nga fakti që ai ishte mbajtur në burg mbi gjashtë vjet. Megjithatë, në çështjen *Chahal*, gjatë tërë periudhës së burgimit, procedurat kanë vazhduar në mënyrë aktive dhe të zellshme, para autoriteteve vendase dhe Gjykatës, për të përcaktuar nëse do të ishte e ligjshme dhe në përputhje me nenin 3 të Konventës të vazhdohej me dëbimin e kërkuesit për në Indi. Nuk mund të thuhet e njëjta gjë edhe për rastin konkret, ku procedurat janë marrë kryesisht me ligjshmërinë e ndalimit.

170. Në rrethanat e çështjes konkrete, nuk mund të thuhet që kërkuesi i parë, i tretë, i pestë, i gjashtë, i shtatë, i tetë, i nëntë, i dhjetë dhe i

njëmbëdhjetë ishin persona “kundër të cilëve [ishin] duke u ndërmarrë veprime me qëllim të dëbimit ose ekstradimit”. Megjithatë, burgimi i tyre nuk hynte tek përjashtimi nga e drejta për liri e parashikuar në paragrafin 5 § 1(f) të Konventës. Ky është një përfundim i cili po ashtu, shprehimisht apo në mënyrë të tërthortë, u arrit nga shumica e anëtarëve të Dhomës së Lordëve (shih paragrafin 17 lart).

171. Ndërkohë, është e qartë nga kushtet e lajmërimit të derogimit dhe Pjesës 4 të Ligjit të vitit 2001 që kërkuesit ishin certifikuar dhe ndaluar sepse dyshoheshin të ishin terroristë ndërkombëtarë dhe për shkak se besohej që prania e tyre në Mbretërinë e Bashkuar përbënte kërcënim për sigurinë kombëtare. Gjykata nuk e pranon argumentin e Qeverisë që Neni 5 § 1 lejon që të vendoset një ekuilibër mes të drejtës së individit për liri dhe interesit të Shtetit për mbrojtjen e popullsisë së tij nga kërcënimi terrorist. Ky argument është në shpërputhje jo vetëm me jurisprudencën e Gjykatës sipas nën-paragrafit (f) por edhe me parimin që paragrafët (a) deri në (f) përbëjnë një listë përfshirëse përjashtimesh dhe që vetëm një interpretim i ngushtë i këtyre përjashtimeve është në përputhje me qëllimet e nenit 5. Nëse burgimi nuk bie brenda kufijve të paragrafëve siç interpretohet nga Gjykata, ai nuk mund të hyjë aty me zor me anë të një ankese ndaj nevojës për të ekuilibruar interesat e Shtetit kundrejt atyre të të ndaluarit.

172. Gjykata rikujton se ajo në disa raste ka gjetur që internimi dhe burgimi parandalues pa akuza nuk ishte në përputhje me të drejtën themelore për liri sipas nenit 5 § 1, në mungesë të një derogimi të vlefshëm sipas nenit 15 (shih *Lawless kundër Irlandës (nr. 3)*, vendimi i datës 1 korrik 1961, §§ 13 dhe 14, Seria A nr. 3; *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar lart, §§ 194-196 dhe 212-213). Prandaj, tani ajo duhet të konsiderojë nëse derogimi i Mbretërisë së Bashkuar ka qenë i vlefshëm.

**b. Nëse Mbretëria e Bashkuar ka deroguar në mënyrë të vlefshme nga detyrimet e saj sipas Neni 5 § 1 të Konventës**

*i. Qasja e Gjykatës*

173. Gjykata kujton se secili Shtet Kontraktues, brenda përgjegjësisë së vet për “jetën e kombit [të tij]”, ka për detyrë të përcaktojë nëse ajo jetë është e kërcënuar nga një “emergjencë publike” dhe, nëse po, sa larg është i gatshëm të shkojë duke u përpjekur ta tejkalojë atë emergjencë. Për shkak të kontaktit të tyre të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshëm me nevojat urgjente të momentit, autoritetet kombëtare në parim janë në pozicion më të mirë sesa gjyqtari ndërkombëtar për të vendosur si në lidhje me praninë e një emergjence të tillë, ashtu edhe në lidhje me natyrën dhe shkallën e derogimeve të nevojshme për ta shmangur atë. Rrjedhimisht, në këtë çështje duhet të lihet një hapësirë e gjerë vlerësimit për autoritetet kombëtare.

Pavarësisht nga kjo, Palët Kontraktuese nuk gëzojnë hapësirë veprimi të pakufizuar. I takon Gjykatës të vendosë nëse, *inter alia*, Shtetet kanë shkuar

përtej “shkallës rreptësisht të kërkuar nga urgjenca” e krizës. Hapësira vendase e vlerësimit kështu shoqërohet nga një mbikëqyrje europiane. Në ushtrimin e kësaj mbikëqyrjeje, Gjykata duhet t’i japë peshën e duhur faktorëve relevantë meqenëse natyra e të drejtave të ndikuara nga derogimi dhe rrethanat që shpien tek, dhe kohëzgjatja e, situatës së emergjencës (*Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar lart, § 207; *Brannigan dhe McBride kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i datës 26 maj 1993, § 43, Seria A nr. 258; *Aksoy*, cituar lart, § 68).

174. Objekti dhe qëllimi i ngërthyer në Konventë, siç shënohet në nenin 1, është që të drejtat dhe liritë duhet të sigurohen nga Shteti Kontraktues brenda juridiksionit të tij. Është themelore për makinerinë e mbrojtjes të vendosur nga Konventa që vetë sistemet kombëtare të ofrojnë zgjidhje për shkeljet e dispozitave të saj, ku Gjykata të luajë një rol mbikqyrës që i nënshtrohet parimit të subsidiaritetit (*Z. dhe të Tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 29392/95, § 103, KEDNJ 2001-V). Për më tepër, gjykatat vendase janë pjesë e “autoriteteve kombëtare” të cilave Gjykata u lejon hapësirë të gjerë vlerësimi sipas nenit 15. Në rrethanat e pazakonta të rastit të tanishëm, ku gjykata më e lartë vendase ka shqyrtuar çështjet lidhur me derogimin e Shtetit dhe ka arritur në përfundimin që ekzistonte një emergjencë publike që kërcënonte jetën e kombit por që masat e marra në reagim ndaj saj nuk ishin rreptësisht të kërkuara nga urgjenca e situatës, Gjykata konsideron që do të ishte e justifikuar arritja e një përfundimi të kundërt vetëm nëse do të bindej që gjykata vendase kishte keqinterpretuar apo keqzbatuar nenin 15 ose jurisprudencën e Gjykatës sipas atij neni ose kishte arritur një përfundim i cili ishte dukshëm i paarsyeshëm.

*ii. Nëse ka ekzistuar një “emergjencë publike që kërcënonte jetën e kombit”*

175. Kërkuesit argumentuan që nuk kishte pasur emergjencë publike që kërcënonte jetën e kombit britanik, për tri arsye kryesore: së pari, emergjenca nuk ishte as aktuale, as e pritshme; së dyti, nuk ishte e natyrës së përkohshme; dhe, së treti, praktika e Shteteve të tjera, ku asnjëri nuk kishte deroguar nga Konventa, së bashku me pikëpamjet e informuara të trupave të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, sugjeronte që ekzistenca e një emergjence publike nuk ishte konstatuar.

176. Gjykata kujton që në çështjen *Lawless*, cituar më lart, § 28, ajo vendosi që në kontekstin e nenit 15 kuptimi i natyrshëm dhe i zakonshëm i fjalëve “emergjenca të tjera publike që kërcënojnë jetën e kombit” ishin mjaft të qarta dhe që ata i referoheshin “një situatë të jashtëzakonshme krize apo emergjence e cila ndikon mbi tërë popullsinë dhe përbën kërcënim për jetën e organizuar të komunitetit nga i cili përbëhet Shteti”. Në *Çështjen Greke* (1969) 12 YB 1, § 153, Komisioni u shpreh se, për të justifikuar derogimin, emergjenca duhet të ishte aktuale ose e pritshme; që ajo duhet të ndikonte tërë kombin në atë masë sa të kërcënohej vazhdimësia e jetës së



organizuar të komunitetit; dhe që kriza apo rreziku duhet të ishte i jashtëzakonshëm, që do të thotë se masat apo kufizimet normale, që lejohen nga Konventa për ruajtjen e sigurisë, shëndetit dhe rendit publik, ishin dukshëm të pamjaftueshme. Në çështjen *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar lart, §§ 205 dhe 212, palët u pajtuan, ashtu si edhe Komisioni dhe Gjykata, që prova e nenit 15 ishte përmbushur, meqenëse terrorizmi kishte vite që përbënte “një rrezik posaçërisht të gjerë dhe akut për integritetin territorial të Mbretërisë së Bashkuar, institucionet e gjashtë krahinave dhe jetën e banorëve të provincës.” Gjykata arriti në përfundime të njëjta për sa i përket situatës së vazhdueshme të sigurisë në Irlandën Veriore në çështjen *Brannigan dhe McBride*, cituar lart, dhe në çështjen *Marshall kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vend.), nr. 41571/98, datë 10 korrik 2001. Në çështjen *Aksoy*, cituar lart, ajo pranoi që dhuna separatiste kurde kishte çuar deri tek “emergjenca publike” në Turqi.

177. Para gjykatave vendase, Sekretari i Shtetit nxori prova për të treguar ekzistencën e një kërcënimi për sulme terroriste të rënda të planifikuara kundër Mbretërisë së Bashkuar. Prova të tjera të mbyllura u paraqitën para SIAC. Të gjithë gjyqtarët kombëtarë pranuan që rreziku ishte i besueshëm (me përjashtim të Lordit Hoffmann, i cili nuk konsideroi që rreziku ishte i një natyre të tillë që përbënte “rrezik për jetën e kombit”: shih paragrafin 18 lart). Me gjithë faktin që kur u bë derogimi asnjë sulm i al’Qaedës nuk kishte ndodhur mbi territorin e Mbretërisë së Bashkuar, Gjykata nuk konsideron që autoritetet kombëtare mund të kritikohen, duke pasur parasysh provat që kishin përpara në atë kohë, për frikën që një sulm i tillë ishte “i afërt”, duke menduar që në çfarëdo kohe mund të kryheshin mizori pa paralajmërim. Kërkesa për afërsinë e sulmit nuk mund të interpretohet aq ngusht sa t’i kërkohet një Shteti të presë që të godasë fatkeqësia në mënyrë që të marrë masa kundër saj. Për më tepër, pas bombave dhe bombave të mbetura në tentativë në Londër në korrikun e vitit 2005, rreziku i një sulmi terrorist, tragjikisht, u pa se kishte qenë mjaft real. Meqenëse qëllimi i nenit 15 është t’u lejohet Shteteve të marrin masa derogimi për të mbrojtur popullsinë e tyre nga rreziqe të ardhshme, ekzistenca e kërcënimit ndaj jetës së kombit duhet të vlerësohet kryesisht duke iu referuar atyre fakteve që kanë qenë të njohura në kohën e derogimit. Megjithatë, Gjykata nuk përjashtohet nga marrja parasysh e informacioneve të cilat dalin në dritë më pas (shih, *mutatis mutandis*, *Vilvarajah dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i datës 30 tetor 1991, § 107(2), Seria A nr. 215).

178. Ndërkohë që Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Të Drejtat e Njeriut ka vërejtur që masat që derogojnë nga dispozitat e ICCPR-së duhet të jenë të “një natyre të jashtëzakonshme dhe të përkohshme” (shih paragrafin 109 lart), praktika gjyqësore e Gjykatës deri më sot nuk ka inkorporuar shprehimisht asnjëherë kërkesën që emergjenca të jetë e përkohshme, pavarësisht se çështja e proporcionaliteti të reagimit mund të lidhet me kohëzgjatjen e emergjencës. Në fakt, rastet e cituara më lart në

lidhje me situatën e sigurisë në Irlandën e Veriut tregojnë se është e mundur që një “emergjencë publike” brenda kuptimit të nenit 15 të vazhdojë për shumë vite. Gjykata nuk konsideron që masat deroguese të marra menjëherë pas sulmeve të al’Qaedës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe të rinovuara në baza vjetore nga Parlamenti, mund të thuhet se ishin të pavlefshme mbi bazën e faktit që nuk ishin “të përkohshme”.

179. Argumenti i kërkuesve që jeta e kombit nuk ishte e kërcënuar bazohet kryesisht mbi opinionin mospajtues të Lordit Hoffmann, i cili i interpretoi fjalët si të tilla që kërkonin ekzistencën e një kërcënimi ndaj jetës së organizuar të komunitetit i cili shkonte përtej kërcënimit për lëndim të rëndë fizik dhe humbje jete. Sipas mendimit të tij, ai duhet të kërcënonte “institucionet tona të qeverisë ose ekzistencën tonë si komunitet civil” (shih paragrafin 18 lart). Megjithatë, në çështje të mëparshme Gjykata ka qenë e përgatitur të merrte në konsideratë një gamë shumë më të gjerë faktorësh në përcaktimin e natyrës dhe shkallës së kërcënimit aktual ose të afërt ndaj “kombit” dhe në të kaluarën ka nxjerrë përfundime sipas të cilave situatat e emergjencës kanë ekzistuar edhe kur institucionet e Shtetit nuk është dukur se ishin të rrezikuara deri në shkallën që paramendon Lordi Hoffmann.

180. Siç është deklaruar më parë, autoritetet kombëtare gëzojnë një hapësirë të gjerë vlerësimi sipas nenit 15 për të cilësuar nëse jeta e kombit të tyre është nën kërcënim nga një emergjencë publike. Ndërkohë që të bën përshtypje fakti që Mbretëria e Bashkuar është i vetmi Shtet i Konventës që ka proceduar një derogim në reagim ndaj rrezikut nga al’Qaeda, megjithëse edhe Shtetet tjera ishin të ekspozuar ndaj rrezikut, Gjykata pranon që i takonte secilës Qeveri, si mbrojtëse e sigurisë së popullit të vet, të bënte vlerësimin e vet mbi bazën e fakteve të njohura për të. Prandaj, duhet t’i jepet pesha e duhur vendimit të ekzekutivit dhe Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar lidhur me këtë çështje. Përveç kësaj, peshë e konsiderueshme duhet t’i jepet edhe pikëpamjeve të gjykatave vendase, të cilat ishin në pozicion më të mirë për të vlerësuar provat lidhur me ekzistencën e emergjencës.

181. Lidhur me çështjen e parë, Gjykata ka të njëjtin mendim me shumicën e Dhomës së Lordëve që ekzistonte një emergjencë publike që kërcënonte jetën e kombit.

*Iii Nëse masat kanë qenë rreptësisht të kërkuara nga urgjenca e situatës*

182. Neni 15 parashikon që Shteti mund të marrë masa që derogojnë nga detyrimet e tij sipas Konventës vetëm “deri në atë masë sa ç’kërkohet rreptësisht nga urgjenca e situatës”. Siç është thënë më parë, Gjykata konsideron që ajo parimisht duhet të ndiqte vendimin e Dhomës së Lordëve lidhur me çështjen e proporcionaliteti të ndalimit të kërkuesve, përderisa nuk vërtetohet se gjykata kombëtare ka keqinterpretuar Konventën apo praktikën gjyqësore të Gjykatës ose ka arritur në një përfundim dukshëm të

paarsyeshëm. Ajo do të marrë në konsideratë kontestimet e Qeverisë ndaj vendimit të Dhomës së Lordëve në këto kushte.

183. Qeveria kundërshtoi fillimisht që shumica e Dhomës së Lordëve duhet t'i kishte lejuar një hapësirë më të madhe vlerësimi ekzekutivit dhe Parlamentit për të vendosur nëse ndalimi i kërkuesve ishte i nevojshëm. Një argument i ngjashëm u përdor para Dhomës së Lordëve, ku Prokurori i Përgjithshëm parashtrroi që vlerësimi i asaj që duhet të mbrohej ishte çështje e gjykimit politik e jo juridik (shih paragrafin 19 lart).

184. Kur Gjykata merr në konsideratë një derogim sipas nenit 15, ajo u lejon autoriteteve kombëtare një hapësirë të gjerë vlerësimi për të vendosur lidhur me natyrën dhe shkallën e masave të nevojshme të derogimit që duhen marrë për të shmangur emergjencën. Sidoqoftë, përfundimisht i takon Gjykatës që të vendosë nëse masat ishin “rreptësisht të nevojshme”. Në mënyrë të veçantë, aty ku një masë derogimi shkel mbi një të drejtë themelore të Konventës, siç është e drejta për liri, Gjykata duhet të jetë e bindur që ka qenë një reagim i mirëfilltë ndaj një situatë emergjence, dhe që ka qenë plotësisht i justifikuar nga rrethanat e veçanta të emergjencës dhe që ishte ofruar mbrojtja e duhur kundër abuzimit (shih, për shembull, *Brannigan dhe McBride*, cituar lart, §§ 48-66; *Aksoy*, cituar lart, §§ 71-84; dhe parimet e nënvizuara në paragrafin 173 lart). Doktrina e hapësirës së vlerësimit gjithmonë është menduar të shërbejë si mjet për përcaktimin e marrëdhënieve mes autoriteteve vendase dhe Gjykatës. Ajo nuk mund të ketë të njëjtin zbatim në marrëdhëniet mes organeve të Shtetit në nivel vendi. Siç u shpreh Dhoma e Lordëve, çështja e proporcionalitetit është përfundimisht vendim juridik, posaçërisht në një çështje si kjo ku kërkuesit janë privuar nga e drejta e tyre themelore për liri për një periudhë të gjatë. Sido që të jetë, duke pasur parasysh mënyrën e kujdesshme me të cilën Dhoma e Lordëve e ka proceduar këtë çështje, nuk mund të thuhet që nuk i është kushtuar rëndësia e duhur pikëpamjeve të ekzekutivit apo të Parlamentit.

185. Qeveria gjithashtu parashtrroi që Dhoma e Lordëve ka gabuar në shqyrtimin e legjislacionit të përmbledhur në vend që të shqyrtonte çështjet konkrete të kërkuesve. Megjithatë, sipas mendimit të Gjykatës, mënyra e shqyrtimit sipas nenit 15 domosdoshmërisht fokusohet tek situata e përgjithshme e vendit në fjalë, në kuptimin që gjykata – qoftë kombëtare apo ndërkombëtare – ka për detyrë të shqyrtojë masat që janë marrë në derogim të të drejtave të Konventës dhe t'i peshojë ato kundrejt natyrës së kërcënimit ndaj kombit që paraqet emergjenca. Aty ku, si në rastin konkret, masat gjendet se janë jo-proporcionale me kërcënimin dhe me pasoja diskriminuese, nuk ka nevojë të shkohet më tej e të shqyrtohet kërkesa në çështjen konkrete të secilit kërkues.

186. Baza e tretë e kontestimit të Qeverisë për vendimin e Dhomës së Lordëve drejtohej kryesisht ndaj mënyrës në të cilën është bërë krahasimi mes të dyshuarve terroristë shtetas dhe atyre jo-shtetas. Megjithatë, Gjykata

konsideroi që Dhoma e Lordëve kishte të drejtë në lidhje me faktin që pushtetet e kontestuara nuk duhet të konsideroheshin si mesa imigracioni, aty ku dallimi mes shtetasve dhe jo-shtetasve do të ishte legjitim, por duhet të shiheshin si masa që kishin të bënin me sigurinë kombëtare. Pjesa 4 e Ligjit të vitit 2001 u hartua për të shmangur një kërcënim real dhe të afërt të një sulmi terrorist i cili, sipas provave, mund të vinte si nga shtetasit ashtu edhe nga jo-shtetasit. Zgjedhja nga Qeveria dhe Parlamenti e një mase imigracioni për të zgjidhur atë që në thelb ishte çështje sigurie rezultoi me dështimin e zgjidhjes së problemit në mënyrën e përshtatshme, ndërkohë që vendosi peshën jo-proporcionale dhe diskriminuese të ndalimit për një kohë të pacaktuar mbi një grup terroristësh të dyshuar. Siç gjeti Dhoma e Lordëve, nuk kishte ndonjë dallim domethënës mes pasojave potencialisht të pafavorshme të ndalimit pa akuza ndaj një shtetasi dhe ato ndaj një jo-shtetasi i cili në praktikë nuk mund të largohet nga vendi për shkak të frikës së torturës jashtë vendit.

187. Së fundi, Qeveria paraqiti dy argumente mbi të cilat kërkuesit pretenduan se gjykatat vendase nuk ishin mbështetur më përpara. Sigurisht, ato nuk duket të jenë përmendur në ndonjë vendim të gjykatave vendase ose në materialet e hapura të cilat i janë paraqitur Gjykatës. Në këto rrethana, edhe nëse presupozohet që parimi i subsidiaritetit nuk e ndalon Gjykatën nga shqyrtimi i bazave të reja, do të kërkoheshin prova shumë bindëse në mbështetje të tyre.

188. I pari i argumenteve kinse të reja ishte që një Shtet kishte të drejtën legjitime, gjatë përkufizimit të masave për jo-shtetasit, që të merrte parasysh ndjeshmëritë e popullsisë britanike myslimane në mënyrë që të zvogëlonte shanset e rekrutimit të ekstremistëve nga radhët e tyre. Megjithatë, Qeveria nuk kishte paraqitur para Gjykatës ndonjë provë që sugjeronte se myslimanët britanikë kishin më shumë gjasa që të reagonin negativisht ndaj burgimit pa akuza të myslimanëve shtetas sesa myslimanëve të huaj për të cilët kishte arsye të dyshohej se kishin lidhje me al'Qaedën. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se sistemi i urdhrave të kontrollit, i ngritur nga Ligji i Parandalimit të Terrorizmit i vitit 2005, nuk diskriminon mes të dyshuarve shtetas dhe atyre jo-shtetas.

189. Baza e dytë kinse e re mbi të cilën u mbështet Qeveria ishte se Shteti mund t'i përgjigjej më mirë kërcënimit terrorist nëse do të arrinte të ndalonte burimin më serioz të terrorizmit, më saktë jo-shtetasit. Në këtë pikë, përsëri Gjykatës nuk i është paraqitur ndonjë provë që mund ta bindte atë që ta përmbyste përfundimin e Dhomës së Lordëve që dallimi në trajtim ishte i pajustificuar. Në fakt, Gjykata shënon që gjykatat vendase, përfshirë SIAC, i cili kishte parë si provat e hapura ashtu edhe ato të mbyllura, nuk ishin bindur që kërcënimi nga jo-shtetasit ishte më serioz sesa kërcënimi nga shtetasit.

190. Si përfundim, Gjykata, ashtu si Dhoma e Lordëve, dhe në kundërshtim me diskursin e Qeverisë, gjen që masat e derogimit nuk ishin

në proporcion meqenëse diskriminonin në mënyrë të pajustificueshme mes shtetasve dhe jo-shtetasve. Rrjedh që ka pasur shkelje të nenit 5 § 1 në rastin e kërkuarit të parë, tretë, pestë, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë, dhjetë dhe njëmbëdhjetë.

### III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 5 § 1 I MARRË NË LIDHJE ME NENIN 14 TË KONVENTËS

191. Kërkuarit u ankuan që ishte diskriminuese dhe në shkelje të nenit 14 të Konventës që ata të ndaloheshin ndërkohë që shtetasit e Mbretërisë së Bashkuar të dyshuar për përfshirje me al'Qaedën ishin lënë të lirë.

Neni 14 parashikon:

“Gëzimi i të drejtave dhe lirive të parashikuara në [Konventë] sigurohet pa diskriminim në baza të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, mendimit politik apo tjetër, prejardhjes kombëtare apo shoqërore, asociimit me një pakicë kombëtare, pasurisë, lindjes apo statusi tjetër.”

192. Duke pasur parasysh arsyetimin dhe përfundimin e mësipërm në lidhje me nenin 5 § 1, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme t'i shqyrtojë këto ankesa ndaras.

### IV. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 5 § 4 TË KONVENTËS

193. Kërkuarit u ankuan që procedura para gjykatave vendore për kontestimin e burgimit të tyre nuk ishte në pajtim me kërkesat e nenit 5 § 4, i cili thotë:

“Secili person që privohet nga liria e tij me anë të arrestimit apo ndalimit ka të drejtën të kalojë në procedura ku ligjshmëria e ndalimit të tij do të vendoset me shpejtësi nga një gjykatë dhe urdhri për lirim të tij do të jepet menjëherë nëse ndalimi nuk është i ligjshëm.”

Qeveria mohoi që kishe pasur shkelje të nenit 5 § 4.

#### A. Parashitjet e palëve

##### 1. Kërkuarit

194. Kërkuarit paraqitën dy argumente kryesore sipas nenit 5 § 4. Së pari, theksuan që, megjithëse e kishin mundësinë të argumentonin para SIAC-it, Gjykatës së Apelit dhe Dhomës së Lordëve që ndalimi i tyre sipas Pjesës 4 të Ligjit të vitit 2001 ishte i paligjshëm sipas Konventës, i vetmi mjet që ata arritën të kenë ishte një deklaratë mospërputhshmërie sipas Ligjit të vitit 1998. Kjo nuk kishte efekt detyrues mbi Qeverinë dhe ndalimi mbeti i ligjshëm deri sa ndryshimi legjislativ u miratua nga Parlamenti.

Kështu, nuk kishte asnjë gjykatë që kishte pushtetin të urdhëronte lirimin e tyre, në shkelje të nenit 5 § 4.

195. Së dyti, kërkuesit u ankuan lidhur me procedurën para SIAC-it për apelet sipas seksionit 25 të Ligjit të vitit 2001 (shih paragrafin 91 lart) dhe në mënyrë të veçantë mungesa e zbulimit të provave materiale, përveç avokatëve të posaçëm me të cilët të ndaluarit nuk ishin të lejuar të konsultoheshin. Në parashtrësën e tyre, neni 5 § 4 importonte garancitë e gjyqit të drejtë të nenit 6 § 1 barabar me peshën e çështjes në fjalë. Ndërkohë që, në rrethana të caktuara, një gjykatë mund t'i lejohet sanksionimi i mos-zbulimit të provave relevante para një individi mbi bazën e sigurisë kombëtare, asnjëherë nuk mund të ishte e lejueshme për një gjykatë që në vlerësimin e ligjshmërisë së ndalimit të mbështetej në materiale të tilla që kishin të bënin në mënyrë vendimtare me argumentet kundër të ndaluarit dhe aty ku nuk ishte zbuluar, qoftë edhe vetëm thelbi ose përmbledhja, mjaftueshëm sa për t'i mundësuar individit që ta dinte se çfarë argumentesh kishte kundër tij dhe të reagoonte ndaj tyre. Në të gjitha ankesat e kërkuesve, përveç kërkuesit të dhjetë, SIAC u mbështet mbi materialet e mbyllura dhe njohu faktin që kërkuesit ishin në pozicion të pafavorshëm.

## 2. Qeveria

196. Qeveria argumentoi që neni 5 § 4 duhet të lexohet nën prizmin e praktikës gjyqësore të Gjykatës sipas nenit 13, për të cilin ishte *lex specialis* për sa i përket burgimit, që nuk ekzistonte e drejta për të kontestuar legjislacionin thelbësor të detyrueshëm para një gjykatë kombëtare. Ky parim, së bashku me sistemin e deklaratave të papërputhshmërisë nga Ligji i të Drejtave të Njeriut, pasqyrore vlerën demokratike të epërsisë së Parlamentit të zgjedhur.

197. Në lidhje me pikën e dytë të kërkuesve, Qeveria parashtrroi që ekzistonin baza të vlefshme të interesit publik për mbajtjen të fshehtë të materialit të mbyllur. E drejta për zbulimin e provave, sipas nenit 6 dhe gjithashtu sipas nenit 5 § 4, nuk ishte absolute. Praktika gjyqësore e Gjykatës nga çështja *Chahal* (cituar lart) e më tej ka shprehur njëfarë përkrahje për një procedurë të avokatëve të posaçëm në fushat me ndjeshmëri të veçantë. Për më tepër, në rastin e secilit kërkues, materiali i hapur ka ofruar informacion të mjaftueshëm për argumentet kundër secilit kërkues duke i mundësuar secilit prej tyre të ndërtonte një mbrojtje efektive.

## 3. Pala e tretë, Justice

198. Justice (shih paragrafin 6 lart) e informoi Gjykatën që në kohën kur SIAC u krijua nga Ligji i Komisionit të Posaçëm të Apelit për Imigracion i vitit 1997, përdorimi i materialit të mbyllur dhe avokatëve të posaçëm në procedura përpara se të besohej se bazohej mbi një procedurë të ngjashme në Kanada, zbatohet në çështjet që dilnin para Komisionit të Shqyrtimit të

Inteligjencës së Sigurisë (angl. "SIRC"), i cili shqyrtonte nëse vendimi i një Ministri për zhvendosjen e një shtetasi të huaj rezident i përhershëm mbi bazën e sigurisë kombëtare ishte i bazuar. Megjithatë, edhe pse procedura e SIRC përfshinte pjesëmarrjen e një këshilltari të brendshëm me qasje ndaj materialeve konfidenciale në seancat dëgjimore *ex parte* dhe *in camera* për të përfaqësuar interesat e kërkuësve, ajo ndryshonte thelbësisht nga modeli i SIAC-it, posaçërisht në faktin që lejonte që avokati i posaçëm të mbante kontakte me kërkuësin dhe avokatët e tij gjatë gjithë procesit dhe edhe pasi që avokati i posaçëm ishte informuar plotësisht në lidhje me informatat sekrete kundër kërkuësit.

199. Përkundrazi, procedurat e SIAC-it kishin të bënin me materialet e mbyllura dhe ndaj avokatëve të posaçëm kishte pasur kritika të shumta, edhe nga Komisioni i Apeleve i Dhomës së Lordëve, nga Komisioni për Çështje Kushtetuese i Dhomës së Komuneve, nga Komisioni i Përbashkët Parlamentar për Të Drejtat e Njeriut, nga Ligji i Komisionit të Senatit Kanadez për Kundër-Terrorizmin, dhe nga Komisioneri i Këshillit të Europës për Të Drejtat e Njeriut. Pas vendimit të Dhomës së Lordëve në dhjetor 2004, që deklaronte Pjesën 4 të Ligjit të vitit 2001 të papërputhshëm me nenet 5 dhe 14 të Konventës, Komisioni për Çështje Kushtetuese i Dhomës së Komuneve filloi hetimet mbi veprimet e SIAC-it dhe përdorimin nga ai të avokatëve të posaçëm. Mes provave të marra nga Komisioni ishte edhe parashtrësia nga nëntë prej trembëdhjetë avokatëve të posaçëm. Në parashtrësë, avokatët e posaçëm theksonin vështirësitë serioze që kishin hasur në përfaqësimin e kërkuësve në procedura të mbyllura për shkak të ndalimit të komunikimit lidhur me materialet e mbyllura. Në mënyrë të veçantë, avokatët e posaçëm nënvizuan rolin shumë të limituar që kishin mundësi të luanin në seancat e mbyllura duke marrë parasysh mungesën e udhëzimeve efektive nga ata që përfaqësonin.

## **B. Vlerësimi i Gjykatës**

### *1. Pranueshmëria*

200. Gjykata shënon që neni 5 § 4 garanton të drejtën e "secilit që privohet nga liria përmes arrestimit ose ndalimit" për të filluar procedura për provimin e ligjshmërisë së ndalimit dhe për të fituar lirimin nëse ndalimi gjendej të ishte i paligjshëm. Meqenëse kërkuësi i dytë dhe i katërt tashmë ishin të lirë, meqenëse kishin zgjedhur të udhëtonin për në Marok dhe Francë respektivisht, në kohën kur filluan procedurat e ndryshme për përcaktimin e ligjshmërisë së ndalimit sipas Ligjit të vitit 2001, rrjedh që ankesat e këtyre dy kërkuësve sipas neni 5 § 4 janë dukshëm të pabazuara brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës (shih *Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i datës 30 gusht 1990, § 45, Seria A nr. 182) dhe duhet të deklarohen të papranueshme.

201. Gjykata konsideron që ankesat e kërkuësve të tjerë sipas kësaj dispozite ngrenë çështje komplekse ligji dhe faktesh, përcaktimi i të cilave do të duhej të varej nga shqyrtimi i themeleve të çështjes. Prandaj, ajo del me përfundimin që kjo pjesë e kërkesës nuk është dukshëm e pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Nuk është ngritur asnjë bazë tjetër papranueshmërie dhe ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

## 2. Themelet

### a. Parimet që dalin nga praktika e mëparshme gjyqësore

202. Neni 5 § 4 parashikon një *lex specialis* në lidhje me kërkesat më të përgjithshme të nenit 13 (shih *Chahal*, cituar lart, § 126). Ai i lejon një të arrestuari ose të ndaluar të fillojë procedura gjyqësore mbi bazën e rrethanave procedurale dhe substantive të cilat janë thelbësore për “ligjshmërinë” e ndalimit të tij/saj nga liria. Nocioni i “ligjshmërisë” sipas paragrafit 4 të nenit 5 ka të njëjtin kuptim si në paragrafin 1, kështu që i arrestuari apo i ndaluar ka të drejtën e shqyrtimit të “ligjshmërisë” së ndalimit të tij nën dritën e jo vetëm kërkesave të ligjit vendas, por edhe të Konventës, parimeve të përgjithshme të mishëruara aty dhe qëllimit të kufizimeve të lejuara nga neni 5 § 1. Neni 5 § 4 nuk garanton një të drejtë për shqyrtim gjyqësor të një fushëveprimi të tillë që ta fuqizojë gjykatën, në të gjitha aspektet e çështjes përfshirë edhe çështjet e përshtatshmërisë, për të zëvendësuar maturinë e vet me atë të autoritetit vendimmarrës. Megjithatë, shqyrtimi duhet të jetë aq i gjerë sa të përfshijë ato rrethana të cilat janë thelbësore për ndalimin “e ligjshëm” të një personi sipas nenit 5 § 1 (*E. Kundër Norvegjisë*, vendimi i datës 29 gusht 1990, § 50, Seria A nr. 181). “Gjykata” shqyrtuese nuk duhet të ketë vetëm funksione këshilluese por edhe kompetencën për të “vendosur” mbi “ligjshmërinë” e ndalimit dhe për të urdhëruar lirim nëse ndalimi është i paligjshëm (*Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar lart, § 200; *Weeks kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i datës 2 mars 1987, § 61, Seria A nr. 114; *Chahal*, cituar lart, § 130).

203. Kërkesat për drejtësi procedurale sipas nenit 5 § 4 nuk imponojnë një standard uniform të pandryshueshëm për t’u zbatuar pavarësisht nga konteksti, faktet dhe rrethanat. Megjithëse nuk është gjithmonë e nevojshme që një procedurë e nenit 5 § 4 të ndiqet nga të njëjtat garanci si ato të kërkuara nga neni 6 për çështje gjyqësore penale ose civile, ajo duhet të ketë karakter gjyqësor dhe të paraqesë garanci të përshtatshme për llojin e privimit të lirisë për të cilin bëhet fjalë (shih, për shembull, *Winterwerp kundër Hollandës*, vendimi i datës 24 tetor 1979, § 57, Seria A nr. 33; *Bouamar kundër Belgjikës*, vendimi i datës 29 shkurt 1988, §§ 57 dhe 60, Seria A nr. 129; *Włoch kundër Polonisë*, nr. 27785/95, § 125, KEDNJ 2000-XI; *Reinprecht kundër Austrisë*, nr. 67175/01, § 31, KEDNJ 2005).



204. Kështu, procedurat duhet të jenë të bazuara mbi parimin e kontradiktoritetit dhe duhet të sigurojnë gjithmonë “barazinë e mjeteve” mes palëve (*Reinprecht*, § 31). Mund të jetë e nevojshme një seancë dëgjimore verbale, për shembull në rastet e paraburgimit (*Nikolova kundër Bullgarisë* [GC], nr. 31195/96, § 58, KEDNJ 1999-II). Për më tepër, në rastet e paraburgimit, për shkak se vazhdueshmëria e një dyshimi të arsyeshëm që i akuzuari ka kryer një vepër penale është kusht *sine qua non* për ligjshmërinë e ndalimit të vazhduar, të ndaluarit duhet t’i jepet mundësia për të kontestuar në mënyrë efektive bazat e akuzave kundër tij (*Becciev kundër Moldavisë*, nr. 9190/03, §§ 68-72, 4 tetor 2005). Kjo mund të kërkojë që gjykata të dëgjojë dëshmitarë dëshmia e të cilëve duket *prima facie* të ketë ndikim material mbi ligjshmërinë e vazhduar të ndalimit (*Becciev*, cituar lart, §§ 72-76; *Turcan dhe Turcan kundër Moldavisë*, nr. 39835/05, §§ 67-70, 23 tetor 2007). Gjithashtu, mund të kërkojë edhe që të ndaluarit ose përfaqësuesit të tij t’u lejohet qasje në dokumentet e dosjes të cilat formojnë bazën e aktakuzës kundër tij (*Wloch*, cituar lart, § 127; *Nikolova*, cituar lart, § 58; *Lamy kundër Belgjikës*, vendimi i datës 30 March 1989, § 29, Seria A nr. 151; *Fodale kundër Italisë*, nr. 70148/01, 1 qershor 2006).

205. Megjithatë, Gjykata është shprehur që, edhe në procedura sipas nenit 6 lidhur me përcaktimin e fajësisë për akuza penale, mund të ketë kufizime mbi të drejtën e një procedure të plotë ndërgjyqëse aty ku është rreptësisht e domosdoshme duke marrë parasysh interesin e fortë kundërveprues publik, siç është siguria kombëtare, nevojën për të mbajtur sekrete metoda të caktuara hetimore të policisë, ose mbrojtjen e të drejtave themelore të një tjetri. Megjithatë, nuk mund të ketë gjyq të drejtë nëse vështirësitë që i shkaktohen të pandehurit nga kufizimi mbi të drejtat e tij baraspeshohet mjaftueshëm nga procedurat e ndjekura nga autoritetet gjyqësore (shih, për shembull, *Doorson kundër Holandës*, vendimi i datës 26 mars 1996, § 70, *Përmbledhjet* 1996-II; *Van Mechelen dhe të Tjerë kundër Holandës*, vendimi i datës 23 prill 1997, § 58, *Përmbledhjet* 1997-III; *Jasper kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], nr. 27052/95, §§ 51-53, KEDNJ 2000-II; *S.N. kundër Suedisë*, nr. 34209/96, § 47, KEDNJ 2002-V; *Botmeh dhe Alami kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 15187/03, vendimi i datës 7 qershor 2007, § 37).

206. Kështu, ndërkohë që e drejta për procedura gjyqësore të drejta penale sipas nenit 6 përfshin të drejtën e zbulimit të të gjitha provave materiale në posedim të palës së akuzës, si pro të akuzuarit ashtu edhe kundër tij, Gjykata është shprehur që nganjëherë mund të lindë nevoja për të mbajtur të fshehta nga pala mbrojtëse prova të caktuara mbi mbi bazën e interesit publik. Në çështjen *Jasper*, cituar lart, §§ 51-53, ajo gjeti që kufizimet mbi të drejtat e mbrojtjes ishin baraspeshuar mjaftueshëm aty ku provat të cilat ishin relevante për çështjen, por mbi të cilat pala e akuzës nuk kishte qëllim të mbështetej, ishin shqyrtuar *ex parte* nga gjyqtari i gjyqit, i

cili kishte vendosur që ato nuk duhet të zbulohen sepse interesi publik i mbajtjes së tyre të fshehta ishte më i madh sesa dobia që do të kishte mbrojtja në rast zbulimi të tyre. Duke gjetur që kishte pasur shkelje të nenit 6, Gjykata e konsideroi domethënëse që ishte gjyqtari i gjyqit, me dijeni të plotë të çështjeve të gjyqit, ai që kishte bërë baraspeshimin dhe që ishin ndërmarrë hapa për t'u siguruar që mbrojtja të mbahej e informuar dhe të lejohej të bënte parashtrësia dhe të merrte pjesë në proceset vendimmarrëse për aq sa ishte e mundur pa zbuluar materialet të cilat pala e akuzës synonte t'i mbante të fshehta (ibid., §§ 55-56). Përkundrazi, në çështjen *Edwards dhe Lewis kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], nr. 39647/98 dhe 40461/98, §§ 46-48, KEDNJ 2004-X, Gjykata gjeti që një procedurë *ex parte* para gjyqtarit të gjyqit nuk ishte e mjaftueshme për të siguruar një gjyq të drejtë aty ku materialet e fshehta ishin të lidhura, ose mund të ishin të lidhura, me një çështje ose fakt që formonte një pjesë të argumenteve të palës së akuzës, të cilën gjyqtari i gjyqit, dhe jo juria, duhet ta përcaktonte dhe e cila mund ishte e një rëndësie vendimtare për rezultatin e gjyqeve të kërkuarve.

207. Në disa prej çështjeve të tjera ku interesat garuese publike përfshinin kufizime mbi të drejtat e kërkuarve në lidhje me provat ndërgjyqëse, mbi të cilat ishte mbështetur prokurori, Gjykata ka vlerësuar shkallën deri ku masat baraspeshuese mund të zgjidhin çështjen e mungesës së një procedure të plotë ndërgjyqëse. Për shembull, në çështjen *Lucà kundër Italisë*, nr. 33354/96, § 40, KEDNJ 2001-II, ajo u shpreh që nuk do të ishte domosdoshmërisht në shpërputhje me nenin 6 § 1 nëse pala e akuzës i referohej në gjyq dëshmitarëve të dhëna në fazën e hetimeve, në mënyrë të veçantë ku një dëshmitar kishte refuzuar ta përsëriste dëshminë e tij në publik nga frika e sigurisë së tij, nëse të pandehurit i ishte dhënë mundësia e duhur dhe e përshtatshme për të kontestuar dëshmitë, qoftë në momentin e dhënies së tyre apo në një fazë të mëvonshme. Megjithatë, ajo theksoi që, aty ku dënimi bazohej vetëm ose deri në një masë vendimtare mbi dëshmitë që ishin dhënë nga një person të cilin i akuzuari nuk ka pasur mundësi ta merrte në pyetje apo ta kishte marrë në pyetje, qoftë gjatë hetimeve, qoftë në gjyq, të drejtat e palës mbrojtëse do të ishin kufizuar deri në një masë e cila nuk do të ishte në përputhje me garancitë e ofruara nga neni 6.

208. Në mënyrë të ngjashme, në çështjen *Dorson*, cituar lart, §§ 68-76, Gjykata gjeti që nuk kishte shkelje të nenit 6 aty ku identiteti i disa dëshmitarëve të caktuar ishte mbajtur i fshehtë nga i pandehuri, mbi bazën e faktit që ata i frikësoheshin ndëshkimit. Fakti që avokati mbrojtës, në mungesë të të pandehurit, kishte mundësi t'i bënte pyetje dëshmitarëve anonimë në fazën e apelit dhe të përpiqej të hidhte dyshime mbi besueshmërinë e dëshmitarëve të tyre dhe që Gjykata e Apelit deklaroi në vendimin e saj që ajo i kishte trajtuar provat e dëshmitarëve anonimë me kujdes ishte i mjaftueshëm për të baraspeshuar disavantazhin e shkaktuar për palën e mbrojtjes. Gjykata theksoi se dënimi nuk duhet të bazohet vetëm

mbi ose në masë vendimtare mbi deklaratat anonime (dhe shih gjithashtu *Van Mechelen*, cituar lart, § 55). Në secilin rast, Gjykata theksoi se roli i saj ishte të siguronte që procedurat në tërësi, përfshirë edhe mënyrën se si ishin marrë provat, ishin të drejta (*Doorson*, cituar lart, § 67).

209. Gjykata i është referuar në disa raste mundësisë së përdorimit të avokatëve të posaçëm për të baraspeshuar padrejtësinë procedurale të shkaktuar nga mungesa e zbulimit të plotë në rastet e sigurisë kombëtare, por nuk është kërkuar kurrë të vendoset nëse një procedurë e tillë do të ishte në përputhje me qoftë nenin 5 § 4 ose nenin 6 të Konventës.

210. Në çështjen *Chahal*, cituar lart, kërkuesi ishte ndaluar sipas nenit 5 § 1(f) në pritje të dëbimit mbi bazat e sigurisë kombëtare dhe Sekretari i Shtetit i kundërshtoi kërkesat e tij për dorëzani dhe *habeas corpus*, gjithashtu për arsye të sigurisë kombëtare. Gjykata njohu (§§ 130-131) që përdorimi i materialeve konfidenciale mund të ishte i pashmangshëm aty ku bëhej fjalë për sigurinë kombëtare por u shpreh se kjo nuk do të thoshte që ekzekutivi mund të lirohej prej kontrollit efektiv nga gjykatat vendase kurdo që ato vendosnin të konstatojnë që bëhej fjalë për siguri kombëtare dhe terrorizëm. Gjykata gjeti një shkelje të nenit 5 § 4 duke marrë parasysh faktin që Gjykata e Lartë, e cila përcaktoi kërkesën e *habeas corpus*, nuk kishte qasje ndaj materialit të plotë mbi të cilin Sekretari i Shtetit kishte mbështetur vendimin e tij. Megjithë mbrojtjen e një paneli këshillues, të kryesuar nga një gjyqtar i Gjykatës së Apelit, i cili kishte qasje të plotë në provat e sigurisë kombëtare, Gjykata u shpreh se paneli nuk mund të konsiderohej si “gjykatë” brenda kuptimit të nenit 5 § 4 sepse kërkuesi nuk gëzonte të drejtën e përfaqësimit ligjor para saj dhe i ishte dhënë vetëm një përmbledhje e argumenteve nga akuzat e çështjes së sigurisë kombëtare kundër tij dhe sepse paneli nuk kishte fuqinë për të marrë vendime dhe këshillat e tij për Sekretarin e Punëve të Brendshme (Home Secretary) nuk ishin të detyrueshme dhe nuk zbuloheshin. Gjykata iu referua (§§ 131 dhe 144) parashtrësive të palëve të treta (Amnesty International, Liberty, Qendra AIRE dhe Këshilli i Përbashkët për Mirëqenien e Imigrantëve; dhe shih parashtrësit e Justice për çështjen në fjalë, paragrafi 198 lart) në lidhje me një procedurë të kërkuar në rastet e dëbimeve të sigurisë kombëtare në Kanada, ku gjyqtari kishte mbajtur një seancë *in camera* të të gjitha provave, në të cilën ishte të propozuarit për dëbim ishte dhënë një deklaratë përmbledhëse, aq sa ishte e mundur, të argumenteve të akuzës kundër tij, dhe ai kishte pasur të drejtën të përfaqësohej dhe të paraqiste prova. Konfidencialiteti i materialit të sigurisë u ruajt duke kërkuar që këto prova të shqyrtoheshin në mungesë të të dëbuarit dhe të përfaqësuesit të tij. Megjithatë, në këto rrethana, në vend të tyre mori pjesë një këshilltar me licencë të lartë sigurie i udhëzuar nga gjykata, i cili mori në pyetje dëshmitarët dhe përgjithësisht e ndihmoi gjykatën të testonte fuqinë e argumenteve të Shtetit. Të dëbuarit iu dha një përmbledhje e provave të

mbledhura nga kjo procedurë, nga e cila ishin hequr pjesët e nevojshme. Gjykata komentoj që ajo:

“i jep rëndësi faktit që, siç theksuan ndërhyrësit në lidhje me nenin 13, ... në Kanada është zhvilluar një formë më efektive kontrolli gjyqësor në rastet e kësaj natyre. Shembulli ilustron që ka teknika që mund të shfrytëzohen të cilat edhe adresojnë shqetësimet legjitime për sigurinë kombëtare lidhur me natyrën dhe burimet e informacionit të inteligjencës, edhe ofrojnë masën individuale substanciale të drejtësisë procedurale.”

211. Në *Tinnelly & Bijtë Shpk dhe Të Tjerë dhe McElduff dhe Të Tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i datës 10 korrik 1998, § 78, *Përmbledhjet 1998-IV* and në çështjen *Al-Nashif kundër Bullgarisë*, nr. 50963/99, vendimi i datës 20 qershor 2002, §§ 93-97 dhe 137, Gjykata iu referua komenteve të saj në çështjen *Chahal* lidhur me procedurën e avokatit të posaçëm por pa shprehur ndonjë opinion lidhur me faktin nëse një procedurë e tillë do të ishte në përputhje me të drejtat e Konventës për të cilat bëhet fjalë.

#### **b. Kërkesat në lidhje me faktet në rastin konkret**

212. Para gjykatave vendase, ekzistonin dy aspekte të kontestit të kërkuësve ndaj ligjshmërisë së ndalimit të tyre. Së pari, ata filluan procedura sipas seksionit 30 të Ligjit të vitit 2001 për të kontestuar vlefshmërinë e derogimit sipas nenit 15 të Konventës e kështu përputhshmërinë me Konventën të tërë skemës së ndalimit. Së dyti, secili kërkuës po ashtu paraqiti një apel sipas seksionit 25 të Ligjit të vitit 2005, duke argumentuar që ndalimi ishte i paligjshëm sipas ligjit vendas sepse nuk ekzistonin baza të arsyeshme për besimin se prania e tij në Mbretërinë e Bashkuar paraqiste rrezik për sigurinë kombëtare apo për dyshimin që ai ishte terrorist.

213. Gjykata nuk e konsideron të nevojshme të arrihet një gjetje e ndarë sipas nenit 5 § 4 në lidhje me ankesat e kërkuësve që Dhoma e Lordëve nuk kishte mundur të lëshonte një urdhër detyrues për lirim të tyre, meqenëse ajo tashmë kishte gjetur një shkelje të nenit 5 § 1 duke u nisur nga dispozitat e ligjit vendas.

214. Baza e dytë e kërkuësve për ankesë sipas nenit 5 § 4 ka të bëjë me drejtësinë e procedurës para SIAC-it sipas seksionit 25 të Ligjit të vitit 2001 për të përcaktuar nëse Sekretari i Shtetit është treguar i arsyeshëm kur ka besuar se prania e secilit kërkuës në Mbretërinë e Bashkuar përbënte rrezik për sigurinë kombëtare dhe kur ka dyshuar secilin prej tyre si terrorist. Kjo është çështje e ndarë dhe e dalluar, e cila nuk mund të thuhet se përfshihet nga gjetja e një shkeljeje të nenit 5 § 1, dhe të cilën Gjykata duhet pra ta shqyrtojë.

215. Gjykata kujton se, megjithëse gjyqtarët që ishin pjesë e SIAC-it arritën të shqyrtonin edhe materialin “e hapur”, edhe materialin “e mbyllur”, as kërkuësit e as këshilltarët e tyre ligjorë nuk mundën t’i shihnin materialet

e mbyllura. Materialet e mbyllura iu zbuluan vetëm një ose disa avokatëve të posaçëm, të caktuar nga Krye-avokati i Përgjithshëm për të vepruar në emër të secilit prej kërkuesve. Gjatë seancave të mbyllura para SIAC-it, avokati i posaçëm kishte mundësinë të bënte parashtrësia në emër të kërkuesit, si në lidhje me çështjet procedurale, siç ishte nevoja për zbulimin e mëtejshëm të materialeve, ashtu edhe në lidhje me substancën e çështjes. Megjithatë, nga momenti kur avokati i posaçëm për herë të parë e pa materialin e mbyllur, ai nuk u lejua më të kishte kontakte me kërkuesin dhe përfaqësuesin e tij, përveç se me leje nga SIAC. Në lidhje me secilin apel kundër certifikimit, SIAC lëshoi një vendim të hapur dhe një vendim të mbyllur.

216. Gjykata merr si pikënisje faktin që, siç kanë gjetur gjykatat vendase dhe ajo ka pranuar, gjatë periudhës së ndalimit të kërkuesve aktivitetet dhe qëllimet e rrjetit të al'Qaedës kanë shkaktuar një "emergjencë publike që kërcënonte jetën e kombit". Prandaj, duhet pasur parasysh që në kohën relevante u konsiderua nevojë emergjente mbrojtja e popullsisë në Mbretërinë e Bashkuar nga sulmi terrorist dhe, megjithëse Mbretëria e Bashkuar nuk derogoi nga neni 5 § 4, dhe pati interes të gjerë publik mbledhja e informacioneve lidhur me al'Qaedën dhe bashkëpunëtorët e saj si dhe mbajtja e fshehtësisë së burimeve të këtyre informacioneve (shih gjithashtu, në lidhje me këtë, *Fox, Campbell dhe Hartley*, cituar lart, § 39).

217. Megjithatë, krahas këtyre interesave të rëndësishme publike, ishte edhe e drejta e kërkuesve nga neni 5 § 4 për drejtësi procedurale. Megjithëse Gjykata ka gjetur që, me përjashtim të kërkuesit të dytë dhe të katërt, ndalimi i kërkuesve nuk hynte tek asnjëra nga kategoritë e parashikuara nga nën-paragrafët (a) deri në (f) të nenit 5 § 1, ajo konsideron që praktika gjyqësore lidhur me kontrollin gjyqësor mbi paraburgimin është relevante, meqenëse në raste të tilla edhe arsyeshmëria e dyshimit kundër të ndaluarit është *sine qua non* (shih paragrafin 204 lart). më tej, në rrethanat e rastit konkret, dhe duke pasur parasysh ndikimin dramatik të privimit të gjatë – dhe në atë kohë në dukje i pacaktuar – nga liria të kërkuesve mbi të drejtat e tyre themelore, neni 5 § 4 duhet të parashtrrojë në thelb të njëjtat garanci për gjykim të drejtë si edhe neni 6 § 1 në aspektin e tij penal (*Garcia Alva kundër Gjermanisë*, nr. 23541/94, § 39, 13 shkurt 2001 dhe shih gjithashtu *Chahal*, cituar lart, §§ 130-131).

218. Në këto rrethana, ishte thelbësore që të zbuloheshin sa më shumë informata që të ishte e mundur lidhur me akuzat dhe provat kundër secilit kërkues pa komprometuar sigurinë kombëtare apo sigurinë e të tjerëve. Aty ku zbulimi i plotë nuk ishte i mundur, neni 5 §4 kërkonte që vështirësitë që shkaktonte kjo të baraspeshoheshin në mënyrë të atillë që secili kërkues të vazhdonte ta kishte mundësinë e kontestimit efektiv të akuzave kundër tij.

219. Gjykata konsideron që SIAC, i cili ishte një gjykatë plotësisht e pavarur (shih paragrafin 91 lart) dhe i cili mund të shqyrtonte të gjitha provat relevante, si të mbyllura ashtu edhe të hapura, ishte në pozicionin më

të mirë për t'u siguruar që asnjë material të mos fshihej pa nevojë nga të ndaluarit. Në lidhje me këtë, avokati i posaçëm mund të ofronte një mbrojtje të rëndësishme, shtesë, përmes marrjes në pyetje të dëshmitarëve të Shtetit lidhur me nevojën për fshehtësi dhe përmes bërjes së parashtresave para gjyqtarit lidhur me zbulimin e mëtejshëm. Në lidhje me materialin që ka përpara, Gjykata nuk ka baza për të gjetur se është përdorur fshehtësi e tepruar dhe e pajustificuar në lidhje me secilin prej apeleve të kërkuesve apo që nuk ka pasur arsye bindëse për mungesën e zbulimit në secilin rast.

220. Më tej, Gjykata konsideron që avokati i posaçëm mund të luante një rol të rëndësishëm në baraspeshimin e mungesës së zbulimit të plotë dhe mungesës së një seance të plotë të hapur ndërgjygjëse duke testuar provat dhe duke paraqitur argumente në emër të kërkuesit gjatë seancave të mbyllura. Megjithatë, avokati i posaçëm nuk mund ta kryente këtë funksion në ndonjë mënyrë të dobishme nëse i ndaluarit nuk i jepej informacion i mjaftueshëm lidhur me akuzat kundër tij për t'i mundësuar atij dhënien e udhëzimeve efektive avokatit të posaçëm. Ndërkohë që kjo çështje duhet vendosur sipas secilës çështje, Gjykata vëzhgon në përgjithësi që, aty ku provat ishin zbuluar në masë të madhe dhe materiali i hapur kishte luajtur rol të madh në përcaktimin e çështjes, nuk mund të thuhej se kërkuesit i ishte mohuar mundësia efektive për kontestimin e arsyeshmërisë së besimit dhe dyshimeve të Sekretarit të Shtetit në lidhje me të. Në raste të tjera, edhe kur të gjitha ose shumica e provave kishin mbetur të pazbuluara, nëse akuzat e përmbajtura në materialin e hapur kishin qenë të hollësishme në masë të mjaftueshme, do të kishte qenë e mundur që kërkuesi t'i ofronte përfaqësuesve të tij dhe avokatëve të tij të posaçëm informacione me të cilat të kundërshtoheshin ato, nëse informacione të tilla ekzistonin, pa pasur nevojë që ai të dinte hollësitë apo burimet e provave që formonin bazën e akuzave. Një shembull do të ishte akuza e ngritur kundër disa prej kërkuesve që ata kishin marrë pjesë në një kamp terrorist trajnimi në një vendndodhje të dhënë në harkun kohor mes datave të deklaruara; duke pasur parasysh natyrën e saktë të akuzës, do të kishte qenë e mundur për kërkuesin që t'i jepte avokatit të posaçëm prova shfajësuese, për shembull një alibi ose një shpjegim alternativ për praninë e tij aty, të mjaftueshëm aq sa t'i lejonte avokatit që ta kontestonte akuzën në mënyrë efektive. Megjithatë, aty ku materiali i hapur përbëhej vetëm nga konstatime të përgjithshme dhe vendimi i SIAC-it për miratimin e certifikimit dhe vazhdimin e ndalimit bazohej vetëm mbi ose në shkallë vendimtare tek materiali i mbyllur, kërkesat procedurale nga neni 5 § 4 nuk janë përmbushur.

221. Prandaj, Gjykata duhet të vlerësojë procedurat e certifikimit në lidhje me secilin prej kërkuesve të ndaluar duke pasur parasysh këto kritere.

222. Ajo vëren që materialet e hapura kundër kërkuesit të gjashtë, shtatë, tetë, nëntë dhe njëmbëdhjetë përfshinin akuza të hollësishme lidhur me, për shembull, blerjen e pajisjeve të veçanta të telekomunikimit, posedimin e dokumenteve të caktuara të lidhura me terroristë të dyshuar të përmendur

me emra, dhe takime me terroristë të dyshuar të përmendur me emra përfshirë edhe vendin dhe datat e sakta. Ajo konsideron që këto akuza ishin aq të hollësishme sa t'u lejonin kërkuesve kontestimin efektiv të tyre. Prandaj, nuk gjen shkelje të nenit 5 § 4 në lidhje me kërkuesin e gjashtë, shtatë, tetë, nëntë dhe njëmbëdhjetë.

223. Akuzat kryesore kundër kërkuesit të parë dhe të dhjetë ishin që ata kishin qenë të përfshirë në mbledhjen e fondeve për grupe terroriste të lidhura me al'Qaedën. Në rastin e kërkuesit të parë kishte prova të hapura të shumave të mëdha të parave të lëvizura përmes llogarisë së tij bankare, dhe në rastin e kërkuesit të dhjetë kishte prova të hapura të përfshirjes së tij në mbledhjen e parave përmes mashtrimit. Megjithatë, në secilin rast provat që kinse paraqisnin lidhjen mes parave të mbledhura dhe terrorizmit nuk iu zbuluan asnjërit kërkues. Në këto rrethana, Gjykata nuk konsideron që këto kërkues ishin në gjendje të kontestonin në mënyrë efektive akuzat kundër tyre. Prandaj, ka pasur shkelje të nenit 5 § 4 në lidhje me kërkuesin e parë dhe kërkuesin e dhjetë.

224. Akuzat e hapura në lidhje me kërkuesin e tretë dhe të pestë ishin të një natyre të përgjithshme, kryesisht që ata ishin anëtarë të grupeve të njohura ekstremistësh islamikë të lidhur me al'Qaedën. SIAC vërejti në vendimet e tij ku rrëzohej apeli i secilit kërkues që provat e hapura ishin jo-thelbësore dhe që provat mbi të cilat ai ishte mbështetur kundër kërkuesve gjendeshin kryesisht në materialin e mbyllur. Sërish, Gjykata nuk konsideron që këta kërkues ishin në gjendje të kontestonin në mënyrë efektive akuzat kundër tyre. Prandaj, ka pasur shkelje të nenit 5 § 4 në lidhje me kërkuesin e tretë dhe kërkuesin e pestë.

#### V. SHKELJET E PRETENDUARA TË NENIT 5 §1 NË LIDHJE ME NENIN 13

225. Kërkuesit argumentuan më tej që çështjet për të cilat bëhej ankesë në lidhje me nenin 5 § 4 po ashtu i jepnin shkas një shkeljeje të nenit 13. Duke pasur parasysh gjetjet e mësipërme, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme të shqyrtohen këto ankesa në mënyrë të ndarë.

#### VI. SHKELJET E PRETENDUARA TË NENIT 5 § 5 TË KONVENTËS

226. Së fundi, kërkuesit u ankuan që, pavarësisht se ishin ndaluar në mënyrë të paligjshme në shkelje të nenit 5 §§ 1 dhe 4, ata nuk kishin të drejtë të zbatueshme për kompensim, në shkelje të nenit 5 § 5, i cili parashikon që:

“Çdo person që ka qenë viktimë e arrestimit ose ndalimit në kundërshtim me dispozitat e këtij neni ka të drejtën e zbatueshme për kompensim.”

227. Qeveria arsyetoi që nuk kishte pasur shkelje të nenit 5 në këtë rast, kështu që neni 5 § 5 nuk ishte i zbatueshëm. Në rast se Gjykata do të gjente shkelje të nenit 5, neni 5 § 5 kërkonte një “të drejtë të zbatueshme për kompensim”, por nuk thoshte që kompensimi do të jepej në çdo rast. Meqenëse Sekretari i Shtetit u gjet nga gjykatat kombëtare të dyshonte me arsye që kërkuesit ishin “terroristë ndërkombëtarë”, parimisht atyre nuk u takonte kompensim nga gjykatat vendase.

#### A. Pranueshmëria

228. Gjykata vëren se ka gjetur shkelje të nenit 5 § 1 në lidhje me të gjithë kërkuesit përveç kërkuesit të dytë dhe të katërt, dhe që ka gjetur shkelje të nenit 5 § 4 në lidhje me kërkuesin e parë, të tretë, të pestë dhe të dhjetë. Rrjedh që ankesat e kërkuesve sipas nenit 5 § 5 janë të papranueshme, por ankesat e kërkuesve të tjerë janë të pranueshme.

#### B. Themelet

229. Gjykata vëren se shkeljet e mësipërme nuk mund t’i jepnin shkas një pretendimi të zbatueshëm për kompensim nga kërkuesit para gjykatave vendase. Rrjedh që ka pasur një shkelje të nenit 5 § 5 në lidhje me të gjithë kërkuesit përveç kërkuesit të dytë dhe të katërt (shih *Brogan dhe të Tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i datës 29 nëntor 1988, § 67, Seria A nr. 145-B dhe *Fox, Campbell dhe Hartley*, cituar lart, § 46).

### VII. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 6 TË KONVENTËS

230. Kërkuesit argumentuan nga ana tjetër që procedura para SIAC-it nuk ishte në përputhje me nenin 6 §§ 1 dhe 2 të Konventës, të cilët parashikojnë që:

“1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, secili ka të drejtën të ketë një seancë publike të drejtë dhe publike brenda një periudhe kohore të arsyeshme nga një tribunal i pavarur dhe i paanshëm i ngritur sipas ligjit. Vendimi do të shpallet publikisht por shtypi dhe publiku mund të përjashtohen nga e tërë ose një pjesë e gjyqit në interes të moralit, rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, ku kjo kërkohet nga interesat e të miturve apo mbrojtja e jetës private të palëve, ose deri në atë masë sa është e nevojshme sipas mendimit të gjykatës në rrethana të caktuara ku publiciteti do të paragjykonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person i akuzuar për veprë penale do të presupozohet i pafajshëm deri sa të vërtetohet fajtor sipas ligjit.”

231. Kërkuesit argumentuan që neni 6 ishte *lex specialis* i garancisë për gjyq të drejtë. Regjimi nën shqyrtim përfaqësonte formën më serioze të masës ekzekutive kundër të dyshuarve për terrorizëm të miratuar brenda



Shteteve Anëtare të Këshillit të Europës në periudhën e pas vitit 2001. Ai u miratua për t'i mundësuar Mbretërisë së Bashkuar që të fillonte procedurat kundër individëve vetëm mbi bazën e dyshimit të arsyeshëm, duke u nisur nga provat të cilat nuk mund të paraqiteshin në gjykatat e zakonshme. Kjo në vetvete kërkoi një analizë në kuadër të nenit 6. Procedurat ishin për përcaktimin e një akuze penale, brenda kuptimit autonom të miratuar sipas nenit 6 § 1, dhe gjithashtu për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile. Përdorimi i materialeve të mbyllura i dha shtysë një shkeljeje të nenit 6.

232. Në parashtrësën e Qeverisë, neni 5 § 4 ishte *lex specialis* lidhur me ndalimin dhe çështjet duhet të shqyrtohen sipas kësaj dispozite. Sidoqoftë, neni 6 nuk ishte i zbatueshëm, sepse vendimi i SIAC-it mbi çështjen nëse duhet të kishte ndalim lidhej me “masat e veçanta të kontrollit të imigracionit” duke mos përcaktuar kështu as akuzën penale e as ndonjë të drejtë ose detyrim civil. Edhe sikur neni 6 § 1 të ishte i zbatueshëm, nuk ka pasur shkelje, për arsyt e cekura më lart në lidhje me nenin 5 § 4.

233. Pa dalë në ndonjë përfundim lidhur me faktin nëse procedurat para SIAC-it hynin brenda fushëveprimit të nenit 6, Gjykata i deklaroi këto ankesa të pranueshme. Megjithatë, ajo vëren se ajo i ka shqyrtuar çështjet lidhur me përdorimin e avokatëve të posaçëm, seancat e mbyllura dhe mungesën e zbulimit të plotë në procedurat para SIAC-it lart, në lidhje me ankesat e kërkuarve sipas nenit 5 § 4. Në vijim të këtij shqyrtimi të plotë, ajo nuk e gjykon të nevojshëm shqyrtimin e ankesave sipas nenit 6 § 1.

## VIII. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

234. Kërkuesit kërkojnë kompensim për dëme materiale dhe jo-materiale të pësuarat si pasojë e shkeljeve, së bashku me kostot dhe shpenzimet, sipas nenit 41 të Konventës, i cili parashikon që:

“Nëse Gjykata gjen që ka pasur shkelje të Konventës ose të Protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese në fjalë lejon vetëm dëmshpërblim të pjesshëm, Gjykata, nëse është e nevojshme, do t'i ofrojë shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

Qeveria argumentoi që caktimi i një shpërblimi të drejtë nuk do të ishte as i nevojshëm as i përshtatshëm në rastin konkret.

### A. Dëmi

#### 1. Pretendimet e kërkuarve

235. Kërkuesit parashtruan që shpërblimi i drejtë në para ishte i nevojshëm dhe i përshtatshëm. Për sa i përket vlerësimit të shumës, mund të merreshin parasysh shpërblimet e akorduara nga gjykatat vendase në rastet e ndalimit të paligjshëm dhe gjithashtu edhe nga kompensimet e bëra nga

Gjykata në çështjet e kaluara (ata iu referuan, *inter alia*, çështjeve *Perks dhe të Tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 25277/94, nr. 25279/94, nr. 25280/94, nr. 25282/94, nr. 25285/94, nr. 28048/95, nr. 28192/95 dhe nr. 28456/95, vendim i datës 12 tetor 1999, ku u caktua kompensim në shumën 5.500 paund për gjashtë ditë burgim të paligjshëm, dhe *Tsirlis dhe Kouloumpas kundër Greqisë*, vendim i datës 29 maj 1995, *Përmbledhjet 1997-III*, ku kërkuesit u kompensuan në barasvlerën e 17.890 paund dhe 16.330 paund, respektivisht, në lidhje me periudhat prej 13 dhe 12 muaj burgim për refuzimin e kryerjes së shërbimit ushtarak).

236. Kërkuesi i parë pretendoi kompensim për humbjen e lirisë së tij mes 19 dhjetorit 2001 dhe 11 marsit 2005, një periudhë prej tre vitesh e 83 ditësh, dhe për vuajtjen mendore, përfshirë edhe sëmundjen mendore. Ai parashtroi që, përveç kësaj, shpërblimi duhet të merrte parasysh vuajtjen e përjetuar nga bashkëshortja dhe familja e tij si pasojë e ndarjes dhe publicitetit negativ. Ai propozoi një kompensim prej 234.000 paund për dëme jo-materiale. Më tej, ai pretendoi afro 7.500 paund për dëme materiale për të mbuluar koston e vizitave që i kishin bërë familjarët e tij në burg dhe shpenzime të tjera.

237. Kërkuesi i tretë pretendoi kompensim për humbjen e lirisë së tij mes 19 dhjetorit 2001 dhe 11 marsit 2005 dhe për vuajtjen mendore si pasojë, përfshirë edhe sëmundjen mendore, së bashku me shqetësimin shkaktuar bashkëshortes dhe fëmijëve të tij. Ai propozoi shifrën 230.000 paund për dëme jo-materiale, së bashku me dëme materiale në shumën 200 paund për shpenzimet e udhëtimit të bashkëshortes së tij, dhe një shumë për të mbuluar humbjen e mundësisë së tij për të ngritur një biznes në Mbretërinë e Bashkuar.

238. Kërkuesi i pestë pretendoi kompensim për burgimin e tij mes 19 dhjetorit 2001 dhe 22 prillit 2004, për arrestin pasues shtëpiak deri më 11 mars 2005 dhe vuajtjen mendore si pasojë, së bashku me vuajtjen e shkaktuar bashkëshortes dhe fëmijëve të tij. Ai propozoi shifrën 240.000 paund për dëme jo-materiale, së bashku me shifrën 5.500 paund për dëme materiale, përfshirë udhëtimet e bashkëshortes së tij dhe kujdesi për fëmijët si dhe paratë që ajo ia kishte dërguar kërkuesit në burg.

239. Kërkuesi i gjashtë pretendoi kompensim për burgimin e tij mes 19 dhjetorit 2001 dhe 11 marsit 2005 dhe për vuajtjen mendore pasuese, së bashku me shqetësimin e shkaktuar bashkëshortes dhe fëmijëve të tij. Ai propozoi shifrën 210.000 paund për dëme jo-materiale, së bashku me 51.410 paund për dëme materiale, përfshirë humbjen e fitimeve si korrier i vetëpunësuar dhe shpenzimet e udhëtimit të bashkëshortes së tij.

240. Kërkuesi i shtatë pretendoi kompensim për burgimin e tij mes 8 shkurtit 2002 dhe 11 marsit 2005 dhe për vuajtjen mendore pasuese, përfshirë edhe sëmundjen mendore. Ai propozoi shifrën 197.000 paund për dëme jo-materiale. Ai nuk kërkoi kompensim për dëme materiale.

241. Kërkuesi i tetë pretendoi kompensim për humbjen e lirisë së tij mes 23 tetorit 2002 dhe 11 marsit 2005 dhe për vuajtjen mendore pasuese, së bashku me shqetësimin e shkaktuar bashkëshortes dhe fëmijëve të tij. Ai propozoi shifrën 170.000 paund për dëme jo-materiale, së bashku me shifrën 4.570 paund për dëme materiale, përfshirë paratë që i janë dërguar atij në burg nga bashkëshortja e tij dhe shpenzimet e saj gjatë ndërrimit të vendbanimeve për t'iu shmangur vëmendjes së padëshirueshme të mediave.

242. Kërkuesi i nëntë pretendoi kompensim për humbjen e lirisë së tij mes 22 prillit 2002 dhe 11 marsit 2005, dhe për vuajtjen mendore pasuese, përfshirë edhe sëmundjen mendore, dhe për shqetësimin e shkaktuar bashkëshortes dhe fëmijëve të tij. Ai propozoi shifrën 215.000 paund për dëme jo-materiale, së bashku me shifrën 7.725 paund për dëme materiale, përfshirë paratë që i ishte dashur të merrte hua për ta ndihmuar bashkëshorten e tij me shpenzimet shtëpiake, paratë që ia kishte dërguar në burg bashkëshortja e tij, dhe shpenzimet e udhëtimeve të saj për ta vizituar atë në burg. Gjithashtu, ai kërkoi një shumë për të mbuluar mundësinë e tij të humbur për të hapur biznes në Mbretërinë e Bashkuar.

243. Kërkuesi i dhjetë pretendoi kompensim për humbjen e lirisë së tij mes 14 janarit 2003 dhe 11 marsit 2005 dhe për vuajtjen mendore pasuese, përfshirë edhe sëmundjen mendore. Ai propozoi shifrën 144.000 paund për dëme jo-materiale, së bashku me shifrën 2.751 paund për dëme materiale, përfshirë humbjen e pagesës së përjavshme prej 37 paund që ai merrte nga Shërbimet Kombëtare të Përkrahjes për Azil (National Asylum Support Service) para burgimit të tij dhe koston e telefonatave që ai i kishte bërë përfaqësuesve të tij ligjorë.

244. Kërkuesi i njëmbëdhjetë pretendoi kompensim për humbjen e lirisë së tij mes 2 tetorit 2003 dhe 11 marsit 2005 dhe për vuajtjen mendore pasuese. Ai propozoi shifrën 95.000 paund për dëme jo-materiale, por nuk bëri kërkesë për dëme materiale.

## 2. Parashtrësit e Qeverisë

245. Qeveria, duke u mbështetur në vendimin e Gjykatës në çështjen *McCann dhe Të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i datës 27 shtator 1995, § 219, Seria A nr. 324, argumentoi që, në parim, kërkuesve nuk u takonte asnjë formë kompensimi financiar sepse ata konkretisht dyshoheshin, mbi baza objektive dhe të arsyeshme, për përfshirje në terrorizëm dhe nuk kishin arritur ta hiqnin atë dyshim.

246. Qeveria theksoi se Pjesa 4 e Ligjit të vitit 2001 ishte miratuar dhe derogimi ishte bërë në mirëbesim, në përpjekje për të zgjidhur atë që perceptohej si një situatë tepër serioze që shkonte deri në gjendjen e emergjencës publike e cila rrezikonte jetën e kombit. Problemi thelbësor me skemën e ndalimit sipas Ligjit të vitit 2001, siç u identifikua nga SIAC dhe Dhoma e Lordëve, ishte se ajo nuk zbatohet për shtetasit e Mbretërisë së Bashkuar ashtu siç zbatohet për shtetasit e huaj. Pas vendimit të Dhomës së

Lordëve, u shqyrtua në mënyrë urgjente çështja se çfarë duhej bërë me kërkuesit duke pasur parasysh emergjencën publike dhe u vendos që duhet të ngrihej një sistem urdhrash kontrolli. Në këto rrethana, nuk mund të sugjerohej që Qeveria kishte vepruar në mënyrë cinike apo duke shpërfillur në mënyrë flagrante të drejtat e individëve.

247. Përveç kësaj, Qeveria parashtroi që asnjë shpërblim i drejtë nuk mund të caktohej në lidhje me shkeljet procedurale të gjetura nga Gjykata (për shembull, sipas nenit 5 §§ 4 ose 5), meqenëse nuk ishte e mundur të spekulohet se çfarë do të kishte ndodhur nëse nuk do të kishte pasur shkelje (*Kingsley kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], nr. 35605/97, KEDNJ 2002-IV; *Hood kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 27267/95, KEDNJ 1999-I).

248. Nëse Gjykata vendos të caktojë ndonjë shpërblim në para, ajo duhet të shqyrtojë me kujdes në secilin pretendim për të konstatuar nëse ka prova mbështetëse të mjaftueshme, nëse pretendimi lidhet sa duhet me shkeljen dhe nëse pretendimi është i arsyeshëm për sa i përket shumës.

### 3. Vlerësimi i Gjykatës

249. Gjykata kujton, së pari, që ajo nuk ka gjetur shkelje të nenit 3 në rastin konkret. Rrjedh që ajo nuk mund të caktojë shpërblim në lidhje me vuajtjen mendore, përfshirë edhe sëmundjen mendore, që pretendohet të ketë rrjedhur nga kushtet e burgimit apo natyra e papërcaktuar në kohë e skemës së ndalimit në Pjesën 4 të Ligjit të vitit 2001.

250. Megjithatë, ajo ka gjetur shkelje të nenit 5 §§ 1 dhe 5 në lidhje me kërkuesin e parë, të tretë, të pestë, të gjashtë, të shtatë, të tetë, të nëntë, të dhjetë dhe të njëmbëdhjetë. Kështu, në përputhje me nenin 41, Gjykata do të mund të caktonte kompensime në para për këta kërkues, nëse do ta gjykonte se një shpërblim i tillë është “i nevojshëm”. Gjykata ka liri të gjerë për të përcaktuar se kur duhet të ketë dëmshpërblim, dhe shpesh është shprehur se gjetja e një shkeljeje është shpërblim i mjaftueshëm pa kompensim monetar të mëtejshëm (shih, mes shumë shembujve, *Nikolova*, cituar lart, § 76). Në ushtrimin e lirisë së saj Gjykata merr parasysh të gjitha rrethanat e çështjes përfshirë edhe natyrën e shkeljeve të gjetura si dhe çdo rrethanë tjetër të veçantë të lidhur me kontekstin e çështjes.

251. Gjykata kujton që në vendimin e çështjes *McCann dhe të Tjerë*, cituar lart, § 219, ajo ka refuzuar dhënien e dëmshpërblimit në lidhje me dëme materiale apo jo-materiale nga shkeljet e nenit 2 të Konventës, duke marrë parasysh faktin që tre të dyshuarit terroristë që u vranë kishin pasur për qëllim të vendosnin një bombë në Gjibraltari. Ajo konsideron që çështja e tanishme dallon, meqenëse nuk është konstatuar që ndonjëri prej kërkuesve është angazhuar, ose ka tentuar të angazhohej, në ndonjë akt dhune terroriste.

252. Vendimi nëse të caktohet ndonjë kompensim monetar në këtë rast dhe, nëse po, shuma e secilit shpërblim, duhet të marrë parasysh disa

faktorë. Kërkuesit janë mbajtur të ndaluar për periudha të gjata kohe, në shkelje të nenit 5 § 1, dhe Gjykata në të kaluarën ka caktuar shuma të mëdha si shpërblim i drejtë për burgimin e paligjshëm (shih, për shembull, *Assanidze kundër Gjeorgjisë* [GC], nr. 71503/01, KEDNJ 2004-II, ose çështjet e cituara nga kërkuesit në paragrafin 235 lart). Megjithatë, çështja e tanishme është shumë ndryshe. Pas pasojave të sulmeve të al'Qaedës në Shtetet e Bashkuara më 11 shtator 2001, në një situatë të cilën gjykatat vendase dhe kjo Gjykatë e kanë pranuar se ekzistonte një emergjencë publike që kërcënonte jetën e kombit, Qeveria ka pasur për detyrë të mbronte popullsinë e Mbretërisë së Bashkuar nga dhuna terroriste. Skema e ndalimit në Pjesën 4 të Ligjit të vitit 2001 është hartuar në mirëbesim, në përpjekje për të kombinuar nevojën për parandalimin e kryerjes së akteve të terrorizmit me detyrimin sipas nenit 3 të Konventës për të mos zhvendosur ose dëbuar asnjë person në një vend ku ai do të përballej me rrezikun real të keqtrajtimit (shih paragrafin 166 lart). Me gjithë faktin që Gjykata, ashtu si Dhoma e Lordëve, gjeti që masat deroguese ishin jo proporcionale, pjesa thelbësore e asaj gjetjeje ishte që legjislacioni ishte diskriminues në shënjestrimin vetëm të jo-shtetasve. Për më tepër, pas vendimit të Dhomës së Lordëve, skema e ndalimit sipas Ligjit të vitit 2001 u zëvendësua me një sistem urdhrash kontrolli sipas Ligjit për Parandalimin e Terrorizmit të vitit 2005. Të gjithë kërkuesit në rastin e të cilëve Gjykata ka gjetur shkelje të nenit 5 § 1, menjëherë pas lirit në mars 2005, iu nënshtruan urdhrave të kontrollit. Prandaj, nuk mund të presupozohet që, edhe nëse shkeljet në rastin konkret nuk do të kishin ndodhur, kërkuesit nuk do të t'i ishin nënshtruar disa kufizimeve ndaj lirisë së tyre.

253. Në këto kushte, Gjykata gjen që rrethanat justifikojnë caktimin e dhënies së një shpërblimi substancialisht më të ulët sesa shpërblimi që ajo cakton zakonisht në raste të tjera të ndalimit të paligjshëm. Ajo cakton 3,900 euro për kërkuesin e parë, të tretë dhe të gjashtë; 3,400 euro për kërkuesin e pestë; 3,800 euro për kërkuesin e shtatë; 2,800 Euro për kërkuesin e tetë; 3,400 euro për kërkuesin e nëntë; 2,500 euro për kërkuesin e dhjetë; dhe 1,700 euro për kërkuesin e njëmbëdhjetë, së bashku me çdo taksë që mund të ngarkohet.

## **B. Kostot dhe shpenzimet**

254. Kërkuesit nuk pretenduan shpërblim për kostot e procedurave në vend, meqenëse ato ishin rikthyer si rezultat i urdhrat të dhënë nga Dhoma e Lordëve. Pretendimi i tyre total për kostot e procedurave para Gjykatës kapte shumën 144.752.64 paund, përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar ("TVSH"). Kjo përfshinte 599 orë pune të këshilluesve me tarifën 70 paund për orë plus TVSH, 342.5 orë pune të avokatëve të lartë me tarifën 200 paund për orë plus TVSH për përgatitjen e kërkesave, vërejtjeve dhe pretendimit për shpërblim të drejtë para Dhomës dhe Dhomës së Madhe, së

bashku me disbursime siç janë raportet e ekspertëve dhe kostot e seancave dëgjimore para Dhomës së Madhe. Ata parashtruan që kishte qenë e nevojshme të udhëzoheshin disa avokatë të ndryshëm, me fusha të ndryshme specializimi, duke pasur parasysh gamën e gjerë të çështjeve për t'u adresuar dhe të provave të përfshira, në lidhje me ngjarje që kishin ndodhur gjatë një periudhe dhjetëvjeçare.

255. Qeveria parashtroi që pretendimi ishte i tepërt. Në mënyrë të veçantë, numri i orëve të shpenzuara nga avokatët e ndryshëm për përgatitjen e dosjes së çështjes për secilin rast nuk mund të justifikohet, sidomos duke pasur parasysh që secili kërkues ishte përfaqësuar gjatë gjithë procedurave vendase në vazhden e të cilave duhet të jenë dhënë udhëzime të detajuara dhe duhet të jenë marrë në shqyrtim praktikisht të gjitha çështjet e dala në kërkesën bërë Gjykatës. Honoraret e shpenzimeve të avokatëve, përveç kësaj, ishin të tepërta.

256. Gjykata kujton që një kërkuesi i takon rimbursim për ato shpenzime që faktikisht dhe me nevojë janë përdorur për parandalimin apo zgjidhjen e një shkeljeje të Konventës, deri në atë masë sa këto kosto janë të arsyeshme për sa i përket shumës (*Kingsley*, cituar lart, § 49). Ndërkohë që ajo pranon që numri i kërkuesve në mënyrë të pashmangshme do të ketë kërkuar punë shtesë nga ana e përfaqësuesve të tyre, Gjykata vëren se shumica e materialeve individuale të depozituara në Gjykatë kishin pasur të bënin me ankesat e kërkuesve nga neni 3 i Konventës dhe pretendimet e tyre për shpërbllim të drejtë që dilnin nga këto ankesa, të cilat Gjykata i ka refuzuar. Përveç kësaj, ajo e pranon argumentin e Qeverisë që disa çështje, veçanërisht ato që kanë lidhje me derogimin sipas nenit 15 të Konventës, kishin dalë para gjykatave vendase, të cilat duhet ta kishin reduktuar kohën e nevojshme për përgatitjen e kësaj pjese të çështjes. Në këto rrethana, ajo konsideron që kërkuesve duhet t'u caktohen në total 60,000 euro në lidhje me kostot dhe shpenzimet, së bashku me çdo taksë që mund t'u ngarkohet kërkuesve.

### **C. Interesi i munguar**

257. Gjykata e konsideron të përshtatshme që interesi i munguar të bazohet mbi përqindjen e shkallës marginale të kreditimit të Bankës Qendrore Europiane, së cilës duhet t'i shtohen tri pikë përqindjeje.

## **PËR KËTO ARSYE, GJYKATA NJËZËRI**

1. *Deklaron* ankesën e kërkuesit të dytë nga nenet 3 dhe 13 të Konventës të papranueshme, dhe ankesat e kërkuesve të parë, të tretë, të katërt, të

pestë, të gjashtë, të shtatë, të tetë, të nëntë, të dhjetë dhe të njëmbëdhjetë nga nenet 3 dhe 13 të pranueshme (shih paragrafët 123-125 të vendimit);

2. *Vendos* që nuk ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës, të marrë vetëm ose në lidhje me nenin 13, për sa u përket kërkuesve të parë, tretë, katërt, pestë, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë, dhjetë dhe njëmbëdhjetë (paragrafët 126-136);
3. *Rrëzon* kundërshtimet paraprake të kërkuesve që Qeveria duhet të përjashtohet nga paraqitja e mbrojtjes sipas nenit 5 § 1(f) të Konventës apo kontestimi i gjetjes së Dhomës së Lordëve që derogimi nga neni 15 ka qenë i pavlefshëm (paragrafët 153-159);
4. *Deklaron* ankesat e kërkuesve sipas nenit 5 § 1 të Konventës të pranueshme (paragrafi 160);
5. *Vendos* që nuk ka pasur shkelje të nenit 5 § 1 të Konventës në lidhje me kërkuesin e dytë dhe të katërt (paragrafët 162-168);
6. *Vendos* që ka pasur shkelje të nenit 5 § 1 të Konventës në lidhje me kërkuesit e parë, tretë, pestë, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë, dhjetë dhe njëmbëdhjetë (paragrafët 162-190);
7. *Vendos* që nuk është e nevojshme të shqyrtohen ankesat e kërkuesve nga nenet 5 § 1 dhe 14 të marrë së bashku (paragrafi 192);
8. *Deklaron* ankesat e kërkuesit të dytë dhe të katërt nga neni 5 § 4 i Konventës të papranueshme dhe ankesat e kërkuesve të parë, tretë, pestë, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë, dhjetë dhe njëmbëdhjetë nga neni 5 § 4 të pranueshme (paragrafët 200-201);
9. *Vendos* që nuk është e nevojshme të shqyrtohen ankesat e kërkuesve të parë, tretë, pestë, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë, dhjetë dhe njëmbëdhjetë nga neni 5 § 4 që Dhoma e Lordëve nuk mund të merrte një urdhër detyrues për lirim të tyre (paragrafi 213);
10. *Vendos* që ka pasur shkelje të nenit 5 § 4 të Konventës në lidhje me kërkuesit e parë, të tretë, të pestë dhe të dhjetë por që nuk ka pasur shkelje të nenit 5 § 4 në lidhje me kërkuesit e gjashtë, të shtatë, të tetë, të nëntë dhe të njëmbëdhjetë (paragrafët 202-225);
11. *Vendos* që nuk është e nevojshme të shqyrtohen ankesat e kërkuesve nga nenet 5 § 4 dhe 13 të marrë së bashku (paragrafi 225);

12. *Deklaron* ankesat e kërkuessit të dytë dhe të katërt nga neni 5 § 5 i Konventës të papranueshme dhe ankesat e kërkuessve të parë, të tretë, të pestë, të gjashtë, të shtatë, të tetë, të nëntë, të dhjetë dhe të njëmbëdhjetë nga neni 5 § 5 të pranueshme (paragrafi 228);
13. *Vendos* që ka pasur shkelje të nenit 5 § 5 të Konventës në lidhje me kërkuessit e parë, të tretë, të pestë, të gjashtë, të shtatë, të tetë, të nëntë, të dhjetë dhe të njëmbëdhjetë (paragrafi 229);
14. *Deklaron* ankesat e kërkuessve nga neni 6 i Konventës të pranueshme (paragrafi 233);
15. *Deklaron* që nuk është e nevojshme të shqyrtohen ankesat e kërkuessve nga neni 6 i Konventës (paragrafi 233);
16. *Vendos* që Shteti përgjegjës duhet të paguajë, brenda tre muajve, shumat e mëposhtme, të konvertuara në paund me tarifën e zbatueshme në kohën e vendimit:
  - (a) në lidhje me dëmet materiale dhe jo-materiale, 3.900 euro (tre mijë e nëntëqind euro) kërkuessit të parë, të tretë dhe të gjashtë; 3.400 euro (tre mijë e nëntëqind euro) kërkuessit të pestë; 3.800 euro (tre mijë e tetëqind euro) kërkuessit të shtatë; 2.800 euro (dy mijë e tetëqind euro) kërkuessit të tetë; 3.400 euro (tre mijë e katërqind euro) kërkuessit të nëntë; 2.500 euro (dy mijë e pesëqind euro) kërkuessit të dhjetë; dhe 1.700 euro (një mijë e shtatëqind euro) kërkuessit të njëmbëdhjetë, plus taksat e ngarkueshme për kërkuessit;
  - (b) për kërkuessit së bashku, në lidhje me kostot dhe shpenzimet, 60.000 euro (gjashtëdhjetë mijë euro), plus taksat e ngarkueshme për kërkuessit;
  - (c) që, nga skadimi i tre muajve të lartpërmendur deri në pagimin e plotë, do të paguhet interesa të thjeshta mbi shumat e mësipërme në përqindjen e shkallës marginale të kreditimit të Bankës Qendrore Europiane, së cilës duhet t'i shtohen tri pikë përqindjeje (paragrafët 249-257);
17. *Rrëzon* pjesën tjetër të pretendimeve të kërkuessve për shpërblim të drejtë.

E bërë në anglisht dhe frëngjisht, dhe miratuar në seancë publike në Ndërtësën e të Drejtave të Njeriut, në Strasburg, më 19 shkurt 2009.

Michael O'Boyle  
Zëvendës Kancelar

Jean-Paul Costa  
Kryetar



© **Këshilli i Europës/Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, 2012.** Gjuhët zyrtare të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut janë anglisht dhe frëngjisht. Ky përkthim është realizuar me mbështetjen e Fondit të Mirëbesimit të të Drejtave të Njeriut pranë Këshillit të Europës ([www.coe.int/humanrightstrustfund](http://www.coe.int/humanrightstrustfund)). Ai nuk është detyruar ndaj Gjykatës, dhe Gjykata nuk mban përgjegjësi për cilësinë e tij. Ai mund të shkarkohet nga baza e të dhënave të praktikës gjyqësore HUDOC të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (<http://hudoc.echr.coe.int>) ose nga çdo bazë tjetër të dhënash në të cilën e shpërndan Gjykata. Ai mund të rishtypet për qëllime jo komerciale me kusht që të citohet titulli i plotë i çdo çështjeje, së bashku me përshkrimin e mësipërm të të drejtave të autorit dhe referencën për Fondin e Mirëbesimit të të Drejtave të Njeriut. Nëse synohet që ndonjë pjesë e këtij përkthimi të përdoret për qëllime komerciale, lutemi kontaktoni [publishing@echr.coe.int](mailto:publishing@echr.coe.int).

© **Council of Europe/European Court of Human Rights, 2012.** The official languages of the European Court of Human Rights are English and French. This translation was commissioned with the support of the Human Rights Trust Fund of the Council of Europe ([www.coe.int/humanrightstrustfund](http://www.coe.int/humanrightstrustfund)). It does not bind the Court, nor does the Court take any responsibility for the quality thereof. It may be downloaded from the HUDOC case-law database of the European Court of Human Rights (<http://hudoc.echr.coe.int>) or from any other database with which the Court has shared it. It may be reproduced for non-commercial purposes on condition that the full title of the case is cited, together with the above copyright indication and reference to the Human Rights Trust Fund. If it is intended to use any part of this translation for commercial purposes, please contact [publishing@echr.coe.int](mailto:publishing@echr.coe.int).

© **Conseil de l'Europe/Cour européenne des droits de l'homme, 2012.** Les langues officielles de la Cour européenne des droits de l'homme sont le français et l'anglais. La présente traduction a été effectuée avec le soutien du Fonds fiduciaire pour les droits de l'homme du Conseil de l'Europe ([www.coe.int/humanrightstrustfund](http://www.coe.int/humanrightstrustfund)). Elle ne lie pas la Cour, et celle-ci décline toute responsabilité quant à sa qualité. Elle peut être téléchargée à partir de HUDOC, sa base de jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme (<http://hudoc.echr.coe.int>) ou de toute autre base de données à laquelle HUDOC l'a communiquée. Elle peut être reproduite à des fins non commerciales, sous réserve que le titre de l'affaire soit cité en entier et s'accompagne de l'indication de copyright ci-dessus ainsi que de la référence au Fonds fiduciaire pour les droits de l'homme. Toute personne souhaitant se servir de tout ou partie de la présente traduction à des fins commerciales est invitée à le signaler à l'adresse suivante: [publishing@echr.coe.int](mailto:publishing@echr.coe.int).